Versioni serb i 'kalit të Trojës'

SIGURI, VËSHTRIME, OPINIONE DHE TRAJTESA

Hajriz Sejdiu

Prishtinë, korrik 2018

~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

Përmbajtja

2.	Përmbajtja	faqe
3.	Hyrje	
4.	Recensat	
5.	Uraniumi i varfëruar rrezik që nuk shihet	
6.	Kosova dhe Rreziqet e Pavarësisë	
7.	Versioni serbi i “Kalit të Trojës”	
8.	Strategji për shuarjen e strukturave paralele	
9.	Tre skenarë që faktorizuan Veriun	
10.	Misioni me mandat sigurie që rrezikoi sigurinë	
~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~~

11.	Idetë tragjikomike ose apetitet qesharake të fqinjëve	
12.	Siguri Ndërkombëtare-Konspiracioni i madh botëror-Osama bin Laden	
13.	Veriu i Kosovë, sigurizimi dhe politizimi i çështjes	
14.	Të kujt janë Resurset Natyrore dhe Pasuritë e Kosovës	
15.	Emergjencat civile si pjesë strukturale e sigurisë nacionale	
16.	Krizat, Llojet dhe Menaxhimi i tyre	
17.	Plani Operativ “Veriu”	
18.	Qka pas Operacionit ”Veriu”	
19.	Autonomia politike shtetërore dhe diplomacia imponuese	
20.	Ruletë ruse përsëri në Ballkan	
21.	Sa jemi të (pa) përgatitur për të menaxhuar fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	
22.	Rrini pa drojë, amerikanët nuk do të largohen nga Kosova	
23.	Infrastruktura kritike dhe siguria nacionale	
24	Kush është koloneli Zhak Okar, autori i librit “ Evropa vdiq në Prishtinë”	
25.	Qentë endacak dhe menaxhimi i rreziqeve në nivelin lokal	
26.	Menaxhimi i refugjatëve, sfida e radhës për Kosovën	
27.	Marrëveshjet antikushtetuese dhe gjendja e sigurisë	
28.	Kosova përball anarkisë, radikalizmit dhe ekstremizmit	
29.	Shërbimet sekrete Serbo - Ruse aktivizohen vrullshëm në Kosovë	
30.	Konspiracioni HAARP apo ndërtimi i autostradës e shkaktoi tragjedinë në Hasan beg	
31.	A është i qëndrueshëm diskursi politik për krijimin së shpejti të Forcave të Armatosura	
32.	Gracka e fundosjes së shtetësisë së Kosovës në Asociacion ose Gazivodë	
34.	Në programet për zgjedhjet lokale, mungon trajtimi i politikave të sigurisë publike	
35.	Sfidat e menaxhimit të sektorit të sigurisë në bashkësi (komunitet)	

HYRJE

Këto shkrime të shtruara në këtë libër, janë një reflektim i situatave dhe gjendjes politike, ekonomike dhe sociale dhe të sigurisë në Kosovë që nga viti 2007 kur, Kosova po përballej me sfida të shumta, me rreziqe dhe kërcënime të të gjitha llojeve dhe formave, jo vetëm prej Serbisë si një shtet ish kolonialist dhe okupator por edhe prej një pjese të bashkësisë ndërkombëtare, tradicionalisht antishqiptare. Këtu janë shkoqitur tema të ndjeshme për çështjet e sigurisë dhe çështjet tjera për të ardhmen vendimtare të vendit, jo vetëm gjatë kërcënimit dhe rrezikimit të Kosovës dhe popullit të saj ne aspektin e lirive dhe të drejtave elementare njerëzore, por edhe të atyre politike, ekonomike dhe shoqërore në përgjithësi, e në veçanti për çështjet që kanë të bëjnë me kërcënimin e qenies

sonë kombëtare dhe që njëkohësisht rrezikonin dhe ende rrezikojnë rajonin por edhe që kishin dhe kanë tendencën e kërcënimit të përhershëm të sigurisë ndërkombëtare. Deri në vitin 2007 kur Kosova përballej me rreziqe të shumta dhe të ndryshme, ajo ishte shumë e hendikepuar sepse administrohej nga UNMIK-u, kështu që në aspektin e sigurisë e edhe në aspektete tjera, institucionet Kosovare nuk mund të vepronin për shkakun se siguria definohet si funksion bazik i çdo shteti dhe natyrisht, duhet pas parasysh se pa një nivel të qëndrueshëm të sigurisë nuk mund të kemi një nivel demokratik të qeverisjes dhe as një siguri shoqërore në përgjithësi. Pas vitit 2008 kur Kosova fitoi pavarësinë e kushtëzuar, rreziqet dhe kërcënimet u shumëfishuan, qofshin ato të brendshme apo të jashtme e herë herë edhe nga vetë kosovarët në pozitë, opozitë, dhe nga shoqëria Civile, herë nga pakujdesia, mosdija apo të shtyrë nga elementet e huaja që vepronin dhe veprojnë edhe sot në Kosovë, të veshur me "petkun e solidaritetit, ndihmës, hvillimit dhe demokracisë" etj. Pas pavarësisë, Republika e Kosovës kishte nevojë për ligje që sigurojnë zhvillim ekonomik, arsimor, shkencor e teknologjik si dhe ligje që sanksionojnë krimin politik, ekonomik si dhe trafikimin dhe veprimet tjera që rrezikojnë një shtet të ri. Pasi këto mungonin, shpesh fatkeqësitë, incidentet apo krizat menaxhoheshin me vështirësi. Sidoqoftë pas miratimit të Kushtetutës shumë gjëra u qartësuan dhe sidomos pas aprovimit të Ligjit për Këshillin për Siguri të Kosovës u krijua bazamenti që Republika e Kosovës të menaxhojë me sukses çdo lloj të rreziqeve, fatkeqësive apo krizave.

Në shumicën e shteteve demokratlke siguria kombëtare përfshinë: sigurinë e territorit dhe sovranitetit kombëtar si dhe mbrojtjen e funksioneve themelore të shoqërisë si ato: (sociale, ekonomike, politike, kulturore, ekologjike, ekonomike, të mbrojtjes, etj). Njëkohësisht "siguria shtetërore përmban këto elemente bazë: sigurinë fizike, autonominë, zhvillimin dhe rendin".[1] Lexuesi dhe kritika duhet ta kenë parasysh se këto shkrime qëllimisht nuk janë menduar si shkrime strikte klasike shkencore të studimeve të sigurisë ku do të përfshiheshin citate apo fusnota të shumta, për më tepër, këtu janë trajtuar aspekte aktuale të Sigurisë

[1] Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Alan Collins, faqe 32

dhe të fushave tjera shoqërore që ndërlidhen natyrshëm me sigurinë, me një gjuhë të kuptueshme për të gjitha shtresat shoqërore, sepse tek e fundit edhe vet studimi i sigurisë si shkencë, është i dizajnuar për individin, grupet dhe shoqërinë në përgjithësi. Pasi që siguria ka të bëjë me individin, grupet shoqërore, grupet etnike dhe me shoqërinë në përgjithësi në një anë, kurse në anën tjetër ka të bëjë me territorin, sovranitetin, ekonominë, politikën, diplomacinë, mbrojtjen dhe ambientin, lexuesit apo të gjithë të interesuarit për fushën e sigurisë dhe sigurinë si nocion, këtu mund të gjejnë tema të ndryshme nga jeta në Kosovë, gjatë një periudhe të caktuar kohore historike, të renditura jo në aspektin përmbajtjesor dhe tematik por sipas kronologjisë së ngjarjeve, të prekura si opinione, refleksione, trajtesa, vrojtime apo të strukturuara si opsione individuale për zgjidhjen e çështjeve jetike shoqërore dhe të sigurisë në vend.
Me respekt:

Autori!

SIGURI AMBIENTALE

Uraniumi i varfëruar rrezik që nuk shihet

"Në vitin 1999, gjatë 78 ditëve të bombardimeve nga Aleanca Veri Atlantike (NATO), janë kryer 36.219 fluturime të avionëve luftarak"[2]. Bombarduesit e NATO-s fluturonin në lartësi prej 10-15 km. Në këto lartësi gjendet mbështjellësi i mbrojtjes së tokës, ozoni. Si pasojë e këtyre fluturimeve dhe bombardimeve, mund të jetë dëmtuar ky mbështjellës mbi tërë Ballkanin. Mbështjellësi i ozonit ka karakter sezonal, që ka të bëjë me gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike dhe me kohë të caktuar të vitit, kështu që ka mundësi që procesi i dëmtimit të ozonit nuk ka mund të qëndrojë shumë kohë në gjerësinë tonë gjeografike, megjithatë është shumë e sigurt se bombardimet, jo vetëm ato të NATO-s por edhe të forcave serbe, kanë ndikuar në zgjerimin global të vrimës ozonale.

Ç`ka është Uraniumi i Varfëruar (U. V) dhe pse quhet kështu?

[2] NATO reveals Kosovo depleted uranium use USAF A-10 planes fired DU munitions Wednesday, 22 March, 2000 By environment correspondent Alex Kirby, Nuc News - September 11, 2000

Urani është element natyror i cili, si gjithë elementet tjera gjendet gjithkund për rreth nesh. Në një tonelatë dhe, mesatarisht gjendet 0.5-5g të uranit natyror. Në ato vende ku gjendet më shumë se 0.1%, është ekonomike të hapen minierat e uranit sepse ky është baza e karburantit të energjetikës nukleare. Për të shfrytëzuar uranin në mënyrë komerciale, patjetër duhet të bëhet koncetrimi i tij. Urani natyror ka tri forma ose izotope : U^{234}, U^{235} dhe U^{238}, të cilët në aspektin kimik janë të njejtë por dallojnë vetëm për nga karakteristikat nukleare. Duke pasë parasysh se urani është element radioaktiv, ai në rrethin e vet emeton rrezatim atomik që është pasojë – rezultat i shkatërrimit të tij. »Ekzistojnë tri lloje themelore të rrezatimit alfa, beta dhe Gama, të cilat nuk janë të njejta dhe nuk janë njësoj të rrezikshme për organizmat e gjallë. Derisa U^{235} (që shfrytëzohet për qëllime komerciale), emeton më shumë rreze Gama, U^{238} më shumë emeton rreze të spektrit Alfa. Uraniumi i varfëruar në të vërtetë është Urani i cili ka më së paku sasi të U^{235}(gjithsejtë nën 1%), kurse pjesa më e madhe përbëhet nga U^{238} (gjithsejtë (99%). Uraniumi i varfëruar është mbeturinë nukleare artificiale ose mbetje nga urani i cili është perdorur në centralet nukleare. »Në botë ka rreth një million tonë të U.V. Rrezet alfa të cilat i emeton U.V., janë të një distance të shkurtër (gjithsejtë disa milimetra nga thërmiat e burimit të rrezatimit), por njëkohësisht janë 20 herë më të rrezikshme për organizmat e gjallë kur bijnë në kontakt me lëkurën. U.V., është shumë i rrezikshëm , sepse është radioaktiv, gjithashtu edhe për ate se është helmues. »[3]

U.V dhe rëndësia e tij në aspektin ushtarak

»Municioni me uranium të varfëruar është i dedikuar për gjuajtjen e tankseve dhe strehimoreve të kundërshtarit. Kjo gjuajtje realizohet përmes kalibreve të ndryshme, nga (7.6mm, dhe 120mm). Pjesë e rëndësishme e këtij municioni është gjilpëra goditëse (penetratori), e bërë nga lëgura me përbërje dominante të U.V. Arsyeja formale e përdorimit të këtij municioni është se: U.V është element natyror shumë i rëndë (1.7 herë më i rëndë se plumbi), kështu që me

[3] **The National Gulf War Resource Center** – USA E-mail: ngwrc@vva.org

vendosjen e tij në majën e granatës do të rritet mundësia e depërtueshmërisë më të madhe të granatës«[4]. Zakonisht, heshtet fakti se, në këtë mënyrë, vendet prodhuese të këtij lloji të armatimit, lirohen nga stoçet e mëdha të mbetjeve nukleare, duke hapur kështu mundësinë për një mënyrë të re të luftës nukleare bashkëkohore. »Në luftat në Ballkan, thuhet se është përdorur municioni i kalibrit 30mm., i cili është gjuajtur nga topat e avionëve A-10, AV-8B HARRIER. Kalibri prej 30mm mund ta depërton çelikun me trashësi 6-7cm kurse përmbajtja e tij është 292g U.V[5]«

Karakteristikat e Uaniumit të Varfëruar

Uraniumi i varfëruar për nga karakteristikat kimiko – toksike dallohet nga uraniumi i zakonshëm. Ekzistojnë tri lloje të uraniumit:234, 235 dhe 238. Ky i fundit (238) përdorët në reaktorët bërthamor për prodhimin e bombës nukleare. Për këtë qëllim uraniumin e pasurojnë me dy izotope tjera radioaktive të cilat nxirren nga uraniumi mineral i cili mbetet pa këto dy komponente dhe shëndërrohet në uranium 238 me përbërje 98.8 % ose Uranium i Varfëruar, mineral i cili është dy herë më pak radioaktiv se origjinali. Në këtë formë të parëndësishme por jo naive e përdorin për shkak të fortësisë së tij,(dendësisë dhe vëllimit, peshës së rëndë specifike). Në këtë formë ky është më i rëndë se plumbi dhe përdorët për prodhimin e shkopinjëve të golfit, pjesëve të aeroplanëve, anijeve, tankseve të blinduara dhe për rritjen e fuqisë depërtuese të projektilëve.

Kur eksplodojnë projektilët me U.V., në momentin e kontaktit me cakun, lirojnë nxehtësi prej:3.000 g. Celzius, me një shtesë të vogël plutoniumi i shtohen edhe 400 g. Celzius. Pas depërtimit në cak, plumbi shpërbëhët në pjesë të imëta të cilat digjen në kontakt me ajrin, duke shkaktuar kështu pasoja afatshkurtëra ose afatgjata për njerëzit që i thithin ato përmes ajrit. A do të jenë dëmtimet

[4] **Campaign Against Depleted Uranium** (CADU) – Velika Britanija E-mail: gmdcnd@gn.apc.org

[5] **DU** EFFECTS IN **KOSOVO** **UNMIK** INSTITUCIONET E PËRKOHSHMVE VETQEVERISËSE Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor, **March 12th, 2001**

afatshkurtëra apo afatgjata, varet nga forma e oksidit të uraniumit, me të cilin personi ka vënë kontakt.

Ekzistojnë dy lloje të oksidit të uraniumit:

a. ***Në formë të gaztë*** – i cili largohet nga trupi i njeriut përmes djersitjes dhe urinimit.
b. ***Në formë të "gjendjes qeramikë"*** i cili mund të mbetet fizikisht në trup

për një kohë të gjatë. Kjo don të thotë se personi i cili ka qenë në kontakt me këtë formë të oksidit të Uraniumit, përmban në vete një burim të përhershëm të rrezatimit në organizmin e vet, me të gjitha pasojat që sjell ky rrezatim.

Uraniumi nuk është pjesë e oligoelementeve dhe as pjesë e indeve, (qelizave njerëzore). U.V. ka veprim emetimi alfa dhe aftësi të madhe depërtuese. Me veprimin e tij krijohen jone të cilat shpërthejnë c`do membranë, përfshirë edhe materien gjenetike që më vonë bartet te pasardhësi, duke shkaktuar sëmundje malinje dhe shumë sëmundje tjera. U.V. përbën toksinë e cila nxit veprime helmuese në të gjitha pjesët vitale të organizmit të njeriut. Një miligram i U.V., i futur në organizëm, mjafton për të bllokuar punën e veshkëve, kurse 50mg nxit radioaktivitet më të madh se sa doza maksimale e lejuar për punëtorët që punojnë në centralet atomike. Thënë teknikisht, kur radioaktiviteti futet në trup mjafton e dhjeta e tre miliontës pjesë të sekondës për të shkatërruar një elektron të njeriut. Pastaj ky elektron pasi që është negativisht i elektrizuar, len atomin e elektrizuar pozitivisht, duke kryer kështu procesin e quajtur jonizim. Pas kësaj elektroni dhe atomi pasi që bëhën jo stabil, prodhojnë reaksione zinxhirore, kimiko- fizike, duke shkaktuar ndryshime në molekula dhe në trashëgiminë gjenetike të indeve dhe qelizave, dhe nga ky moment mund të përshpejtohet procesi i zhvillimit të kancerit (tumorit). Sipas përvojës së Luftës në ish Jugosllavi, gjegjësisht boshnjakëve, shqiptarëve, serbëve dhe kroatëve të Bosnjës, ka lindur sindromi i quajtur: "Shiu Amerikan". Në të vërtetë personat që kanë pas kontakt me U.V. shumë shpejt ankohen për lodhje kronike, kanë kokëdhembje, djersitje të tepërta dhe frymëmarrje të vështirësuar. Këto vështirësi sipas deklaratave të personave të rrezatuar rriten sidomos gjatë kohës me shi. Ajo që brengos më së shumti është fakti se U. V. është më i rrezikshëm se

uraniumi, sepse i pari oksidohet, tretet në ujë dhe mu për këtë është e domosdoshme që zonat e kontaminuara të dekontaminohen sa më shpejt, para se U. V. të mbërrijë te shtresat e thella të dheut, ose gjer te ujërat nëntokësorë. Si pasojë e veprimit të U. V., pasojnë gjendjet e rënda tek njerëzit siç janë gjendjet:

- Teratogjene
- Mutagjene
- Kancerogjene, etj...

Rritja incidence e sëmundjeve malinje fillon 2-5 vjet pas kontaminimit të parë intern me ushqim dhe ujë.

Në kufirin Kosovë Shqipëri ku ka pasë më shumë goditje me U.V. pastaj, Kosovë – Mali i Zi, Kosovë-Serbi, sipas statistikave jo formale është shënuar një rritje e konsiderueshme e sëmundjeve kancerogjene, sidomos nga kanceri i organeve të frymëmarrjes. Municioni me U.V. e ka ndotur ambientin jetësor dhe mund ta ndërrojë për qindra vite strukturën gjenetike të popullsisë së prekur nga U.V. Shikuar në tërësi është e domosdoshme që me aksione të organizuara dhe të koordinuara në planin global të ruhet dhe të respektohet e drejta e njerëzve që kanë pësuar nga pasojat e veprimit me municion të U.V.

Ku dhe sa është përdorur ky municion?

»Në luftën e Gjirit janë hudhur më shumë se 940.000 copë të municionit me kalibër 30mm, 14.000 copë të kalibrit 105mm, dhe 120mm, që gjithsejtë bëjnë rreth 320 tonelata të U.V«[6]. »Ministria e Mbrojtes së SHBA-ve dhe NATO kanë pranuar se në Kosovë dhe për rreth saj është përdorur ky municion. Faktet precize i din vetëm NATO-ja por dyshohet se janë hudhur afërsisht 30 tonë«[7].

Një pjesë e madhe e U.V është hedhur mbi teritorin e Kosovës. »Thuhet se mbi teritorin e ish Jugosllavisë janë hudhur 13.000 tonë U.V. Sipas disa të dhënave,

[6] Gulf War The Nation, October 21, 1996

[7] **DU** EFFECTS IN **KOSOVO** **UNMIK** INSTITUCIONET E PËRKOHSHMVE VETQEVERISËSE Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor, March 12th, 2001

(Amerikanët vetë e kanë pranuar), në të vërtetë janë hudhur 11.000 tonë të U.V, të këtij nus produkti 235 i cili përdorët si karburant në elektranat nukleare«[8].

Si pasojë e rëndë e bombardimit nuk numërohen vetëm tonelatat e U.V, por edhe tonelatat e materieve kimike të dëmshme dhe kancerogjene të djegura dhe të shpërndara, si psh: merkuri, dioksinet, kerozina e djegur, (trafot e djegura), halonet dhe të gjitha këto, janë pasoja shtesë e bombardimeve, të cilat kanë dëmtuar seriozisht njerëzit dhe ambientin që i rrethon, më shumë se sa është folur apo pranuar botërisht.

Se a është më i rëndësishëm veprimi kimik apo radioaktivi U.V. në njerëz

Duhet te vërtetohet nese veprimi dëmtues i U.V. –se është bërë nga ana e jashtme apo edhe e brendshme e rrezatimit. Rrezatimi i jashtëm është i rëndësishëm, para së gjithash, në rastet kur tërë gjilpëra goditëse ose një pjesë e saj gjendet në afërsi të njerëzve. Nëqoftëse një gjilpërë e tillë vie në kontakt me lëkurën, për shkak të prezencës së rrezatimit alfa dhe beta, janë të mundshme ndryshimet në lëkurë. Këto raste janë të rralla dhe ka mundësi tu iket.

Rrezatimit të brendshëm vështirë se mund ti iket dhe është shumë më i rezikshëm. Rreziku primar vie nga thithja thërmive në rrethinën e afërtë të objektit të goditur. Sidoqoftë, duhet pasë parasysh se thërmiat e imëta të uranit futen në dhe dhe në ujë, kështu në mënyrë indirekte dhe vazhdimisht kontaminojnë tërë zinxhirin e gjërave ushqimore. Gjysmë koha e shkrirjes së Uranit të varfëruar është 4.5 miliardë vite, që praktikisht don të thotë se nëse një herë është shpërndarë urani, aty do të mbetet përjetësisht. U.V mës së shumti futet në organizmin e ushtarëve dhe njerëzve të cilët kanë qenë në afërsi të vendit dhe momentit të goditjes. Është e mundur që në ato momente dhe raste mund të thithen deri në 100 gram U.V. nëse njëherë futet në organizëm, U.V.,në kontaktin direkt së pari rrezikon indet, mëlqinë, veshkët, por edhe organet tjera vitale, sidomos mushkëritë, palcën kurrizore,etj. Pasojat e radiologjike dhe

[8] Sweeping the Truth Under the DU Rug NATO Use of Depleted Uranium in the War Against Yugoslavia by Dr. Vladimir Ajdacic & Dr. Predrag Jaksic - **November 26, 2001**

toksike mund të kërcënojnë me rrezikun e kancerit. Ky rrezik përbën 5% siver (0.05. milisiver). Në fazat e më vonshme, pas goditjes, sidomos gjat sanimit të pasojave, nuk përjashtohen thithja shtesë e thërmive në rrethinën e vendit të goditur. Arsye mund të jetë ngritja e pluhurit radioaktiv nga dheu si pasojë e ndonjë fryme ose të lëvizjes së automjeteve. Dozat ekvivalente në këto raste mund të jenë të vogla dhe vështirë se mund të kalojnë një të dhjetën e mikrosiverit. Nëqoftëse caku nuk është goditur, një përqindje e vogël e U.V do të shndërrohet në gjendje të ngurtë aerosole. Urani në formë metali do të gjendet në dhe dhe në këtë rast është i mundshëm reaksioni me ujin. Varësisht nga situata gjeologjike është lehtë e mundshme ndotja e edhe e ujrave nëntokësorë. Kjo duhet të kihet prasysh në secilin lokacion veq e veq.

NATO Vërteton Detajet e Përdorimit të U.V. Në Kosovë

»Në letrën e datës 7 shkurt të vitit 2000, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lordi Robertson i konfirmon Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve te Bashkuara, z.Kofi Anan, detajet e përdorimit të municionit me U.V. në luftën e vitit 1999 në Kosovë. Predhat me U.V. janë përdorur sa herë që janë angazhuar forcat e blinduara A-10 gjat operacioneve të forcës Aleate dhe janë përdorur gjithandej në Kosovë përafërsisht gjat 100 misioneve. Gjylet GAU-8 /A API janë të destinuara për PGU-13/B dhe përmbajnër projektile aerodinamike me nën-kalibrim, me energji Kinetike depërtuese të mekanizuar nga U.V, produkt ky, jo kritik i procesit të rafinimit të Uraniumit. A - 10 shfrytëzon predha të U. V- së si pjesë të mbushjes së tyre standarde. Sasia e përafërt prej 31.000 predhave të municionit me U.V. janë përdor në operacionet e forcave aleate.« [9] Përqëndrimi kryesor i këtyre operacioneve ka qenë në një zonë, në përendim të rrugës: Pejë – Deqan, në zonën për rreth Klinës, në zonën për rreth Prizrenit dhe në një zonë në veri të vijës që lidh Therandën (Suharekën), me Ferizajin. Sidoqoftë, shumë

[9] **NATO reveals Kosovo depleted uranium use USAF A-10 planes fired DU munitions Wednesday, 22 March, 2000 By environment correspondent Alex Kirby, Nuc News - September 11, 2000**

misione ku është përdor municion U.V. janë zhvilluar edhe jashtë këtyre zonave të përmendura. Në këtë moment është e pamundur për të caktuar saktësisht ç`do lokacion ku është përdorur municioni me U.V. Më poshtë, bashkangjitur është harta e cila ofron informacionet më të mira në dispozicion, për lokacionet ku është përdorur municioni me U.V.

Janë hudhur gjithsejtë 31.000 predha me nga 271 g., që përmbajnë gjithsejtë 8401 kg. të Uraniumit të Varfëruar

Figura 1. Lloji i Aeroplanit bombardues A-10, me U.V. i cili ka bombarduar forcat Serbe në Kosovë

HARTE E VENDEVE TË CILAT JANË IDENTIFIKUAR SI CAÇE ARTILERIKE ME PËRMBAJTJE TË U. V. KOMBET E BASHKUARA (UNDP- NATO)

VENDET TË CILAT JANË IDENTIFIKUAR SI CAÇE ARTILERIKE ME PËRMBAJTJE TË U. V. PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR AMBIENTIN (PKMA-UNEP)



UNIVERSITETI I BRISTOLIT

RAPORTI FINAL

"PROGRAMI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR AMBIENTIN (PKBA) PËR CAÇET E GODITURA ME URANIUM TË VARFËRUAR GJAT LUFTËS NË KOSOVË"[10]

URANIUMI I VARFËRUAR (U. V), RAPORTI FINAL:

Qëllimet e Misionit Vlerësues në Kosovë

Misioni 2 javor (5-17 nëntor), i PKBMA-së kishte për detyrë të përcaktonte nëse përdorimi i U. V.- së gjatë luftërave në Ballkan mund të kishte sjellë ndonjë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Përbërja e Ekipit

Ekipi i Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambientin (PKBA-UNEP-it) përbëhej prej 14 shkencëtarëve nga: Instituti i Mbrojtjes Radioaktive të Suedisë, Agjensioni Ndërkombëtar i Energjisë Atomike, Universiteti i Bristolit, Departamenti i Shkencave Mjekësore, AC Laboratori – Spiez (Zvicër), Agjensioni Kombëtar Italian për Mbrojtjen e Mjedisit (ANPA), Qendra e Ushtrisë Amerikane për Promovimin e Shëndetit dhe Mjekësisë Preventive, Instituti Finlandez i Punëve të Brendshme dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Ambientit.

Cilat vende duhej të identifikoheshin e që ishin si caqe artilerie të kontaminuara me U. V., gjatë luftës në Kosovë?

Gjithsejtë janë kryer 112 sulme me Aeroplan gjuajtës A-10 por disa caqe janë goditur nga dy herë.

Sa fusha (caqe) i kishte vizituar ekipi i UNEP-it gjatë misionit në Kosovë?

[10] **Relief Web report** — *http://reliefweb.int/node/73842* UNEP Depleted Uranium Missions

Ekipi i UNEP-it kishte vizituar gjithsejtë 11 vende, 5 në sektorin Italian dhe 6 në sektorin Gjerman të KFOR-it.

Vendet ku u morën mostrat:

Sektori Italiani i KFOR-it

1. Garnizoni i Gjakovës (garnizon i mbyllur i ish A. J);
2. Barakat e Irzniqit, (barakat ish A. J. Deçan);
3. Bregu i Vranovcit: kodër afër këtij fshati (Deçan);
4. Liqeni i Radoniqit: liqe artificial në veri të qytetit të Gjakovës;
5. Bandera/Pozhar: fshat afër bregut të lumit (Deçan);

Sektori gjerman i KFOR-it

1. Rikavac:Lokacioni gjendet në rrugën e asfaltuar,në fushën në të dy anët e rrugës dhe në një ndërtesë më larg (Prizren);
2. Mali Ceja: Cak i goditur me 5 qershor në pozicionet e njësisë kundërajrore të Ushtrisë Jugosllave, në një kodër mali (Prizren);
3. Fshati Plane (Prizren), Lokacion afër fshatit Plane në anën e pjerrtë të Pashtrikut që gjendet në kufirin mes Shqipërisë dhe Kosovës;
4. Belobrad – Sharr (Dragash), cak i NATO-s i goditur me 15 Maj 1999. Pjesët e artilerive gjenden në të dy anët e rrugës;
5. Buzec – Sharr (Dragash), Lokacioni gjendet në drejtim të fshatit Buzec në fushën në të dy anët e rrugës;
6. Fshati Kuk (Kokouce), Sharr (Dragash), Caku i goditur gjendet në kodrën e malit në një lartësi mbidetare përafërsisht 1,500 metra;

CAÇET E VIZITUARA (MARRJA E MOSTRAVE) NGA P. K. B. P. M. A. (UNEP)
EKIPI I UNEP-it GJATË MSIONIT TË TIJ NË KOSOVË

Legjenda:

1. Garnizoni i Gjakovës (garnizon i mbyllur i ish A. J).
2. Barakat e Irzniqit, (barakat ish A.J. Deqan).
3. Bregu i Vranovcit: kodër afër këtij fshati (Deqan).
4. Liqeni I Radoniqit: liqe artificial në veri të Gjakovës.
5. Bandera/Pozhar: fshat afër bregut të lumit (Deqan).
6. Rikavac lokacioni gjendet në rrugën e asfaltuar
7. Mali Ceja: Cak i njësisë kundërajrore të U. J, në një kod
8. Fshati Plane (Prizren), Lokacion afër fshatit Plane
9. Belobrad – Sharr (Dragash), cak i Natos i goditur me 15
10. Buzec – Sharr (Dragash),
11. Fshati Kuk (Kokouce), Sharr (Dragash),

Çfarë dhe sa lloje mostrash u mblodhën?

" Në këto vende u mblodhën mostra të dheut dhe të ujit. Mostrat e dheut janë nxjerr nga thellësitë dhe lokacionet e ndryshme., uji është marrë nga përrojet lumenjtë dhe puset e fermave. Janë marrë edhe mostra të ndryshme nga bari, drunjtë, frutat, dhe këpurdhat. Në tri punkte qumështi është marrë drejtpërdrejtë nga lopetnga lopët. Kurse testi i kontaminimit është bërë në ndërtesa, automjetet e shkatërruara ushtarake dhe nga penetratorët e gjetur. Janë mbledhur gjithsejtë 340 mostra:247 mostra dheu, 45 mostra uji,30 mostra të vegjetacionit, 10 teste të ndotjes, 5 mbështjellës, 7 penetratorë,dhe 1(një) fragment (pjesë penetratori). Penetratorët dhe mbështjellësit janë pjesë të veçanta artilerie"[11].

Çka është penetratori?

"Është pjesë e metaltë e uraniumit të varfëruar, në formë të lapsit të mprehur, 9 cm i gjatë dhe me diametër 0.9 cm. Metal me densitet (19 g/cm cub, ose 19 herë më i dendur se uji, metal shumë i dendur) që ka mundësi të përshkojë blindimin e lartë, dhe kjo është arsyeja pse U. V . përdorët si municion"[12].

Çka përmbanin këto mostra dhe pse u analizuan?

[11] **Relief Web report** — *http://reliefweb.int/node/73842* UNEP Depleted Uranium Missions

[12] Nuclear Metals Inc., brochure. Depleted Uranium Ordnance.

U.S. Army training document. Depleted Uranium Training for Chemical Soldiers. TA-031-DUAT-003. http://www.wood.army.mil/84chem/HHC/TTD/Rad%20Trng/NEW%20DU%20Tier%20III%20TSP%20991115.doc

“Mostrat e dheut u analizuan për izotopet e uraniumit, uraniumit total dhe toriumit. Këto mostra u analizuan edhe për shkak të elementeve trans uranium dhe nxehtësisë. Mostrat e ujit u analizuan për uraniumin total, izotopet e uraniumit, pH-së, EH-së, dhe për elementet e mëdha të gjurmëve, përfshirë (alkalitetin - bazën), kurse penetratorët ishin analizuar për izotopet e uraniumit”[13].

Çka është gjetur nga laboratori i kërkimeve në universitetin e Bristolit?

Ata kishin gjetur se pjesa më e madhe e mostrave të dheut kishin uranium të koncentruar brenda koncetrimit normal të ambientit. (1-300 mg/kg). Vetëm një sasi e vogël e mostrave kanë lartësi të ultë të koncetrimit me uranium dhe kjo ndodh vetëm në kontakt të drejtpërdrejtë me penetratorin. “Izotopet e analizuara të uraniumit, tregojnë se uraniumi i varfëruar përmban: 0.2 % të Uraniumit 235. Uraniumi i varfëruar gjithashtu ka gjurmë të koncetrimit U236 dhe të plutoniumit 239PU dhe 240PU dhe ka indikacione se ky metal është prodhuar nga karburantet nukleare. Ky koncetrim, nganjëherë është më i ultë se 236U dhe se plutoniumi, dhe vijon të jetë më shumë se 1% në kufi me radioaktivitetin e metalit,0.2%235U.”[14]

Cilat janë implikimet për mjedisin?

Sipërfaqet e kontaminuara në këto fusha janë të vogla, të parëndësishme dhe nuk janë kërcënuese për mjedisin. Megjithatë ka lokacione që përmbajnë mbi 600kg. të U. V.(2000 gjyle) të U. V. dhe ka të ngjarë që ujërat nëntokësorë të kontaminohen në të ardhmen. Në këto vende mund të ndodh numër i reaksioneve natyrore të cilat mund të ndeshen dhe ngadalësojnë lëvizjen e Uraniumit.

[13] **Relief Web report** — *http://reliefweb.int/node/73842* UNEP Depleted Uranium Missions
[14] Po aty

Qka ndodh me rastin e goditjes së municionit apo raketës me U.V. në cak?

Përveq veprimit të thjeshtë mekanik,municioni me uranium të varfëruar, për shkak të radioaktivitetit të Uraniumit, ka dhe veprim radiologjik në njerëz, si dhe ndikim në ambientin jetësor.

Për vlerësimin e këtij veprimi është me interes të dijmë se çka ka ndodhur me gjilpërën goditëse në momentin e goditjes në cakun e fortë, siq është tanku, ose strukturat e betonarmesë. Në këtë rast në vendet e goditura paraqiten:

- Mbeturina të mëdha (dhjetë gramëshe) të pjesëve të gjilpërës goditëse;
- Mbeturina të pakta (gramëshe) të pjesëve të gjilpërës goditëse;
- Thërmitë e mëdha (mbi 10 mikronë), dhe
- Thërmitë Aerosole si pasojë e djegijes së pjesëve të gjilpërës goditëse.

Tri Thërmitë e para janë të përbëra nga urani metal (me shtesë të metaleve të rralla), që janë relativisht të rënda dhe bijnë në largësi të afërtë (dhjetë metra). Këto thërmi mund të reagojnë intenzivisht me gjërat e lëngëta në rrethinë dhe në këtë mënyrë ndotin ujrat sipërfaqësor dhe nëntokësorë si dhe vetë tokën (dheun). Në rast të goditjes së cakut, në vendin e goditjes, paraqiten temperatura të larta gjer në 1200 C. Urani metalik ndizet në temperaturë prej 700.gradë celzius. Pjesë të gjilpërës goditëse (5-70%) ndizen dhe kështu krijohen: dioksidi i uranit, trioksidi i uranit, dhe U_3O_8.

Pas ftohjes së shpejtë, vie deri te procesi i formimit të Aerosoleve, gjegjësisht shëndrrimi në mjegull uraniumi të imtë. Pjesa më e madhe e këtyre thërmive është shumë e vogël dhe ka një –prag nën 2.5 mikronë. Procesi i ftofjes është i tillë, që kjo mjegull e uraniumit ka thërmi në formë keramike të cilat kanë shkrirje të vogël në ujë dhe hidratet e trupit. Nga kjo edhe varet shumë mekanizmi i veprimeve të këtyre aerosoleve në botën e gjallë. Pjesa më e madhe e thërmive të krijuara bie në tokë, afërsisht rreth vendit të goditjes. Në largësi më shumë se 200 metra, numri i tyre është më i vogël, edhe pse me matje precize mund të konstatohet prezenca e tyre edhe në largësitë prej dhjetëra kilometrash, sepse

bazuar në dimenzionin (madhësinë) e tyre, thërmitë mund të barten lehtë nga era.

A është më i rrezikshëm në njerëz veprimi kimik apo radioaktiv i U.V-së?

Veprimi dëmtues i U.V. mund të bëhet nga ana e jashtme dhe e brendshme e rrezatimit. Rrezatimi i jashtëm është i rëndësishëm, para së gjithash, në rastet kur tërë gjilpëra goditëse ose një pjesë e saj gjendet në afërsi të njerëzve. Nëqoftëse një gjilpërë e tillë vie në kontakt me lëkurën, për shkak të prezencës së rrezatimit alfa dhe beta, janë të mundshme ndryshimet në lëkurë. Këto raste janë të rralla dhe ka mundësi tu iket.

Rrezatimit të brendshëm vështirë se mund ti iket dhe është shumë më i rezikshëm. Rreziku primar vie nga thithja e (thërmive) në rrethinën e afërtë të objektit të goditur. Sidoqoftë, duhet pasë parasysh se thërmiat e imëta të uranit futen në dhe dhe në ujë, kështu që në mënyrë indirekte dhe vazhdimisht kontaminojnë tërë zinxhirin e gjërave ushqimore. Gjysmë koha e shkrirjes së Uranit të varfëruar është 4.5 miliardë vite, që praktikisht don të thotë se nëse një herë është shpërndarë urani, aty do të mbetet përjetësisht. U.V më së shumti futet në organizmin e ushtarëve dhe njerëzve të cilët kanë qenë në afërsi të vendit dhe momentit të goditjes. Është e mundur që në ato momente dhe raste mund të thithen deri në 100 gram U.V. Nëse njëherë futet në organizëm, U.V.,në kontaktin direkt së pari rrezikon indet, mëlqinë, veshkët por edhe organet tjera vitale, sidomos mushkëritë, palcën kurrizore, etj. Aerosolet e thithura kanë komponentën e tretshmërisë dhe jo të rritjes. Nga komponentet zbërthyese të U.V., ndodhin pasojat akute të nxitura nga hemotoksiniteti i uranit, gjegjësisht pasojat e helmimit. Pasojat radiologjike dhe toksike mund të kërcënojnë me rrezikun e kancerit. Ky rrezik përbën 5% siver (0.05. milisiver). Si krahasim mund të marrim se rreziku i përgjithshëm i vdekshmërisë nga kanceri përbën 20%.të rasteve. Në fazat e mëvonshme, pas goditjes, sidomos gjat sanimit të pasojave, nuk përjashtohet thithja shtesë e thërmive në rrethinën e vendit të goditur. Arsye mund të jetë ngritja e pluhurit radioaktiv nga dheu, si pasojë e ndonjë fryme ose të lëvizjes së automjeteve. Dozat ekvivalente në këto raste mund të jenë të vogla

dhe vështirë se mund të kalojnë një të dhjetën e mikrosiverit. Nëqoftëse caku nuk është goditur, një përqindje e vogël e U.V do të shndërrohet në gjendje të ngurtë aerosole. Urani në formë metali do të gjendet në dhe dhe në këtë rast është i mundshëm reaksioni me ujin. Varësisht nga situata gjeologjike është lehtë e mundshme ndotja edhe e ujrave nëntokësorë. Kjo duhët të kihet prasysh në secilin lokacion veq e veq.

Resurset Natyrore

»Sipas dëshmive të profesor Kader Azmalit, ish ministër për burimet ujore dhe pasuritë pyjore në Qeverinë e Republikës Jug Afrikane, i cili ishte mysafir në Konferencën Botërore për ruajtjen e resurseve natyrore, nën organizimin e Fondacionit Rojters, në Londër, organizuar në vitin 1994«[15], atëherë ai ishte habitur nga fakti se paisjet më moderne për matjen e dhe kontrollin e ujrave nëntokësorë për tërë Evropën, saktësisht, kishin përcaktuar dy vende nga ish Jugosllavia: Regjionin e Liqejve të Plitvicës dhe pjesë nga ujrat nëntokësor të Kosovës«[16]. Kur është fjala për rrjedhat ujore nëntokësore në Kosovë, është shumë i rëndësishëm drejtimi i këtyre rrjedhave, gravitim dhe derdhja e tyre. Këto të dhëna mund të na tregojnë dëmin real për ambientin jetësor si pasojë e U.V., jo vetëm në Kosovë, Ballkan por edhe në Evropë.

Të gjitha këto fakte është mirë të verifikohen shkencërisht me analizimin e mostrave nga vendet e goditura, përndryshe mund të përballemi me fenomenin e imunodeficitit tek popullata e zonave të goditura me U.V.

Nëqoftëse këto supozime verifikohen si të sakta (megjithëse jemi vonuar shumë), për ç`do ditë mund të rritet rreziku kancerogjen, kriptorhizmi si sëmundje mashkullore dhe steriliteti tek femrat.

Hidrologjia

Po japim më poshtë një hartë hidrologjike të Kosovës me të dhëna, si shembull krahasues për dëmin eventual dhe të mundshëm të U.V. në ujrat sipërfaqësor dhe nëntokësor të Kosovës. Në Kosovë ka shumë lumenjë që rrjedhin në drejtim

[15] Wednesday, July 14, 1999 Published at 14:44 GMT 15:44 UK **World Kosovo waterways bombing a 'war crime' By News Online's Alex Kirby**

[16] Po aty

të Detit Adriatik, Detit të Zi dhe Detit Egje. Lumenjtë kryesorë të Kosovës janë: Drini i Bardhë (në pjesën jugore të Kosovës – derdhet në Detin Adriatik), Lumi i Ibrit (në pjesën veri perëndimore, derdhet në lumin Morava dhe Danub, e më tej në Detin e Zi), lumi Lepenc (i cili në pjesën jug lindore derdhet në lumin Vardar dhe në detin Egje). Është shumë interesant fakti që Deti i Zi është i drenuar nga ujrat nga një sipërfaqe e zonës ujëmbledhëse prej 5500 km², ose 51 % të territorit të Kosovës, Deti Adriatik është i drenuar nga nje zonë prej 4500 km² ose 43 %, dhe Deti Egje është i drenuar nga një zonë vetëm 900 km² ose 6 %

Kurrizoret Ujëndarëse

Kurrizoret ujëndarëse të tri drenazheve kryesore (Drini i Bardhë, lumi i Ibrit dhe Lepencit) takohen me njëri – tjetrin afërsisht 16.5 km në perëndim të Ferizajt, në zonën kadastrale të Budakovës, komuna e Therandës (Suharekës). Në këtë pikë kontakti të tre kurrizoreve ujëndarëse, ndodhet Mali i Dermanit në lartesi 1,359 m. mbi nivelin e detit. Prej kësaj pike, sipërfaqja ujore derdhet në drejtim të Detit Adriatik, Detit të Zi ose Detit Egje.

Lumenjë të tjerë të rëndësishëm në Kosovë janë: Lumi i Sitnicës, Morava e Binçës, Bistrica e Pejës dhe Bistrica e Deçanit. Kosova gjithashtu ka një numër të madh burimesh karstike, burime të ujrave termale dhe minerale, lugina akullnajore dhe liqene natyrale dhe artificiale.

Cilat janë rreziqet – implikimet nga U.V., për shëndetin e popullatës?

Nëse uji pijshëm në të ardhmen nuk kontaminohet implikimet për shëndetin e popullit nuk janë të rrezikshme nga U. V. Ka shumë rekomandime për mënyrat e monitorimit të ujërave nëntokësorë dhe se si të behën analizat për uraniumin në përgjithësi, në të ardhmen.

Kush duhet ta vlerësojë rrezikun

E vërteta e plotë dhe vlerësimi i saktë i rrezikut mund të bëhen, vetëm atëherë kur të kemi të dhëna të plota mbi veprimet, kualitetin, kuantitetin, numrin e saktë të fluturimeve, pajisjet mbrojtëse për fluturaket luftarake etj.

Nga ana e jonë, për faktet me interes të bombardimeve dhe luftës në Kosovë mund të flasin njerëzit e kualifikuar si:

- Ekspertët ushtarakë
- Ekspertët mjekësorë
- Ekspertët ekologjikë,
- Banorët e vendbanimeve ku kanë rënë bombat, si dhe punëtorët shkencorë të profileve:
    - Bujqësi-agronomi
    - Hidrologji
    - Kimi
    - Teknologji
    - Shoqatat Joqeveritare Ekologjike
    - Personat e Trajnuar për Situata Post Radioaktive

Nga gjithë këta njerëz të pregaditur, kërkohet që në mënyrë të organizuar të fillojnë punën për vlerësimin e shkallës së rrezikshmerisë dhe sanimin e gjendjes. Këta ekspertë të organizuar në formë komisioni apo në ndonjë formë

tjetër, duhet që, përveq vlerësimit të rrezikshmerisë, të vlerësojnë dëmet dhe të kërkojnë kompensimin e dëmeve të shkaktuara.

Identifikimi i Lokacioneve të Goditura me U.V., dhe Siguria e tyre

Prioritet është çështja e identifikimit të lokacioneve, vendosja e shenjave identifikuese të shkallës së rrezikshmërisë dhe ruajtja e tyre rigoroze.Informimi i mirë i qytetarëve, që ata dhe kafshët e tyre të mos futen në zonat e kontaminuara dhe tu ndalohet rreptësisht ndërtimi në, dhe afër këtyre zonave.

Po jetojmë në kohën kur ruajtja e ambientit jetësor është bërë çështje jetike, shkencë, drejtim politik dhe problem kryesor në sferën ekonomike, prandaj nëqoftëse nuk i gjejmë faktet dhe të dhënat që rrezikojnë jetën e qytetarëve tanë, jemi bashkëpjesmarrës të shkatërrimit gjenetik dhe ekologjik për shekuj me rradhë.

Si ta identifikojmë municionin me U.V., dhe mbetjet e tij ?

Gjilpërat goditëse nga municioni me U.V, janë në formë të cigares, rreth 30cm. të gjata. Ato mund të jenë të deformuara lehtë ose në disa pjesë, nga goditja. Nga njëherë në njërën anë mund të gjenden edhe mbetje të bartësit nga alumini në të cilin gjendet gjilpëra. Këto gjilpëra janë prej uraniumit të varfëruar. Duke pasë parasysh se vetëm 25% të granatave godisin cakun, pjesët e këtij municioni mund të gjenden rreth vendit të goditur, ose në sipërfaqe ose edhe të futura nën sipërfaqen e tokës (dheut).

SI TË SILLEMI?

Rregulla të përgjithshme :

- ✓ *Mos ofrohi te vendet e bombarduara;*
- ✓ *Bëni një shenjë të përkohshme vendit ku janë pjesët*
- ✓ *Mos mblidhni prodhime dhe barishte afër vendeve të goditura;*
- ✓ *Mos i kullosni kafshët, as mos shfrytëzoni ujin afër vendit të mundshëm të kontaminuar, qoftë nga uji sipërfaqësor apo nga pusi;*

- ✓ *Ndaloni fëmijtë të mos luajnë rreth vendit të goditur;*
- ✓ *Mos e punoni tokën e cila mund të jetë e kontaminuar;*
- ✓ *Mbani higjienë kur të lëvizni afër vendit të goditur;*

Nëqoftëse kemi gjetur pjesë të U.V:

- ✓ *Mos i prekni këto pjesë;*
- ✓ *Në shtëpi menjëherë lahuni mirë dhe detajisht ndërroni rrobat;*
- ✓ *Lajmëroni policinë ose FSK-në për (rastin), gjetjet;*
- ✓ *Lajmëroni fqinjët.*

Nëqoftëse mendoni se jeni kontaminuar me U.V:

- ✓ *Menjëherë lajmërohuni te mjeku më i afërtë dhe kërkoni kontrollë adekuate;*
- ✓ *Njoftoni organet ligjore për vendin dhe mënyrën se si jeni kontaminuar.*

Qka të kërkoni:

Insistoni që të keni ne dispozicion të gjitha të dhënat e kontaminimit në rrethinën tuaj, sipas ligjeve për mbrojtje nga rrezatimi jonizues, dhe udhëzuesi për veprim në situata të jashtëzakonshme. Organet zyrtare janë të obliguara që ti paraqesin këto të dhëna.

Kërkoni që të bëhet një matje precize dhe reale e ndotjes nukleare në rrethinën tuaj, për përpërmbajtjen e uraniumit në mostrat e dheut. Kështu do të jeni të sigurtë se a ka dhe sa është real rreziku. Insistoni që të dhënat të bëhen publike.

MATJET

Ekzistojnë dy lloje të matjeve: Prospekti i terenit për të përcaktuar lokacionin, matjet e shkallës së radioaktivitetit dhe përbërjes së uraniumit në mostrat e dheut, ushqimit, ujit, ajrit, vegjetacionit, prodhimeve te qumshtit etj.. Mund të bëhen matje përmes shumë metodash: spektrometria gama (më e shpeshtë dhe më e thjeshtë), spektrometria Alfa, radiometria Alfa, analiza aktive e neutroneve (më e ndijshme), spektroskopia masive etj.

VËREJTE

Thithja e thërmive të U.V mund të ketë pasoja afatgjata në shëndet, përfshirë sëmundjet nga kanceri, deformimet gjenetike të posalindurve, sëmundjet neurologjike, sëmundjet e veshkëve, dhe dëmtimet e sistemit imunologjik. Këto efekte mund të lajmërohen disa vite pas kontaminimit.

Dekontaminimi (Sanimi Ekologjik)

Dekontaminimi (Sanimi) ekologjik duhet të bëhet çështje jetike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe si çështje imediate, sepse nëse nuk fillojnë sa më shpejt veprimet e duhura, ndotjet ndërshtetërore do të përhapen në tërë Ballkanin dhe më gjërë. Për të parandaluar efektet pasuese dhe për të zbutur sadopak dëmët tani më të shkaktuara, duhet të kryhen këto veprime:

- Vlerësimi i shtrirjes së goditjeve me U.V;
- Numri i goditjeve dhe sasia;
- Marrja e mostrave në të gjitha pikat e goditura;
- Vlerësimi i shkallës së kontaminimit;
- Plani Aksional për dekontaminim, sanim dhe eleminimin e mbetjeve;.
- Monitorim permanent;

Perveq institucioneve nderkombetare duhet te caktohet edhe një ekip vendor për të përfituar eksperiencën e nevojshme dhe për të bërë krahasimin e të dhënave.
Në këto grupe si në aspektin planifikues ashtu edhe në atë zbatues duhet të marrin pjesë:

- Forca e Sigurisë së Kosovës;
- Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore;
- Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë;
- Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- KFOR- i;
- OJQ-të;
- Fondacionet Ndërkombëtare;
- Organizatat Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Ambientit Jetësor etj.

Për të zgjidhur apo sanuar këtë problem të madh dhe jetik, është i nevojshëm mobilizimi dhe senzibilizimi i i gjithë spektrit shoqëror në Kosovë, si dhe faktorit ndërkombëtar, sepse kufijtë gjeografik të shtrirjes së pasojave nuk ekzistojnë.
Për të bërë detektimin, dekontaminimin dhe sanimin e sipërfaqeve të kontaminuara nga substancat e ndryshme të rrezikshme, është e nevojshme që të kompletohen të dhëna të sakta dhe të:

- Përcaktohen lokacionet;
- Vendosen në harta;
- Caktohet perimetri i sigurisë;
- Senzibilizohet opinioni publik si dhe duhet të;

njoftohen dhe kërkohet ndihmë nga këto organizata:

- Programi i OKB-së për ruajtjen e ambientit jetësor;
- Programi për ruajtjen e mbështjellësit të ozonit;
- Fondi Multilateral për realizimin e protokollit të marëveshjes së Montrealit;
- Organizatat Ballkanike;
- Institucionet Shkencore Europiane dhe Amerikane;

Përmbledhje:

Shumë Organizata Ndërkombëtare duke përfshirë edhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Ambientin (PKBA-UNEP-in), kanë dërguar ekipe dhe ekspertë në vendin e ngjarjes duke i ngarkuar me detyra për të raportuar dhe vlerësuar ndikimin e U.V-së në shëndetin dhe mjedisin jetesor. Sidoqoftë mbetet detyrë parësore e qeverisë që përveq monitorimit permanent, të krijoj ekipe specialistësh që të punojnë vazhdimisht në këtë çështje, në aspektin e detektimit, dekontaminimit, sanimit, eleminimit, dhe analizave gjithëpërfshirëse.

Shtator 2007.

KOSOVA DHE "RREZIQET E PAVARËSISË"

Tani më Kosova po përgatitet për të “fituar Pavarësinë” e dizajnuar sipas Marti Ahtisarit edhe pse kjo është një “pavarësi “ e varur, megjithatë sfidat dhe rreziqet si brenda Kosovës ashtu edhe nga jashtë do të jenë të mëdha dhe të ndryshme.

Qysh nga fillimi i bisedimeve shtesë, nën udhëheqjen e treshes ndërkombëtare: Ishinger, Harqenko, Vizner, Serbia nuk ka pushuar të lansojë deklarata nga më të ndryshmet dhe shpesh edhe kontradiktore, për planet sekrete dhe të hapura të saj, kundër pavarësisë së Kosovës. Këto deklarata sikur se mos të drejtoheshin kundër një populli, shpesh do të mund të cilësoheshin edhe si qesharake. Aty ku planifikuesit serbë të të gjitha strukturave dhe shërbimeve mbeten mbrapa, në ndihmë ju vijnë zyrtarët e lartë rusë. Serbët kërcënojnë me embargo, mbyllje kufijsh, thirrje për luftë, bisedime për kompromis, kurse rusët kërcënojnë me lëvizje stihike të pakontrolluara të kufijve në Ballkan, Evropë dhe botë, për herë të parë pas luftës së dytë botërore siç thonë ata, nëse këtë pavarësi e pranojnë Evropa dhe Amerika. Zyrtarët Serbë haptas kanë bërë thirrje për vendosjen e bazave ushtarake Ruse në lumin Drina, ku do të vendosej nga një raketë me kokë bërthamore e drejtuar nga secili kryeqytet Evropian!

Cilët janë skenarët e Serbisë dhe parashikimet pas pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës?

- Veriu i Kosovës do të ndahet duke u thirr në rezolutën 1244;
- Enklavat fillimisht do të barikadohen dhe izolohen duke mobilizuar pleq, fëmijë dhe gra, gjoja në mbrojtje të sovranitetit serb;
- Shpallja e autonomisë serbe në rajonin e Shtërpcës,Brezovicës dhe pjesës veriore;
- Shpallja e Autonomisë Gorane në fshatrat e Sharit (Dragash 13 fshatra të Kosovës dhe 6 të Shqipërisë) për këtë dëshmon hapja e Zyrës Koordinuese të Qeverisë së Serbisë në Sharr, njëkohësisht me hapjen e saj në veri të Mitrovicës dhe Kërkesa e Nazif Dokles për "Autonomi Gorare"[17] bërë në fillim të vitit 2007, UNMIK-ut, Qeverisë Shqiptare, Qeverisë Bullgare, asaj Maqedonase etj.

Alternativa tjetër e skenarit serb është barrikadimi dhe mospranimi i realitetit të ri të Serbëve nga Shtërpca, dhe mundësia e lëvizjes së tyre në drejtim të lindjes me pikë koncetrimi Kamenicën, si qendër e enklavës së lindjes. Dhe këtu

[17] 13 March 2007 | 18:33 | FOCUS News Agency

qëndron rreziku i konfrontimit në mes tyre dhe shqiptarëve nga lugina e Preshevës në rast të një shpërnguljeje të tyre të dhunshme (e pritur). Mundësia e sulmeve terroriste në objektet me rëndësi vitale:

- Parlamenti;
- Qeveria,
- Hidrosistemet;
- Elektroenergjetika;
- Shkollat etj;
- Shantazhimi me ujin e liqenit të Ujmanit (Gazivodës) etj.

Rreziqet nga jashtë - Parashikimet:

- Thirrjet për vendosjen e bazave ushtarake ruse në Serbi
- Vizitat e shpeshta të zyrtarëve Serbë në zonën tokësore të sigurisë në kufi me Kosovën (Lugina e Preshevës).
- Pranimi me konkurs i 700 pjesëtarëve (ushtarëve me pagesë në këtë zonë tokësore të sigurisë).
- Ndërtimi bazës së madhe ushtarake 34 Km2 në Cepotin, afër kufirit me Kosovën.

Sipas gazetës frënge "Le Mond", tri janë kërcënimet kryesore jo vetëm për Kosovën por edhe për SHBA-në dhe Kombet e Bashkuara:

1. Frikësimi Rus;
2. Hakmarrja Serbe dhe
3. Armatosja e sërishme e Shqiptarëve.

Si do të Reagojnë Strukturat e Sigurisë në Kosovë?

KFOR-i ka për detyrë që të sigurojë kufijtë gjegjësisht brezin kufitar me Serbinë që nuk është edhe aq i shkurtër, pra është një distancë që do të sfidojë ushtarët e KFOR-it jo me forca të rregullta ushtarake por ndoshta me njësi dhe grupe të vogla manovruese terroristësh. Me gjasë KFOR-i do të jetë i detyruar të bashkëpunojë dhe koordinojë ngusht me TMK-në, por shtrohet pyetja si dhe sa do të jetë efektiv ky koordinim në rastin më të keq? Sigurinë e Brendshme do ta menaxhojnë SHPK-ja dhe Policia e UNMIK-ut. Këto dy segmente do ta kenë të vështirë kordinimin në mes vete sepse kjo është dëshmuar disa herë dhe arsye

tjetër kryesore është se këto dy segmente do të përballen me situata shumë të nxehta në brendi të Kosovës, kështu që mundësia për dështim do të jetë shumë e madhe.

Politika:

Ka informacione se të gjitha strukturat e sigurisë në Kosovë janë duke hartuar plane veprimi, përfshirë edhe qeverinë e Kosovës, por moskonstituimi i organeve të reja qeveritare dhe vonesat në këtë drejtim do të ndikojnë që planifikimi të mbetet në gjysmë, që do të jetë e dëmshme, dhe kjo do të varet nga qasja e qeverisë së re se a do të vazhdoj planifikimin e nisur apo do të filloj nga e para.

Dhe në kuadër të kësaj Shtrohet dilema se a do të ishte më mire të mblidhej një Kongres Gjithkombëtar, që të bënte pregaditjet dhe bërjen e shtetësisë duke obliguar moralisht, materialisht dhe fizikisht të gjitha strukturat shtetërore, politike akedemike, me një fjalë të mobilizonte tërë kombin sepse sfida është e madhe dhe kështu të fragmentarizuar vështirë se mund tia dalim! Tani kur po krijohen koalicionet qeverisëse disa njerëz flasin me plot entuziazëm për demokraci, për pozitë dhe opozitë, e për qështje tjera që janë vetëm paravan i dëshirës për pushtet me çdo kusht, por demokracia e jonë është ende në shpërgej, opozita, pozita dhe shteti janë vetëm një fatamorganë, kështu që nuk duhet ti lejojmë vetes komoditetin e aktrimit të shtetit, sepse situata është përplot rreziqe të papritura. Andaj në bërjen e koalicionit duhet vepruar sipas sistemit ushtarak, “ata që zotërojnë teren, janë komandantë”. Për të menaxhuar mirë situatën dramatike që veç po na troket te dera, duhet të mendohet për një koalicion që mund të qetësojë vendin dhe rajonin por që edhe mund të mobilizoj qenien tonë kombëtare.

E premte 28.12. 2007, Qendra e Situatave - Zyra e Kryeministrit

Versioni serb i “kalit të trojës”

Në një nga protestat e fundit me moton ”Serbi po, pavarësia e Kosovës - kurrë”, ish kryetari i komunës së Zveqanit, Dragisha Milanoviq, ka thënë se serbët e pranojnë rezolutën 1244 dhe se dëshirojnë të vazhdojnë bashkëpunimin

me KFOR-in dhe UNMIK-un. “Serbët e Kosovës janë për paqe dhe stabilitet në komunat tona, dhe në rajon, ka thënë ai, kështu që të gjitha problemet që imponohen, sikurse ai i gjykatave, hekurudhave dhe i policisë, mund të zgjidhen në mënyrë të qetë dhe me dialog mes Beogradit dhe UNMIK-ut”.

Kjo deklaratë në dëgjim të parë krijon përshtypjen e një gatishmërie të serbëve (“të viktimizuar”), për të biseduar dhe zgjidhur problemet në mënyrë civilizuese dhe demokratike përkundër hedhjes së granatave të dorës dhe vrasjes së një polici Ukrainas në demonstratat e dhunshme të 17 marsit.

Por, pse të zhvillohet dialog mes UNMIK-ut dhe Beogradit, kur tani më Kosovën e kanë pranuar shumë shtete?

Ç`kërkon Beogradi në një shtet Sovran i pavarur dhe i pranuar ndërkombëtarisht? Po UNMIK-u pse? Ndoshta për tu përshëndetur përfundimisht me të “përkëdhelurit e tij nga veriu”, dhe nga Beogradi.

Por, ç`duan në të vërtetë serbët?

- Ndarje fizike;
- Autonomi;
- Ndarje funksionale, apo
- Bojkot të institucioneve të reja të Republikës së Kosovës dhe

kompromet im të faktorit ndërkombëtar në Kosovë dhe pro Kosovës?

Me gjasë të gjitha këto së bashku janë një paravan për të fshehur qëllimin e vërtetë të tyre e që po mundohen ta fusin në Kosovë përmes “kalit të Trojës” të quajtur “ Ministri për Kosovën dhe Metohinë”.

Lojërat serbe, se presidenti dhe institucionet serbe nuk kanë dijeni për planin e ndarjes së Kosovës apo broçkullat tjera, janë vetëm pjesë e skenarit për të hutuar dhe përçarë faktorin qeverisës të Kosovës, faktorin e sigurisë ndërkombëtare në Kosovë si dhe një pjesë të luhatur të bashkësisë ndërkombëtare për pranimin e pavarësisë së Kosovës.

Qëllimi Politik, Gjeopolitik dhe Strategjik i Serbisë në Kosovë

Sipas Harold Lasvelit, “**politika** është mësimi se kush çka fiton, kur, si dhe pse? Një pjesë e politikës si shkencë është edhe e ashtuquajtura politikë e lartë. Politika e lartë merret me çështjet ushtarake, të sigurisë dhe marrëdhëniet me

shtetet tjera, brenda situatës së përgjithshme në bashkësinë ndërkombëtarë dhe marrëdhëniet në këtë bashkësi, por e motivuar nga interesat vetjake, e cila përveç situatës në marëdhënjet ndërkombëtare është e kushtëzuara edhe nga shumë faktorë tjerë të zhvillimit të brendshëm të shtetit"[18].

Gjeopolitika është shkencë e cila studion ndikimin e pozitës gjeografike, pasurive natyrore dhe ambientit fizik në politikën e jashtme të shtetit dhe ka burimet e saja jo vetëm gjeografike por edhe ekonomike, historike dhe në shkencat ushtarake. Këtu vura në pah ose shqyrtova nocionin e politikës dhe gjeopolitikës me qëllim që të ilustroj përpjekjet e qeverisë së Serbisë dhe luftën e saj të pa kompromis, me kombinim mjetesh e metodash për të vazhduar "sundimin " në Kosovë edhe pas shpalljes së pavarësisë së saj.

Shembull i shfrytëzimit të gjeopolitikës për dominim global ishte ai i gjeografit dhe profesorit gjerman Karl Haushofer, që njihej si "themelues i gjeopolitikës gjermane", para Luftës së Dytë Botërore. Instituti Gjeopolitik në Munih, kishte 1000 shkencëtarë, teknicienë, dhe spiunë, idetë dhe puna e të cilëve paraqitej mes hartave, grafikoneve, statistikave, informatave dhe planeve dhe këto kishin diktuar lëvizjet e Hitlerit që nga fillimi Luftës së Dytë. Profesori Haushofer kishte shkruar se "në mënyrë që Gjermania të prosperojë, lidershipi i saj do të duhej të konsideronte pesë elemente esenciale siç ishin: lokacioni fizik, resurset, territori, morfologjia dhe popullata".[19]

Po cilat janë përpjekjet dhe qëllimet e Serbisë menjëherë pas intervenimit të NATO-s dhe vendosjes së misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë?

"DEKLARATA E NIKOLDANIT"

Në Mitrovicë, në verën e vitit 2003, kryetari i bashkësisë së komunave dhe vendbanimeve serbe të "Kosovës dhe Metohisë"(K. M), Dr Marko Jakshiq, prezantoi planin, gjegjësisht një "dokument të rëndësishëm politik dhe strategjik" të quajtur: "Deklarata e Nikoldanit"("Nikoldanska Deklaracija")[20].

[18] Title, **Politics; who gets what, when, how**. Author **Harold** Dwight **Lasswell**. Publisher, Whittlesey house, 1936. Original from, the University of Michigan

[19] **Zeitschrift für Geopolitik** -*Journal for Geopolitics* (1924), Karl Ernst Haushofer

[20] Nikoldanska Deklaracija, Mitrovica, 2003 - **Skupština zajednica opština Kosova i Metohije**

Në këtë dokument thuhet se: ”Duke parë dështimin e misionit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit etnik permanent të serbëve, pra në mungesë të lirisë së lëvizjes, mungesës së procesit të kthimit serioz të të dëbuarve serbë, mungesës së të drejtave njerëzore elementare, të cilat manifestohen me “GETOIZIM”, dhe me porosinë e vazhdueshme kërcënuese të “Zjarrit dhe Shpatës”, nga ana e “terroristëve dhe separatistëve shqiptarë”, humbjes së rrugës dhe dështimit të strategjisë së Serbisë për Kosovën dhe Metohinë, shpallim:***”Deklaratën e Nikoldanit”***.

Qëllimi Gjeopolitik i kësaj deklarate

Cilat dhe çfarë janë pikat që do të jenë bazë për veprimet e ardhshme destruktive serbe në Kosovë që u manifestuan dhe po manifestohen edhe tani në forma të ndryshme, shpesh hetuese dhe kontradiktore në dukje? Këto forma dhe veprime po implementohen dhe futen në Kosovë përmes versionit serb të “Kalit të Trojës” dhe përmes të ashtuquajturës “Ministri për Kosovën dhe Metohinë,”

”Kosova dhe Metohia është pjesë e pandarë e Serbisë- gjegjësisht edhe e Malit të ZI (tani më jo)”. Duke pas parasysh këtë çështje, dhe pas ndarjes së heshtur dhe të vazhdueshme katër vjeçare të Kosovës dhe Metohisë nga Serbia, është koha që ky proces të ndalet dhe të fillojë integrimi i kësaj hapësire në amëzën e vet, në Serbi, e që përputhet me rezolutën 1244. Kthimi i Serbisë në Kosovë dhe Metohi, duhet të jetë tendencë sikurse e politikës zyrtare serbe, po ashtu edhe e bashkësisë ndërkombëtare. Politika e demontimit të institucioneve serbe në Kosovë është akt jo legjitim dhe jolegal dhe duhet të ndalet.

Struktura paralele në Kosovë mund të jenë ato të cilat u krijuan pas vitit 1999 e të cilat nuk kanë lidhje institucionale me Beogradin. Është ironi politike që institucionet shekullore të shtetit serb në Kosovë e Metohi nga ana e disa çarqeve të bashkësisë ndërkombëtare, të shpallen paralele.

Për këtë, kërkojmë që strukturat para shtetërore dhe paraushtarake të krijuara, duhet të shuhen. Si shembull po japim, doganat e Kosovës, dhe TMK-në tani FSK-në. Janë të pavërteta dhe ndjellakëqija vlerësimet se këto struktura paralele nuk perjudikojnë statusin e ardhshëm dhe nuk e favorizojnë “ Kosovën e Pavarur”.

Beogradi zyrtar duhet të fillojë një aksion vendimtar për të kthyer strukturat shtetërore "të dëbuara", si ato ekonomike, kulturore, arsimore, fetare (RTB, Bogosllovinë etj).

Serbët që jetojnë në K. M. si pjesë e shtetit serb, janë komb e jo pakicë kombëtare. Nga kjo burojnë dhe të gjitha të drejtat kolektive (arsimi, shëndetësia, deri te siguria e tyre dhe gjykatat).Të qenit element konstituiv, si komb serb, kemi të drejtën për decentralizim, gjegjësisht krijimin e vetëvendosjes funksionale të serbëve në Kosovë e Metohi .Çështja e entitetit për serbët nuk është politike por ekzistenciale. Krijimi i dy entiteteve në hapësirën e Kosovës dhe Metohisë. është i vetmi opsion politik që ndalon eksodin e mëtejmë. Përvoja pozitive nga Bosnja dhe Hercegovina mund të shfrytëzohet plotësisht në realizimin e këtij projekti.

Kriteret për krijimin e dy entiteteve duhet të jenë: demografike, kadastrale, ekonomike, arkeologjike, historike….por pamja etnike momentale nuk do të jetë masë për krijimin e entitetit, sepse legjitimizon dhe favorizon eksodin dhe pastrimin etnik të serbëve, të krijuar me ardhjen e misionit të Kombeve të Bashkuara në viti 1999. Kriter mund të jetë vetëm përbërja etnike e vitit 1998, gjegjësisht para luftës dhe më herët.

Me krijimin e dy entiteteve do të krijohen kushtet reale për kthim të shpejtë, masiv dhe të qëndrueshëm të serbëve. Gjithashtu do të krijohen kushtet për një liri të plotë të lëvizjes dhe zhbërjes së "Getove."

Kthimi i ushtrisë dhe policisë serbe, si një nga pikat bazë të rezolutës 1244 mund të realizohen në mënyrë dhe kapacitet të plotë, përmes entitetit serb, si dhe në kufirin e pranuar ndërkombëtarisht mes Serbisë dhe malit të Zi.

Standardet e ofruara nga ana e Shefi të UNMIK-ut, rrezikojnë interesat vitale të popullit dhe shtetit serb në Kosovë dhe Metohi dhe si të tilla, për ne janë të papranueshme.

Platforma e ofruar për krijimin e entiteteve nuk i rrezikon interesat e asnjë bashkësie, dhe është në funksion të stabilizimit të gjendjes në Kosovë e Metohi si dhe në rajon".

Në këtë deklaratë mund të shihet qëllimi i vërtetë i platformës së planifikuar mirë nga gjeopolitikanët serbë për Kosovën, e që më shumë i ngjan një platformë

neokolonialiste. E gjithë strategjia ka për qëllim krijimin e entitetit serb ku do të ushtrohej sundimi dhe veprimi i plotë gjeopolitik i shtetit serb në këto fusha:

- Pozitë gjeografike (kufijtë gjeografik të enklavave- decentralizimi);
- Pasuri natyrore(-Minierat, ujërat, pyjet), dhe në ekonomi përmes resurseve të patundshme, profitabile dhe në rentë (Ujmani, Brezovica);
- Histori, arsim, fe (kishat si sinonim i shtetësisë së hershme serbe dhe pasuritë e tyre të patundshme);
- Kthimi i ushtrisë dhe policisë serbe në këto entitete për të vendosur dhe ruajtur sovranitetin e shtetit serb. Me një fjalë, të krijohen kushtet për një shtet funksional serb brenda shtetit të Kosovës, i përbërë nga një pakicë serbe e cila do të jetonte në mirëqenie dhe bollëk, duke shfrytëzuar dhe varfëruar Kosovën, për të derdhur gjithë pasurinë dhe profitin në Serbi, siç kishte ndodhur gjatë gjithë historisë 200 vjeçare të okupimit.

Qëllimi Gjeostrategjik - ***Rrethanat ndërkombëtare***

Për të kthyer sërish "Kosovën dhe Metohinë" në sistemin juridik dhe kushtetues të Serbisë, serbëve ju duhet vetëm në gjë: një "kondicion i mirë historik", sepse, sipas planifikuesve serbë, koha është duke punuar për Rusinë, si aleate e madhe e Serbisë. Rrethanat ndërkombëtare po ndryshojnë dhe atë në dëm të kundërshtarëve të Serbisë. Gjithnjë sipas strategjisë afatgjate serbe, bota në vitet e ardhshme, gjithnjë e më shumë do të merret me problemet e sigurisë, energjetikës dhe të ekologjisë, dhe shumë më pak me problemet tona.

Duhet pas parasysh se shoqëritë perëndimore dhe siguria e tyre, në thelb, janë të rrethuara dhe rrezikuara nga radikalizmi islam, kurse ekonomikisht rrezikohen nga konkurrenca e fortë e ekonomisë nga lindja e largët.

Rrethanat në Serbi, në Kosovë dhe veprimet e ardhshme

Plani gjeostrategjik serb është konsistent në atë se, me çdo kusht duhet të insistohet në prezencën e shtetit serb në Kosovë, në çdo aspekt dhe formë të mundshme. Serbët llogarisin në homogjenizimin kombëtar për Kosovën, pastaj në varfërinë dhe pamundësinë ekonomike të Kosovës për tu zhvilluar në mënyrë të mëvetësishme. "Shteti", i cili sipas tyre "prodhon vetëm kriminalitet dhe varfëri,

dhe i cili në decenien e parë të shek.21, nuk mund të sigurojë energji elektrike për qytetarët e vet, nuk ka shanse për mbijetesë".

Gjendja reale

Sidoqoftë, serbët harrojnë se Kosova tani më është shtet i pavarur, me kapacitete te mjaftueshme ekonomike, shkencore dhe arsimore, që ka një miqësi dhe aleancë me demokracitë dhe superfuqitë ushtarake dhe ekonomike botërore si: SHBA - në, dhe Evropën, kështu që planet serbe "mund të realizohen në afate kohore të gjata, vetëm nëse ne, biem në ndonjë gjumë letargjik, e miqtë tanë as nuk do të marrin mundimin që të na përkundin, për të mos na zgjuar nga gjumi. Plani afatgjatë serb e pësoi tronditjen e parë me shpalljen e Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt, pastaj me pranimin e këtij shteti të ri, nga më shumë se 60 shtete, që është një pranim jo vetëm sasior brenda një kohe të shkurtër por edhe shumë cilësor,(G8-ta, Evropa , SHBA etj). Edhe pranimi i Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO, demanton dhe zhgënjen planifikuesit serbë për humbjen e interesimit në te ardhmen, të faktorit vendimmarrës ndërkombëtar, në çështje të sigurisë në Ballkan dhe rreth Kosovës. Tani është koha që institucionet tona në mënyrë të ligjshme duke u bazuar në kushtetutë si dhe duke shfrytëzuar kapacitetet politike, diplomatike, dhe të sigurisë, të mbrojnë sovranitetin e Republikës së Kosovës. Dhe kur kemi parasysh vizitat e Tadiqëve dhe viçeve tjerë në Republikën e Kosovës, Institucionet e Kosovës në radhë të parë e gjithashtu edhe populli i Kosovës, nuk duhet të harrojnë okupimin shekullor, dëshmorët, invalidët e luftës, dhunën, njerëzit e humbur, jo për tu hakmarrë por, për të mbrojtur dinjitetin tonë të nëpërkëmbur edhe tani nga Serbia.

Shtator 2009.

Strategji për shuarjen e strukturave paralele

Kosova duhet të jetë e gatshme për pengimin e funksionimit të strukturave paralele, në çdo vend dhe në çdo formë të mundshme, për të diskredituar dhe margjinalizuar ato. Prandaj, për këtë çështje, Institucionet kosovare

duhet të aktivizojnë një ofanzivë të aktivitetit diplomatik, politik, të sigurisë, dhe propagandistik.

Qëllimi strategjik i Kosovës është: që ajo të jetë përherë e gatshme, për ndryshimet e „mundshme radikale“, të arkitekturës së Ballkanit perëndimor për të cilën pergatitet dhe e dëshiron Serbia, në kohën kur të paraqitet „momenti për ndarjen e re gjeopolitike të hartave“. Kjo kërkon ruajtjen e tërësisë teritoriale të paprekur të Kosovës sot, që në momentin e ndryshimeve të rrethanave gjeopolitike nesër ose kurdoqoftë, Serbia të pengohet sepse ajo përsëri do të tentojë të futet siq pretendon vazhdimisht „në pasurinë e saj të uzurpuar në mënyrë ilegale“. Qëllimi strategjik i adaptimit të suksesëshëm të Serbisë ndaj rrethit (fqinjëve), të saj jo të pëlqyer, është rritja e fuqisë së saj , mirëqenjes, kohezionit dhe sigurisë. Ky qëllim, sigurisht ngërthen në vete edhe „mbrojtjen e integritetit teritorial“.

Institucionet kosovare mund t`i shuajnë grupet para politike dhe strukturat paralele ilegale, përmes tri veprimeve afatshkurtëra dhe afatmesme: Duke ulur me kujdes të dozuar tensionet politike dhe të sigurisë brenda dhe rreth Kosovës, në mënyrë që gjithmonë të demaskohet qëndrimi i Serbisë se bëhet fjalë për një krizë dhe për të neutralizuar propaganden serbe se kjo krizë:

- Nuk është me ndikim global, siq pretendon Serbia;
- Kjo krizë është afër stabilizimit, dhe drejt zgjidhjes së plotë, dhe
- Nuk është e mbarsur me rreziqe të reja për të shpërthyer.

Detyrë tjetër është insistimi për të bindur faktorin ndërkombëtar se kjo krizë është krijuar artificialisht nga Serbia, e cila krizë nuk krijon as nxit mosmarrëveshje transatlantike rreth menaxhimit të saj.

Detyrë e tretë është ndihma për funksionimin e Eulexit gjithkund dhe në ç`do mënyrë të mundshme, me qëllim të faktorizimit të tij si partner (jo tutor),i

Institucineve të Republikës së Kosovë duke pasë parasysh vazhdimisht pavarësinë e kushtëzuar dhe nën mbikqyrje.

Këto veprime mund të cilësohen si veprime afatshkurtëra dhe afatmesme dhe janë: jashtëzakonisht të mundshme;

- legale;
- të drejta;
- të duhura dhe përfituese, dhe më në fund, mund të bëhen të realizueshme praktikisht, menjëherë.

Si do të Realizohen këto qëllime në praktikë?

Para se te meren këto veprime, duhet të amandamentohen dhe të aprovohen në kuvendin e Kosovës sa më shpejt që është e mundur pjesët e kodit penal të Kosovës, të cilat do të sanksionojnë rrezikimin e sovranitetit, përpjekjeve për ndarje apo shkëputje, rrezikimin e rendit shoqëror, cenimin e kufijve etj, me një fjalë sanksionimin e rrezikimit dhe kërcënimit të sigurisë kombëtare të jashtme dhe të mbrendshme të Kosovës, nga grupet dhe individët e caktuar, pasi që këto qështje nuk janë futur në Kodin penal të Kosovës në vitin 2004.

E para : Për pjesët e Kosovës që gjenden nën kontrollin e strukturave paralele, të përdorët termi: „Pjesët e okupuara përkohësisht nga Republika e Serbisë“, si dhe në të gjitha organet dhe aktet zyrtare dhe në paraqitje, të përdoren termet, shenjat dhe identifikimet e Republikës së Kosovës.

E dyta: Për udhëheqësit e strukturave paralele të përdoret termi : autoritete ose grupe rrebele – kryengritëse dhe si njerëz që janë në konflikt me ligjin“

E treta: Të ngritet padi në Gjyqin Ndërkombëtar të Drejtësisë kundër Sërbisë, për gjenocidin permanent ndaj shqiptarëve që nga viti 1878 e këndej, duke pasë parasysh edhe dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike si Nishi, Leskovci,

Vranja dhe Kurshumlia, gjenocidin e luftë së fundit dhe duke e ngritur njëkohësisht edhe çështjen e Bujanovcit dhe Luginës së Preshevës.

E katërta:Të ngriten sa më shpejtë marëdhënje diplomatike në nivel ambasadorësh sidomos me shtetet e fuqishme që e kanë pranuar Kosovën.

E pesta:Të arrihet marrëveshja me Shqipërinë që përfaqësitë e saj diplomatike dhe konzulare të përfaqësojnë paraqitjen e interesave të Kosovës në vendet ku ajo nuk mund ti mbulojë me përfaqësi diplomatike. Kjo nënkupton vendosjen e e këtyre marëdhënjeve në nivele të ulta të ngarkuarish me punë (me personel kosovar), me vendet tjera, që do ta pranonin qëndrimin e tyre edhe pse ende nuk e kanë pranuar Kosovën.

E gjashta: Angazhimi diplomatik për ngrirjen formale të kandidaturës së Serbisë në B.E, deri sa të gjitha shtetet e B.E., nuk e njohin Kosovën shtet ose formalisht nuk deklarohen në favor të tërësisë teritoriale të Kosovës dhe ta mbështesin plotësisht Eulexin .

E shtata: Forcimi dhe operacionalizimi sa më i shpejtë i FSK-së, forcimi i stukturave tjera të sigurisë si Policia e Kosovës, AIK-u etj., si dhe aprovimi i një rezolute nga Kuvendi i Kosovë për funksionalizim të kushtetutës për të shtrirë qeverisjen e Republikës s ë Kosovës në ç`do pjesë të saj.

E teta: Kriminalizimi dhe ndjekja penale, e përpjekjeve për secesion (nga Rpublika e Kosovës e pranuar ndërkombëtarisht), me fjalë ose me vepër, nga strukturat paralele serbe dhe ç`do strukturë tjetër.

E nënta: Sllogani „Republika e Kosovës“ duhet të vendoset në të gjitha pikat e dukshme për të huajtë, që në kontaktin e parë, duke filluar nga sportelet e ambasadave të Kosovës deri te bilbordet në aeroport dhe në hyrjet kufitare, kurse kombinimi diplomatik, informativ, lobistë dhe veprimet personale të spjegimit, duhet të jenë në funksion të arsyetimit të të gjitha këtyre veprimeve.

E dhjeta: Të binden serbët lokal (dhe ata në Serbi), se Serbia nuk ka humbur kurrfarë teritori, (sepse Kosova ishte e okupuar nga Serbia), dhe se Kosova është vend i të gjithë atyre që jetojnë dhe që dëshirojnë të jetojnë këtu si dhe joshja reale e serbëve lokal dhe ofertat serioze për të qenë pjesë aktive në jetën politike, si qytetarë plotësisht të barabartë të Republikës së Kosovës.

Pra, qëllimi strategjik i Republikës së Kosovës është që, ajo të jetë gjithmonë e gatshme për ndonjë ndryshim të mundshëm „radikal" të arkitekturës së ballkanit perëndimor të imponuar nga Serbia, natyrisht, nëqoftëse vie momenti për ndarjen e re të hartave gjeopolitike. Prandaj detyrë me prioritet për kombin shqiptar është: ngritja shpirtërore, kulturore dhe morale e kombit si parakusht i ngritjes ekonomike, politike dhe të sigurisë deri te bashkimi kombëtar.

Prishtinë shkurt 2010 - botuar në gazetën „Zëri"

Misioni me mandat sigurie që rrezikoi sigurinë

Para se të vinte Misioni Evropian i quajtur Eu-Lex në Kosovë- që don të thotë Ligji Evropian, konturet e tij kishin zënë vend në Kushtetutën e shtetit të kushtëzuar, më të ri në botë - Republikën e Kosovës.

Dhe fatkeqësisht në vend se qytetarët e Kosovës të njiheshin me mandatin e këtij misioni përmes institucioneve shtetërore, mandatin dhe fuqinë e tij ekzekutive duhet të na e sqarojnë OJQ-të e ndryshme.

Pak kush nga qytetarët e Kosovës e dinte dhe besonte se ky mision kishte pushtet më të madh se Kushtetuta e Kosovës, Presidenti, Kryeministri, Parlamenti, Qeveria..... Pra kishte pushtet më shumë se të gjithë këta së bashku, biles edhe më shumë se sovrani i këtij vendi(populli), të quajtur Republika e Kosovës. Shkëndijat e para se Eu-Lexi do të merrej me qështjet e krimeve të pas luftës, krimeve ekonomike, korrupsionit etj., u qfaqen para vendosjes së tij në Kosovë. Numri i dosjeve të përfolura që gjoja do të hapeshin, rritej nga 100 – 200 -250 -500 deri sa arriti mbi 800 dosje! Propaganda e thashethemeve

paraprake e Eu-Lexit po pregatiste terrenin për gjoja një drejtësi joshëse dhe të pranuar nga qytetarët e Kosovës, të cilët ishin lodhur nga tema e përditshme e korrupsionit , amullisë dhe një apatie qeverisëse por që në fakt ishte një ogur i keq në aspektin strategjik, për situatën politike, diplomatike, ekonomike dhe të sigurisë në Kosovë.

Eu-Lexi qëllimisht lëshonte deklarata kinse po përcillte peshqit e mëdhenj, deri sa këto fraza u bënë bajate dhe qytetarët qesheshin duke e krahasuar edhe këtë mision të dështuar që në start, me ate të UNMIK-ut.

Dhe e Keqja ndodhi!

Në emër të korrupsionit, policët e Eulexit thyen çdo normë dhe konventë ndërkombëtare dhe shtetërore, duke u futur në mënyrë arbitrare në Instutucionet e Republikës së Kosovës. Kështu që me plot të drejtë mund të shtrohet pyetja : A kreu Eu-Lexi krim politik me rastin e bastisjes së Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit?

Me kriminalitet Politik kuptohen të gjitha aktivitetet kriminale të drejtuara kundër rregullimit shtetëror, regjimeve politike, përfaqësuesve shtetëror, vendimeve si dhe orientimeve të ndryshme politike apo "këto vepra zakonisht janë të drejtuara kundër qytetarëve ose sistemit shtetëror të një shteti demokratik."[21]

Dhe sidoqoftë, u shpall apo nuk u shpall fajtor Ministri Limaj, ekziston baza ligjore për të paditur dhe akuzuar EU-Lexin se në këtë rast ka kryer një krim politik kundër Institucioneve të Republikës së Kosovës. Ministri Limaj mund të hetohej dhe të përcillej në forma dhe mënyra shumë konfidenciale por edhe nëse duhej të bastiseshin Institucionet Shtetërore për hir të drejtësisë, kjo duhej të bëhej bashkë me Institucionet Shtetërore me mandat sigurie ose së paku, të merrnin pjesë në bastisje si të barabartë edhe Organet e Kosovës për siguri dhe ligj - prokurorët dhe Policia e Kosovës.

Si duhej të Reagonte Qeveria e Kosovës

Menjëherë pas kësaj ngjarje është dashur të mblidhej Këshilli i Kosovës për Siguri i cili do të: distancohej nga korrupsioni dhe të deklaronte bindshëm se ligji është mbi të gjithë. Të kërkonte sqarime dhe llogari nga Eu-Lexi për atakun në

[21] Dr.sc Kolë Krasniqi, Terrorizmi Ndërkombëtar, faqe 20, Botimi II-Prishtinë 2010

Instuitucionet Shtetërore Legjitime të Kosovës. Të kërkonte në të ardhmen bashkëpunim të ngushtë në të gjitha dhe për të gjitha rastet. Të jepte mesazhe qetësuse dhe optimiste për qytetarët e Kosovës.

Si dhe të analizonte dëmët që kishte shkaktuar kjo ngjarje te faktori ndërkombëtar, Donatorët dhe Investitorët e huaj të mundshëm.

Si u Menaxhua Situata gjatë dhe pas kësaj ngjarjeje?

Pa Dashur të ngritet qështja e takimeve të asaj dite që mund të cilësohet si një ditë dhe javë krize që po përjetonte shteti i ri, mund të themi se këto takime ishin shumë individuale, ose vetëm të një partie politike, sodoqoftë mesazhet konstruktive të qarta dhe qetësuse për qytetarët, qofshin ato qeveritare, partiake apo edhe të opozitës ose ishin konfuze ose mungonin fare.

A ishte ky atak i Eu- Lexit në Institucionet shtetërore i qëllimshëm dhe pse?

Në këtë rast dëmet për Republikën e Kosovës janë të konsiderueshme së pari në aspektin ekonomik, për arsye të besueshmërisë, donacioneve, investimeve të huaja etj..,Pastaj dobësimi ose zbehja e imazhit të Qeverisë së Kosovës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe, me këtë veprim qëllimi kryesor i Eu-lexit me gjasë ishte që faktori shtet i Kosovës të dobësohej qëllimisht para:

takimit të rregullt në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, takimit të Sarajevës,

zgjedhjeve lokale jo legjitime të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, çështjes Shqiptare kurrë më delikate në Maqedoni si dhe gjendjes politike të mjerë dhe tragjike në Shqipëri. Si duket skenari i Eu-lexit (dhe jo vetëm i tij), ia arriti qëllimit duke krijuar një gjendje kaotike jo vetëm për qytetarët e Kosovës, për Qeverinë por në përgjithësi u rrezikua edhe gjendja e sigurisë në tërë Ballkanin Perëndimor. Kjo është teoria e rrezikimit të Sigurisë nga vetë Siguria me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të pozicioneve të forta, për tu paraqitur menjëherë në rolin e shpëtimtarit të shenjtë, si qetësues të krizave gjegjësisht të kazanit të përvëluar ballkanik.

Dhe kulmi i veprimeve të Eu-Lexit në këtë gjendje amullie janë burgosjet e ish pjesëtarëve të UÇK-së, vetëm pse Serbia tregoi krimin e vet monstruoz në Rashkë. Duke parë të gjitha këto veprime dhe pa i parë ato që ndodhin mësheftas, atëherë besojmë se Eu-lexi ose një pjesë e faktorit ndërkombëtar bëri

një spektakël karnevalesk, qesharak, dhe injorues por me përmasa ndoshta tragjike dhe me pasoja të rënda, jo vetëm për sigurinë por edhe për të ardhmen e Kosovës në përgjithësi.

Qershor 2010.

Tre skenarë që faktorizuan veriun

Kosova po vazhdon të jetë arenë skenarësh dhe planesh nga më të ndryshmit. Duke qenë të sinqertë dhe pa njohuri të mjaftueshme në këso lojërash e skenarësh politikë dhe diplomatikë, ne biem pre ose viktimizohemi duke na udhëhequr emocionet, dhembja dhe e drejta jonë historike që nuk ka të bëjë asgjë me këta skenarë.

Skenari i parë: Strategjia e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Mitrovicën që nga shpallja e saj kishte lënë shumë për të dyshuar. Fillimisht, kjo strategji u proklamua si një plan i Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj si plan strategjik i përbashkët (Qeveri - ICO), sidoqoftë nuk vonoi shumë dhe Evropa u distancua nga ky plan duke thënë se nuk kishte dijeni për të, dhe se nuk ishte bashkautorë e kësaj strategjie. Doli të jetë tejet paradoksale andaj deklarata e Pitër Faith-it se këtë strategji e kishin hartuar ICO-ja me Qeverinë e Republikës së Kosovës, madje edhe në bashkëpunim me Beogradin! ? Sipas kësaj strategjie qëllimi kryesor ishte krijimi i një komune të re, e që nuk paraqet ndonjë risi për opinionin vendor dhe ndërkombëtar, por ajo që është indikativë në këtë pjesë të strategjisë është se, kjo vetëm sa e forcon gjendjen jo të favorshme faktike për Kosovën. Beteja zhvillohet për atë se kush do të organizojë zgjedhje lokale në këtë pjesë të Kosovës. Kjo ide është më shumë garuese dhe mashtrim optik, sepse, tek e fundit, fituesit e këtyre zgjedhjeve, dihet mirëfilli, do të jenë faktorë legjitim destabilizues në favor të strategjisë serbe për Veriun, brenda një shteti sovran dhe të pavarur. Përvoja na ka treguar se liderët serbë, të dalë nga zgjedhjet lokale, qofshin ato “tonat “ apo të “atyre”, në momentin më kritik pozicionohen në anën e shtetit serb.

Skenari i dytë: Në anën tjetër, (lexo: në anën jugore), u zhvillua një skenar më shumë emocional se sa i organizuar, i cili pa dashje, forcoi gjendjen faktike në pjesën veriore. Shoqatat e dala nga lufta, natyrisht, të prira më shumë nga dhembja dhe emocionet se sa nga ndonjë skenar real dhe strategjik, organizuan një protestë kundër zgjedhjeve serbe në Republikën e Kosovës, gjegjësisht kundër ndarjes së saj. Ndoshta kjo protestë më mirë do të ishte të organizohej në Prishtine se sa afër "kufirit verior", siç e quajnë serbët. Sidoqoftë, protestuesit shqiptarë kishin për qëllim t'ia tregonin faktorit ndërkombëtar pakënaqësinë rreth gjendjes së keqe në Veri. Këta, të prirë nga ndjeshmëria nacionale dhe e drejta historike, protestuan pothuajse pa asnjë mbështetje shtetërore dhe politike të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në fakt, Qeveria e Republikës së Kosovës doli me deklaratën për jolegjitimitetin e këtyre zgjedhjeve, ndoshta pa dashje dhe nga një qëllimi i mirë doli edhe një deklaratë inkurajuese për serbët se: "Qeveria ishte përcaktuar për metoda jo të dhunshme në pengimin e këtyre zgjedhjeve"

Skenari i tretë: Në këtë gjendje konfuze, kur Serbia po mbante zgjedhje lokale në Kosovë, përkohësisht e kishte cenuar integritetin dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës, duke shkelur normat kombëtare dhe ndërkombëtare (mbajtja e zgjedhjeve të pa ligjshme) dhe hyrja ilegale e liderëve serbë dhe suitave të tyre kriminale të armatosura në territorin e një shteti të pavarur.

Serbët, të trimëruar ndoshta edhe nga kjo deklaratë e Qeverisë dhe duke e parë disponimin dhe qëllimin e Kosovës zyrtare, jo vetëm që organizuan dhe mbajtën zgjedhjet lokale por edhe ia mësynë pjesës jugore, për të na e bërë me dije dhe për të na "frikësuar " me "faktin" se "sa lehtë mund ta kalojnë urën". Protestuesit serbë po e luanin rolin e viktimës që sulmon me çdo mënyrë dhe mjet. Në aspektin strategjik, përparësia e tyre qëndronte ose bazohej në diskursin e vazhdueshëm politik dhe diplomatik të Serbisë, të shpalosur javëve të fundit, e i cili, konsiston drejt ndarjes së Kosovës, andaj jo pa qëllim "elektorati" dhe protestuesit serbë u munduan t'i tregojnë botës se ku dëshirojnë ta ngulin gurin e kufirit.

Telegrafi.com,03 Qershor 2010.

Idetë tragjikomike ose apetitet qesharake të fqinjëve

Kur ti nuk je i zoti të lëvrosh arën, atë ose do ta mbys bari i keq dhe therët ose do ta punojë dikush tjetër. Shqiptarëve përgjithësisht gjatë historisë së tyre ju ka munguar agresiviteti politik dhe diplomatik, hiq agresivitetin në mes vete. Ne mobilizohemi vetëm atëherë kur rrezikohet qenia e jonë, e në këtë çështje për dreq mu kujtua një shaka e një miku një ditë kur po flisnim për racën tonë: Ai më tha se ne ose kishim prejardhjen nga bibani ose i ngjanim shumë atij, sepse vetëm kur na fishkëllen dikush ne krekosemi, pastaj qetësohemi shpejt dhe për një kohë të gjatë. Përndryshe nuk kemi pas dhe me gjasë as nuk do të kemi një Konstantë të të bërit politikë dhe diplomaci. Në këtë moment historik kur shqiptarët më së shumti, falë interesave gjeostrategjike të SHBA-së kanë arrit disa suksese si Shtetin e Mbikëqyrur të Kosovës dhe hyrjen në NATO të Shqipërisë, po i përcjellin disa rreziqe të cilat mund t'i cenojnë dhe zhbëjnë këto dy suksese jo autoktone ose për të mos fituar urrejtjen e super patriotëve, këto dy suksese detyrohem t'i quaj të përbashkëta me faktorin ndërkombëtar.

Këto ditë është ngritur shumë pluhur rreth deklaratave të serbit të "moderuar" dhe pro evropian Tadiq, lidhur me ridefinimin e kufijve ballkanik dhe pajtimit historik me shqiptarët. Në dukje të parë dhe për patriotët naiv, kjo deklaratë është shumë joshëse dhe entuziaste, por çka fshihet në të vërtetë pas kësaj deklarate: Fillimisht, Zoti Tadiq e din mirë se konjukturat botërore politike, diplomatike dhe gjeostrategjike janë në favor të shqiptarëve deshi apo nuk deshi zoti Tadiq dhe deshëm ne apo s'deshëm si shqiptarë, kështu që në pamundësi për të ndikuar ose stopuar këto rrjedha, ai bën lojën e padronit të Ballkanit dhe josh shqiptarët me hipotezën se problemet në Ballkan janë çështje e këtyre dy kombeve gjoja më të fuqishme.

Tadiqi në këtë rast ka disa qëllime kryesore: Të nxisë egon dhe megalomaninë shqiptare se ne jemi vërtetë fuqi ballkanike, të minimizojë rolin e kombeve tjera

me të cilët shqiptarët kanë çështje të pambyllura si me Maqedonasit, Grekët dhe Malazeztë. Kështu, në këtë frymë ideja e Tadiqit bëhet sa e rrezikshme po aq edhe monstruoze. Prandaj, përmes kësaj ideje, Tadiqi kërkon një luftë ballkanike kur ne ende nuk jemi konsoliduar si shtet, dhe në vend të një fitoreje kombëtare do të korrnim një humbje kombëtare me turp dhe me pasoja shekullore. Tadiqi për ata që mund të qartësojnë vizionin e tij e ka parasysh gjendjen e rëndë të Maqedonisë ose të maqedonasve në aspektin e Identitetit kombëtar, pastaj gjendjen e rëndë politike dhe sociale të shqiptarëve në Maqedoni ku "pajtimi" ose konflikti i dëshiruar sipas Tadiqit do të involvonte së paku pesë shtete ballkanike përveç Serbisë, Shqipërinë, Maqedoninë, Bullgarinë, Greqinë dhe Kosovën.

Pastaj Tadiqi si përfaqësues i denjë i Nikolla Pashiqit, i cili para Evropës kishte qarë (e vërtetë historike) me lot për fatin e serbëve, njëkohësisht me veprime luftarake, dhunuese dhe barbare kishte zhbërë fizikisht shqiptarët nga trojet e tyre, e njeh mirë gjendjen në Jugun e Shqipërisë, dhe bashkëpunon ngushtë me grekët që të Amortizojë çështjen çame duke ushqyer apetitin edhe ashtu të madh grek për jugun shqiptar, kështu që shqiptarët në vend se të marrin atë që është e tyre, do të detyrohen të japin hisenë e vet shekullore. Loja e Tadiqit vazhdon Përmes injorimit të Malazezëve dhe Maqedonasve duke favorizuar vendin e tij Serbinë dhe Greqinë si mike dhe aleate natyrore, njëkohësisht duke marr rolin e tutorit, duke shpërfillur dhe injoruar deri në skajshmëri këto dy shtete dhe duke folur në emër të Maqedonisë dhe Malit të Zi me qëllim të ngritjes dhe nxitjes së armiqësive të vjetra mes tyre dhe shqiptarëve.

Po, cilat janë favoret e Serbisë në aspektin Strategjik: E para të pengohet konsolidimi i pavarësisë së Kosovës dhe shtrirja e sovranitetit të saj, dhe, e dyta, përmes sindromit grek që duke kërkuar atë që s'të përket ta mbash atë që e ke marrë pa të drejt si rasti i Çamërisë e që për Serbinë është jo Lugina e Preshevës siç mendojnë disa shqiptarë, por përveç saj, çështja është më shumë te e drejta historike e Nishit, Vrajës, Toplicës dhe e Kurshumlisë, sepse kontrata historike fatale e marrëveshjes qindvjeçare e mbrojtur dhe e sponsorizuar nga Evropa e atëhershme për ndarjen dhe copëtimin e vilajeteve (tokave) shqiptare

skadon në vitin 2012-2013. Dhe Tadiqi duke pas parasysh këtë skadim kontrate, gjoja si një shpëtimtar i vorbullës së zjarrtë ballkanike tenton që të fus në lojën e përgjakshme shqiptarët, që në këtë moment favorizues për ne, të ngarkojë mbi shpinën tonë tërë konfliktin, luftën dhe urrejtjen ballkanike në mënyrë që të përfitojë sikurse sot e një qind vjet më parë.

Do të ishim në gjendje si komb, të bënim një ridefinim të padrejtësive historike kundër nesh dhe një kompromis të quajtur pajtim historik mes shqiptarëve, serbëve dhe të gjithë fqinjëve tanë, në mënyrë demokratike, me dialog dhe marrëveshje vetëm atëherë kur të ndodhte bashkimi Shqipëri Kosovë, sepse atëherë do të kishim një shtrirje solide gjeografike, gjeostrategjike, gjeo ekonomike dhe gjeopolitike, një ekonomi dhe një treg të konsoliduar dhe të mjaftueshëm për veten dhe të tjerët, resurse të mjaftueshme humane dhe të tjera, kështu që do të ishim në gjendje t'i bënim ballë me lehtësi sfidave të sigurisë ballkanike dhe më gjerë. Vetëm kështu do t'i dëshironim mirë se ardhje dhe suksese zotit Tadiq në pajtimin jo vetëm shqiptaro-serb, por edhe ballkanik, si dhe në ridefinimin e kufijve ballkanik, aq të domosdoshëm sidomos për ne shqiptarët.

Postuar: 0:07 / 6.04.2011- telegrafi.com

SIGURI NDËRKOMBËTARE

Konspiracioni i madh botëror - Osama Bin Laden

Në vitin 1982 kur Afganistani ishte ende nën okupimin e Bashkimit Sovjetik, Osama Bin Laden i cili po studionte ndërtimtarinë, në të njëjtën kohë me urdhër të shërbimit sekret të Arabisë Saudite shkoi në Afganistan ku do të ndërtonte rrugë tunele dhe baza për lëvizjen muxhahedine. Gjithashtu si një njeri që vinte nga një familje e pasur financoi ndërtimin e shumë llogoreve për stërvitjen e vullnetarëve nga shumë shtete myslimane. Në të njëjtën kohë edhe CIA, stërviste dhe furnizonte me armë muxhahedinët në luftë kundër okupimit rus. Në vitin 1990 Osama u kthye në vendlindjen e tij, Arabinë Saudite, dhe në mënyrë të

hapur kundërshtoi prezencën ushtarake Amerikane në vendin e tij, duke thënë se ata po i ndotnin vendet e shenjta po ashtu duke kërkuar krijimin e një shteti të zotit. Për këtë arsye ju mor nënshtetësia, u dëbua nga vendi por duke marrë me vete një pjesë të madhe të pasurisë së babait të tij i cili ishte një nga sipërmarrësit më të mëdhenj të ndërtimtarisë në Arabinë Saudite.

Fillimisht Osama ishte vendosur në Sudan por kur Amerikanët kërkuan dëbimin e tij, ai u kthye në Afganistan. Aty së bashku me mjekun egjiptian Aiman Al Zavahiriu themeluan rrjetin Al Qaeda që don të thotë "Bazë". Al Qaeda fillimisht kishte planifikuar sulme në Jemen, Somali, Arabinë Saudite dhe në fund në SHBA. Ndërkohë që problemet me terrorizmin në Amerikë kishin nisur të shfaqeshin qysh nga vitet 90`, por format fillimisht ishin konvencionale, së pari përmes mjeteve shpërthyese (lëndëve plasëse) me fuqi shkatërruese, pastaj planifikimet për sulme erdhën duke marrë forma dhe metoda të ndryshme herë të sofistikuara e herë të thjeshta dhe shumë praktike, si antraksi, kërcënimet dhe prodhimi i bombave të ndyta me përbërje nukleare, e deri te përdorimi i avionëve të thjeshtë siç ishte rasti i 11 shtatorit 2001, kur u shembën kullat binjake.

Resurset natyrore – lënda e Parë

Shtetet e fuqishme për të dominuar jo vetëm ushtarakisht, por edhe ekonomikisht, duhet të kontrollojnë lëndën e parë e cila siguron zhvillimin e ekonomisë botërore. Shtetet në fjalë kanë siguruar për një kohë të gjatë rolin e aktorit kryesor jo vetëm në arenën e marrëdhënieve ndërkombëtare por edhe atë ekonomike, elemente këto që e bënë Britaninë e Madhe të vetmin shtet që arriti të vendos hegjemoninë në marrëdhëniet ndërkombëtare në shekullin e 18. Në këtë kuptim edhe Amerika zhvilloi dy luftëra në Lindjen e Afërt, zyrtarisht për të luftuar terrorizmin, por në fakt siguroi zotërimin dhe përqendrimin në duart e saj të lëndës së parë (gazin natyror në Afganistan dhe naftën në Irak dhe të shteteve aleate të Gjirit Persik) për të cilat Kina dhe India do të kenë nevojë shumë shpejt duke qenë se zhvillimi i tyre industrial dhe demografik në 15 vitet e ardhshme do të shterojë burimet natyrore të tyre dhe si rrjedhojë ato do jenë të detyruara të

kenë një vartësi politike dhe ekonomike ndaj shtetit që i ka përqendruar këto të fundit në duart e tij. Prandaj kjo është arsyeja përse Moska, Pekini dhe Uashingtoni i janë futur një lufte pa krye mbi kontrollin e burimeve natyrore të para siç janë: gazi dhe nafta dhe po zhvillojnë gjithmonë e më shumë teknologji të reja të burimeve energjike alternative.

Këshilltarët Politikë, Ushtarak dhe të inteligjencës në emër të mbrojtjes së Lirive dhe të drejtave njerëzore dhe demokracisë, këshillonin presidentët Amerikanë për mundësinë e shterjes së resurseve amerikane për 25 vitet e ardhshme duke ua bërë me dije se 80% e resurseve botërore gjenden në Euroazi, dhe se 10% e gazrave botërore gjenden në Irak kurse Irani është fuqi botërore sa u përket këtyre resurseve.

Në emër të luftës kundër terrorizmit, armatimit kimik dhe nuklear edhe presidenti George W. Bush sulmoi Irakun dhe kur nuk mundi të justifikonte mungesën e gjetjes së armëve kimike, biologjike dhe atomike, invazionin ushtarak e arsyetoi me shkeljen e të drejtave dhe lirive njerëzore dhe regjimin diktatorial të Sadam Hysenit. Në këtë frymë edhe specialistët e çështjeve të definuar sigurisë shtetërore, regjionale ndërkombëtare dhe botërore kishin rreziqet dhe kërcënimet e shekullit 21 si në vijim:

- Terrorizmi;
- Shkatërrimi i shteve dhe
- Krimi i organizuar, e tregtia me mjete nukleare.

Pasi që Amerika ka arritur të shtrijë dominimin e vet në Lindjen e Afërt, Kina si superfuqi ekonomike, sot rrezikohet nga harxhimi i burimeve të veta natyrore brenda 15 viteve të ardhshme. Sipas disa analizave të specialistëve të ekonomisë botërore nuk ka më dyshime që Kina një superfuqi ekonomike sot, në 15 vitet e ardhshme do të ketë përdorur të gjitha burimet e saj natyrore të cilat gjenden në tokën e saj. Si rrjedhojë, kësaj superfuqie ekonomike do t'i duhet të sigurojë lëndën e parë diku tjetër. Andaj, "Kina duke qenë e vetëdijshme se ka

një numër enorm banorësh të cilët kërkojnë shumë burime, kishte filluar të përgatitej qysh në vitet 60-70 në këtë drejtim, pra sigurimin e resurseve natyrore ne vendet tjera si p.sh në Afrikë. Qysh nga këto vite ishte zhvilluar një luftë e fshehtë dhe e heshtur në mes shërbimeve sekrete botërore si MI-6 britanik, CSIS kinez, KGB-ja sovjetike, Mossadi, BOSS, shërbimi sekret jugoafrikan, DGST dhe nga fundi i viteve te 60 edhe CIA-s Amerikane."[22]. Në vitet 1960 Afrika ishte kthyer në një nga kontinentet ku zhvillonin veprimtarinë e tyre shërbimet sekrete më të fuqishme të botës, për arsye se ajo konsiderohej atëherë dhe sot si vendi me resurse të shumta natyrore, me një popullsi të varfër dhe të pa arsimuar dhe me një fuqi punëtore të lirë. "Shërbimi Kinez, Izraelit, Anglez, Amerikan, kryesisht kërkonin dominim ekonomik, për dallim prej atij Rus i cili kishte arritur edhe të eksportonte modelin rus të revolucionin dhe socializmi si rend shoqëror. Pra kishim të bënim edhe me dominimin ideologjik"[23].

Barack Obama – "Amerikani Afrikano – Mysliman"

Pasi që George W. Bush e kishte kryer pothuajse një pjesë të mirë të punës në Afganistan, Irak dhe thuaja se në tërë Gjirin Persik, Amerika zgjodhi një president të ri që ishte sa fascinuese për ata që predikojnë demokracinë, lirinë dhe të drejtat njerëzore, anti racizmin, por njëkohësisht ishte po aq dëshpëruese kjo zgjedhje për Amerikanët që i urrenin këto "kuazi vlera" sipas tyre. Menjëherë pas zgjedhjes së Barack Obamës për president, ishin shkëmbyer akuza jo shumë të forta mes Osama Bin Ladenit dhe Barack Obamës.

Fillimi i vitit 2011 do të mbahet mend në historinë botërore sidomos atë amerikane për daljen në opinion të sekreteve diplomatike Amerikane nga mbarë

---

[22] ^ "National Intelligence Estimate 60/70-65: Problems and Prospects in Sub-Saharan Africa". *Foreign Relations of the United States, 1964-1968, Volume XXIV, Africa*. April 22, 1965. FRUS-XXIV-195, NIE 60/70-65. http://www.mekaleh-eritra.org/Documents/Nekrumah/2006-07-05-USA-Doc1.htm.

[20] ^ "National Intelligence Estimate 60/70-65: Problems and Prospects in Sub-Saharan Africa". *Foreign Relations of the United States, 1964-1968, Volume XXIV, Africa*. April 22, 1965. FRUS-XXIV-195, NIE 60/70-65. http://www.mekaleh-eritra.org/Documents/Nekrumah/2006-07-05-USA-Doc1.htm

bota përmes Portalit Wikileaks. Në këtë rast vlen të përmendet një fakt që pak kush e kishte analizuar dhe hetuar, për herë të parë në historinë e diplomacisë Amerikane, sekretarja e shtetit Hilary Clinton, i kishte ftuar të gjithë ambasadorët e Amerikës kudo që ishin, në mbarë botën që të kthehesin në vendin e tyre për të marr instruksione të reja diplomatike, sepse, sipas të gjitha gjasave diplomacia Amerika po përgatitet për ndryshime rrënjësore të kursit të veprimit kundrejt sfidave të reja të sigurisë globale dhe dominimit botëror. Dhe shenjat e para se diçka do të ndryshonte u panë me lëvizjet "demokratike" që po ndodhnin radhazi sidomos në botën myslimane duke filluar nga Afrika e Jugut, Lindja e Mesme dhe Gjiri Persik. Me radhë, shtetet si Jemeni, Egjipti, Libia dhe Siria po tronditeshin dhe tronditen ende nga lëvizjet e brendshme demokratike e që deri tash disa nga këto vende kanë qenë të njohura si sponzoruesit kryesor të terrorizmit, përveç Egjiptit. Kur bota myslimane dhe opinioni ndërkombëtar po shqetësohej nga këto lëvizje, në Amerikë kundërshtarët e presidentit Barack Obama po venin në pikëpyetje shtetësinë dhe Amerikanizmin e presidentit duke kërkuar që të publikohej botërisht dhe sa më shpejt që është e mundur certifikata e tij e lindjes. Nën trysninë e madhe dhe të vazhdueshme të opinionit Amerikan, Shtëpia e Bardhë dhe presidenti u detyruan që ta publikonin certifikatën e tij të lindjes ku për habi shkruante: Barack Husein Obama III. Për të mbuluar dhe relativizuar të gjitha këto, inteligjenca dhe elita ushtarake Amerikane përgatiten dhe kryen vrasjen spektakulare të kryeterroristit botëror Osama Bin Laden në një vilë të vjetër në Pakistan, shumë afër qendrës prestigjioze, akademisë ushtarake pakistaneze, në një shtëpi e cila nuk i plotësonte as kërkesat elementare për një jetë normale për një njeri të varfër, e lëre më për një kryeterrorist të trumbetuar siç ishte Osama Bin Laden. Për vdekjen e tij shtypi botëror shkruan përafërsisht kështu: Gjatë viteve të kaluara Osama Bin Laden e kishte humbur rolin e super-trurit, organizatorit dhe urdhërdhënësit të rrjetit terrorist Al Qaeda. Ai ishte një kërcënim i zvogëluar real dhe më shumë ishte një simbol i terrorizmit. Në këtë mënyrë prandaj edhe vdekja e tij është më tepër simbolike. Arsyeja pse Bin Ladeni ishte vrarë dhe nuk iu kishte dhënë mundësia të gjykohej është për shkak se ndoshta qeveria Amerikane nuk dëshironte që Bin Ladeni të nxirrte tërë

sekretet për operacionet e fshehta ushtarake që u zhvilluan nga Amerikanët gjatë luftës së ftohtë në Afganistan. CIA kishte armatosur armatën Muxhahedine të Bin Ladenit në luftë kundër Rusisë në Afganistan.

Telegrafi.com, 1:00 / 10.05.2011

Veriu i Kosovë, sigurizimi dhe politizimi i çështjes

Shkolla e Kopenhagës lindi në Institutin e Kërkimeve për Konfliktin dhe Paqen në Kopenhagë dhe përfaqësohet nga Berry Buzan, Ole Waever, Jaap de Wilde dhe të tjerë. Si shkollë, kjo ka zhvilluar një mori konceptesh themelore për të rishqyrtuar sigurinë me metoda jo ushtarake. Kjo shkollë karakterizohet përmes dy nocioneve: sigurizimit dhe **de sigurizimit**. Shkolla bëri përpjekje dhe luajti rol të rëndësishëm në konceptimin e çështjeve të sigurisë sidomos pas luftës së ftoftë. Sipas kësaj shkolle çdo çështje specifike mund të sigurizohet, **de sigurizohet**, politizohet dhe depolitizohet. Një çështje mund të sigurizohet përmes diskursit të ligjërimit dhe nga akti politik të shndërrohet në çështje sigurie. Për të sigurizuar një çështje grupi i caktuar si shteti, politika, shoqëria civile etj., një problem apo çështje të politizuar e paraqesin si kërcënim për objektin referues sikurse, sovraniteti dhe integriteti kombëtar etj. kurse de sigurizimi është e kundërta e sigurizimit.

Politizimi i një çështjeje në fushën e sigurisë dhe sipas shkollës së Kopenhagës, kuptohet si një çështje e sigurisë që merr kuptim politik e që duhet të zgjidhet përmes mekanizmave institucional shtetëror.

Kurse de politizimi, gjithmonë sipas kësaj shkolle kupton zgjidhjen e problemeve të sigurisë përmes debateve publike pa u involvuar mekanizmat shtetëror institucional.

Faktori ndërkombëtar dhe veriu i Kosovës

Çështjen e veriut të Kosovës e sigurizuan, fillimisht bashkëpunimi i ngushtë i Forcave ndërkombëtare - KFOR-it Francez, UNMIK-ut, dhe shtetit të Serbisë të cilët mbështetën fuqishëm serbët e veriut për bojkot ndarje dhe dhunë ndaj shqiptarëve dhe shtetit të Republikës se Kosovës, me të gjitha strukturat

shtetërore dhe sidomos me ato të sigurisë. Faktori ndërkombëtar - KFOR-i Francez cili u vendos në Mitrovicë në vitin 99 dhe UNMIK- u, Sigurizuan çështjen e veriut (e cila mund të depolitizohej ose të politizohej që donë të thotë të futej në mekanizmat institucional dhe të zgjidhej lehtësisht), duke frikësuar dhe demonizuar qëllimshëm opinionin vendës në veri nga një emër i vetëm, UÇK, me qëllim të spastrimit etnik dhe të krijimit të gjendjes faktike në favor të Serbisë. Serbia përmes mekanizmave shtetëror jo vetëm që çështjen e veriut e bëri kërcënim dhe rrezik për Kosovën dhe rajonin por arriti që përmes skenarëve të shumtë, me demonstrata dhe protesta radikale, përveç tjerash në emër të drejtave të serbëve në veri, të vrasë dhe të dëbojë shqiptarët nga prona e tyre shekullore e po ashtu të vrasë dhe të plagos ushtarët e KFOR-it, Policët e UNMIK-ut si dhe ata të Eulexit. Skenarëve të tillë destruktiv shpesh në mënyrë të pavetëdijshme ju bashkëngjitën edhe shqiptarët sikurse ai i protestave të vitit 2004..

Sigurizimi strategjik ndërkombëtar i çështjes së veriut-Burimi i krizës

Qysh ne bisedimet Ahtisaari, Millosheviq, Çernomirdin thuhet se nga diplomacia Ruse - Serbe ishin bërë përgatitjet se si do të kompromet ohej çdo sukses i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Një prej bashkëpunimeve strategjike ndërmjet BIA-s dhe SVR-së rreth ose kundër Kosovës, ishte intensifikuar gjatë luftës e sidomos gjatë bombardimeve të NATO-s në Kosovë në muajt prill dhe maj 1999. Në atë kohë kryetari i Finlandës Marti Ahtisaari i lindur në qytezën Viborg të Rusisë, zhvillonte bisedime me Sllobodan Millosheviqin dhe Viktor Çernomirdin-in (ish kryeministër i Rusisë i cili vdiq me 03 nëntor 2010, pak para zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Kosovë!)

Historiku

Kronologjia e ngjarjeve me te rëndësishme, janar-mars, 1999

- 15 janar-Masakra e Reçakut ne Kosovë, Vriten 45 shqiptarë;
- 29 janar-Mbledhja e Grupit të Kontaktit në Londër: Kërkohet zbatimi i rezolutave, hetim për Reçakun, dënohen provokacionet e UÇK-së dhe ftohen palët për marrëveshje brenda 21 ditëve;

- 06. shkurt-Hapet Rambuje nën kryesinë franko-angleze, Serbët deklarojnë praninë e sigurisë nga NATO-s dhe kryesohen nga Ratko Markovic, kurse delegacioni kosovar kryesohet nga Hashim Thaçi, Ibrahim Rugova dhe Veton Surroi;
- 14 shkurt-Grupi i Kontaktit zgjat negociatat e Rambujesë deri me 20 shkurt;
- 20 shkurt-Grupi i Kontaktit, që shikon mos firmosjen e dy palëve, vendos një pauzë dhe planifikon një ritakim me 15 mars;
- 15 mars-Rifillojnë bisedimet në Paris. Firmosin vetëm kosovarët me 18 mars. Firmosja është shoqëruar me një deklarate interpretuese, e cila ripohon synimin e palës kosovare për pavarësi në fund të periudhës transitore;
- 23 mars-Holbrooke heq dorë pas dy takimeve me Slobodan Millosheviqin. Serbët nuk pranojnë kushtet e NATO-s. Solana e bën ekzekutiv act-ord atë natë;
- 24 mars- Ne orën 20.00 lokale fillojnë bombardimet. Me kërkesën e rusëve mblidhet KE-se i OKB-së;
- Anan dënon intrasigjencën e Beogradit;
- Primakov nuk shkon në Uashington;
- Sipas UNHCR-së jashtë Kosovës janë strehuar 200.000 persona;
- 25 mars - KE konfirmojnë mbështetjen për NATO-n;

Kronologjia e ngjarjeve më të rëndësishme-vazhdim, maj-qershor 1999

- 10 maj-Cernomirdin në Peking;
- 19 maj-Mbledhje e drejtoreve politike të G-8 në Bon;
- Mision i ri i Chernomyrdin në Beograd;
- 20 maj-Bisedime në Moskë, ku Chernomyrdin-it dhe Talbot-it i shtohet edhe Ahtisari;
- 02 qershor - Chernomyrdin dhe Ahtisari në Beograd;
- Millosheviçi mbledh parlamentin Serb;
- 03 qershor-Parlamenti dhe qeveria serbe pranojnë kushtet e BE-së me anë të Ahtisarit;

- 06 qershor- Fillojnë në Kumanovë bisedimet në mes të delegacionit të SHBA-së dhe atij Serb;
- Gjenerali Xhekson përballë
- atij Serb Svetozar Marjanovic.

Vendosja dhe shpërndarja e forcave të KFOR-it në Kosovë pas intervenimit të NATO-s: Roli i Francës

Franca e cila do të vendoste kontingjentin e saj në veriun e Kosovës me rolin e saj deklarativisht pro Kosovës, do të dëshmohej si shumë negative dhe armiqësore në çështjen e veriut. Por, si do te ndodhte kjo: Franca është anëtare e disa organizatave të njohura botërore ndër të cilat është edhe NATO prej të cilës ajo ishte tërhequr në vitin 1966. Fillimisht ajo ishte entuziazmuar me rolin e saj parësor në Rambuje, por interesat dhe miqësitë e vjetra ortodokse e pengonin që të luante rol konstruktiv. Në Francë mbretërojnë dy linja, ajo pro Amerikane dhe ajo pro ortodokse. Këto dy linja u manifestuan më së shumti në terren (Kosovë) si gjatë bombardimeve po ashtu edhe gjatë vendosjes së Kontingjentit Francez në Kosovë i cili kontingjent me Ndihmën e UNMIK-ut dhe Kryesuesit të PSSS-së i cili fatkeqësisht ishte po ashtu francez, Bernard Kushner, krijoi zonë dhe hapësirë që Serbia me forcat e saja paramilitare dhe strukturat tjera ta vendosin rendin ne veri. Kjo vendosje u përshkallëzua me dhunimin, vrasjen dhe dëbimin e popullatës shqiptare nga veriu i Kosovës për të shndërruar këtë pjesë të Kosovës në fakt të kryer. Po ashtu vëmendjen nga rreziku verior e tërhoqi edhe ndërhyrja dhe ardhja e pa planifikuar e forcave (kontingjentit) ruse në Kosovë.

Dështimi i politizimit dhe sigurizimit të veriut nga vendorët:
UÇK-ja dhe Qeveria e Përkohshme

Duke qenë se delegacioni i Kosovës në Rambuje nuk kishte ndonjë harmonizim idesh dhe veprimesh të mjaftueshme rreth qëllimeve politike dhe strategjike për Kosovën dhe duke u marr me shume me krijimin e një qeverie gjithë përfshirëse, sikur u harrua dhe u la anash veriu i Kosovës si në aspektin strategjik po ashtu

edhe taktik, sepse Forcat e UCK-së patën mundësi fillimisht që të kontrollonin atë territor dhe të vendosnin rregull dhe rend.

Pasi që gjatë kohës sa delegacioni Kosovar ishte në Rambuje, në Kosovë brenda radhëve të UCK-së ndodhen lëvizje dhe emërime që shmangën vëmendjen rreth asaj se si duhet vepruar me tutje ne aspektin strategjik dhe taktik siç ishte ta zëmë shtrirja e UCK-së jo vetëm në tërë Kosovën, kjo bëri që të krijohej një huti dhe vetë kënaqësi.

Pse mbeti veriu pa struktura politike dhe Ushtarake të Kosovës:

a. Mungesa e një strategjie nga ana e Drejtorisë politike e cila ishte e zënë shumë me bisedimet në Rambuje dhe rreth krijimit të qeverisë së përkohshme
b. Mungesa e një Plani Operativ (ose mos zbatimi i tij nëse ai ekzistonte) për shtrirjen e Forcave të UCK-së në tërë territorin e Kosovës dhe me gjërë.
c. Mosbesimi i delegacionit Kosovar, ndaj faktorit ndërkombëtar i shndërruar në besim blanko ndaj NATO-s se kjo me ndërhyrjen e saj do të rregullonte çështjen tonë deri në fund.
d. Mosmarrëveshjet e Partive kryesore politike rreth konstituimit të një qeverie (sepse në atë kohë Kosova kishte dy qeveri).

Në këtë vorbull veprimesh pa strategji, pa prioritete dhe pa një plan veprimi, serbët shfrytëzuan rastin dhe së bashku me Kontingjentin Francez të KFOR-it dhe UNMIK-un u konsoliduan në veriun e Kosovës, kështu që kur u hetua rreziku se veriu mund të ndahej, atëherë forcat e UCK-së tentuan që të (futen edhe pse me vonesë) në veri e ku për habi të tyre, hasën në rezistencë të armatosur të Kontingjentit Francez të KFOR-it dhe në dënimin e UNMIKU-t e përveç kësaj patën humbje në jetë njerëzish dhe plagosje të ushtarëve.

Sigurizimi i veriut nga KFOR-i UNMIK-u dhe Serbia

1999

Cilat ishin ngjarjet kryesore pas krijimit të tampon zonës nga Francezët dhe UNMIKU?

Në verën e vitit 1999, lumi Ibër në Mitrovicë u bë vija e ndarjes ndërmjet dominimit të shqiptarëve në jug dhe veriut të mbizotëruar nga serbët. Ndarja rezultoi nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë dhunën etnike dhe paaftësinë e KFOR-it dhe UNMIK-ut për të kontrolluar situatën. Udhëheqësit politikë serb në Mitrovicën e veriut formuan Rojet e Urës, një grup të rinjsh qëllimi i të cilëve ishte për të "mbrojtur" veriun nga sulmet ekstremiste. vlerësimet tregonin për një grup prej150-250 persona.

2000.

Në fillimin e shkurtit të 2000, u krye një sulm me granatë në një autobus të Kombeve të Bashkuara, (Komisionari i Lartë për Refugjatët UNHCR kujdesej për serbët) në afërsi të Mitrovicës. Ky sulm pati si pasojë tre të vrarë dhe shumë të plagosur. Pasuan Sulmet hakmarrëse serbe në veriun e. Mitrovicës, ku mbetën të vrarë dhjetë shqiptarë.

2001

Në shkurt të vitit 2001, vrasja e një të riu shqiptar në veri çoi në sulmet ndaj KFOR-it francez nga ana e shqiptarëve.

2002

Në prill 2002, një kontroll rutinë e trafikut u shkallëzua në një sulm të armatosur nga Rojet Urës mbi policët e UNMIK-ut, ku u plagosën 22 policë. Ky ishte akti më i keq i dhunës ndaj personelit të UNMIK-ut që nga fillimi i misionit.

2003

Sigurizimi i çështjes së veriut nga Serbia përmes serbëve vendor

Në Mitrovicë, në verën e vitit 2003, kryetari i bashkësisë së komunave dhe vendbanimeve serbe të "Kosovës dhe Metohisë"(K. M), Dr Marko Jakshiq, prezantoi planin, gjegjësisht një "dokument të rëndësishëm politik dhe strategjik" të quajtur: "Deklarata e Nikoldanit"("Nikoldanska Deklaracija"). Në këtë dokument thuhet se: "Duke parë dështimin e misionit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit etnik permanent të serbëve, pra në mungesë të lirisë së lëvizjes, mungesës së procesit të kthimit serioz të dëbuarve serbë, mungesës së të drejtave njerëzore elementare, të cilat manifestohen me "GETOIZIM", dhe me porosinë e vazhdueshme kërcënuese të "Zjarrit dhe Shpatës", nga ana e terroristëve dhe separatistëve shqiptarë, humbjes së rrugës dhe dështimit të strategjisë së Serbisë për Kosovën dhe Metohinë, shpallim:

"Deklaratën e Nikoldanit

"Kosova dhe Metohia është pjesë e pandarë e Serbisë- gjegjësisht edhe e Malit të ZI (tani më jo)".Duke pas parasysh këtë çështje, dhe pas ndarjes së heshtur dhe të vazhdueshme katër vjeçare të Kosovës dhe Metohisë nga Serbia, është koha që ky proces të ndalet dhe të fillojë integrimi i kësaj hapësire në amëzën e vet, në Serbi, e që përputhet me rezolutën 1244. Kthimi i Serbisë në Kosovë dhe Metohi, duhet të jetë tendencë sikurse e politikës zyrtare serbe, po ashtu edhe e bashkësisë ndërkombëtare. Politika e demontimit të institucioneve serbe në Kosovë është akt jo legjitim dhe jo legal dhe duhet të ndalet.

Pika e fundit e kësaj deklarate që ishte edhe platformë politike serbe e cila është aktuale dhe e cila po zbatohet edhe sot si pjesë e marrëveshjeve Kosovë – Serbi thotë:

Me krijimin e dy entiteteve do të krijohen kushtet reale për kthim të shpejtë, masiv dhe të qëndrueshëm të serbëve. Gjithashtu do të krijohen kushtet për një liri të plotë të lëvizjes dhe zhbërjes së "Getove."Kthimi i ushtrisë dhe policisë serbe, si një nga pikat bazë të rezolutës 1244 mund të realizohen në mënyrë dhe kapacitet të plotë, përmes entitetit serb, si dhe në kufirin e pranuar ndërkombëtarisht mes Serbisë dhe Malit të Zi. Standardet e ofruara nga ana e

Shefi të UNMIK-ut, rrezikojnë interesat vitale të popullit dhe shtetit serb në Kosovë dhe Metohi (KM). dhe si të tilla, për ne janë të papranueshme. Platforma e ofruar për krijimin e entiteteve nuk i rrezikon interesat e asnjë bashkësie, dhe është në funksion të stabilizimit të gjendjes në K. M. si dhe në rajon".

2004

Në mars të vitit 2004, protestat në Mitrovicë patën tendencën e shndërrimit në konflikt ndërmjet shqiptarëve dhe Serbëve, sidoqoftë këto protesta u shndërruan ne trazira ne mbarë Kosovën ku u vranë 28 dhe u plagosën 600 persona. Këto trazira demonstruan dhunën më të keqe në Kosovë që nga viti 1999. Ky skenar serbo rus ishte paramenduar të tërhiqte vëmendjen nga veriu, sepse tashmë ishte afati kur duhej të shqyrtohej çështja e pavarësisë sipas marrëveshjes së Rambujesë. Në këtë skenar populli i Kosovës i zhgënjyer në UNMIK-un dhe faktorin ndërkombëtar ra pre e skenarit serb dhe grupeve te caktuara të porositura nga agjenturat e ndryshme, shkatërruan dhe dogjën pa nevojë objekte fetare serbe duke i dhënë shkas Serbisë dhe faktorit ndërkombëtar pro serb që para botës të na paraqisnin si vandal dhe fanatik fetar, .duke akuzuar dhe qortuar tërthorazi faktorin ndërkombëtar pro shqiptar për ndihmën që na kishin dhënë.

Deri në vitin 2008 Republika e Kosovës nuk e politizoi përveç se me ndonjë deklaratë të rrallë çështjen e veriut. Pas shpalljes së pavarësisë dhe pas aprovimit të kushtetutës, Republika e Kosovës krijoi mekanizmat kushtetues dhe ligjor për të shtrirë sovranitetin e vetë në tërë territorin e vet. Tani më çështja e veriut ishte shndërruar në një gjendje faktike në favorin e Serbisë, kjo gjendje nga njëherë edhe quhej edhe konflikt i ngrirë. Por, Sido që të quhej kjo gjendje, Serbia tani më kishte shtrirë tërë mekanizmat shtetëror në veri ose saktësisht shteti serb qeveriste këtë pjesë të Kosovës.

Politizimi i çështjes së veriut nga Republika e Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë, aprovimit të kushtetutës së Kosovës dhe hartimit të një mori ligjesh të cilat rregullojnë fushën e mbrojtjes së integritetit dhe

sovranitetit, si dhe sanksionojnë një mori aktesh që po i ndërmerrnin strukturat paralele serbe dhe Serbia në territorin e Republikës së Kosovës, Kosova filloi politizimin e çështjes së veriut përmes qeverise, parlamentit, partive politike, dhe shoqërisë civile për te gjetur mënyrën se si do të shtrinte sovranitetin në veri. Pra kjo çështje filloi të politizohej dhe kërkohej zgjidhje brenda mekanizmave institucional shtetëror.

E ndodhur nën presionin politik vendor, Qeveria e Kosovës filloi diskursin ligjërues për të sigurizuar këtë çështje e cila faktikisht ishte kërcënim dhe rrezik për Kosovën që nga viti 1999.

Përpjekja e parë u bë me hartimin e një platforme për veriun që për fat të keq që në fillim mund të hetohej se do të dështonte. E para se nuk ishin përfshirë të gjithë faktorët relevantë në hartimin e saj dhe e dyta edhe pas shumë spekulimesh se kjo platformë ishte hartuar së bashku dhe në harmoni me faktorin ndërkombëtar, vetë deklaratat e këtyre të dytëve ishin kontradiktore dhe jo shpresëdhënëse. Sidoqoftë nga kjo platformë së paku nxorëm një koordinator që do vazhdonte rrugën e tij politike dhe diplomatike falë këtij koordinimi?!!

Sigurizimi i çështjes së veriut nga qeveria e Republikës së Kosovës

Pasi që kishte argumente të mjaftueshme se veriu dhe Serbia me strukturat paralele po përgatisnin një ndarje ose autonomi sipas modelit të Bosnjës, e ndodhur nën trysninë e tërë spektrit politik, shoqërisë civile dhe aktorëve tjerë në Republikën e Kosovës, qeveria hartoi dhe zbatoi një plan operativ përmes të cilit tentoi të rimarr pikat kufitare 1, dhe 31 dhe për të shtrirë sovranitetin territorial në tërë Republikën Kosovës. Në vlerësimin e parë mund duket se qeveria e Kosovës përmes policisë së saj po vepronte drejt (ende nuk kemi informacione publike se a kishte bekimin ndërkombëtar) dhe me sukses, por Plani ishte i rrezikshëm dhe i vështirë për tu zbatuar. Pse? Zakonisht misionet për rimarrjen e pikave strategjike brenda një territori të caktuar janë mision i ushtrisë. Dhe këtu ishte çështja kryesore e suksesit dhe e mos suksesit te këtij operacioni (varësisht nga opinioni). Operacionet ushtarake (çfarë duhej të ishte ky i kthimit të dy pikave kufitare nen sovranitetin e Kosovës e ku Serbia duhej të konsiderohej si

okupatorë në këtë pjesë të Kosovës) përgatiten në mënyrë të detajuar dhe me më së paku tri alternativa ose plane rezervë. Dhe dy janë elementet kryesore që gjatë planifikimeve të tilla garantojnë sukses: e para një inteligjencë e fortë që do të na ushqente me informacione të mjaftueshme, të shpejta, të detajuara dhe me kohë për kundërshtarin (armikun), dhe e dyta në operacione të tilla kërkohet një mbështetje e fuqishme logjistike. Duke pas parasysh se policia jo vetëm e Kosovës por në të gjitha shtetet demokratike është e trajnuar për operacione të shpejta policore dhe duke pas parasysh misionin dhe përvojën e tyre për jo qëndrueshmëri operacionale që është karakteristikë e policive demokratike, duhet të jemi të vetëdijshëm për mangësitë eventuale gjatë këtij operacioni. Dhe pasi që Republika e Kosovës nuk kishte ushtri, atëherë qeveria u detyrua që të bënte një kombinim të operacionit policor-ushtarak. Dhe në fund, edhe pse misioni i policisë nuk përkonte me këtë operacion, prapë se prapë ky operacion ishte i domosdoshëm, i suksesshëm pjesërisht por që lente shumë për të dëshiruar.

Politizimi Ndërkombëtar i Veriut- dialogu Kosovë - Serbi

Duke u sigurizuar çështja e veriut nga të gjitha palët: nga Serbia, faktori ndërkombëtar dhe Kosova, u pa se kjo çështje nuk mund të zgjidhet duke u trajtuar si kërcënim permanent ekzistencial për asnjërën palë. Përkundër përpjekjeve pa sukses të Gjermanisë që këtë çështje ta zgjidh përmes diplomacisë imponuese, atëherë edhe Serbia edhe Kosova u zunë peng nga faktori ndërkombëtar dhe Bashkimi Evropian, natyrisht nga nevoja për tu bërë pjesë e Evropës, me kërkesën e miqve ndërkombëtar dhe nën udhëheqjen e Baroneshës Ashton, Kosova dhe Serbia filluan bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, si kusht për integrim në BE. Pra tani veriu u politizua dhe u shndërrua në çështje politike ndërkombëtare. Dhe në këtë drejtim është mirë ta kujtojmë faktin se rruga drejt bashkimit Evropian nuk kishte dhe nuk ka zgjidhur çështje konfliktuoze ose problematike në Evropë sikurse ishte rasti i Qipros ose ujërave detarë mes Kroacisë dhe Sllovenisë.

Është me rëndësi të thuhet se asnjë nga aktorët e përfshirë në zgjidhjen e kësaj çështje, as faktori ndërkombëtar, as Serbia e as Kosova nuk bënë ndonjë përpjekje që këtë çështje ta zgjidhin përmes de politizimit si një element i rëndësishëm i shkollës së Kopenhagës, e që nënkupton zgjidhjen e çështjeve të tilla përmes debateve publike.

Tani pas një mori marrëveshjes të arritura gjatë bisedimeve, gjithçka duhet të fokusohet në tri çështje kryesore sidomos për qytetarët që jetojnë në veri pa dallim etnie, apo fetare:

1. Zhvillimi ekonomik;
2. Aspekti social;
3. Aspekti shpirtëror.

Në vend të përfundimit:

Çka është asociacioni i Komunave apo Autonomia kulturore dhe ajo politike?

1. Autonomia kulturore

Në Evropë ekzistojnë autonomi të tilla kurse edhe tek ne gjithnjë sipas planit të Ahtisarit, mund të krijohen asociacione komunash (autonomi) të cilat kryesisht kanë ingerenca kulturore.

2. Autonomia politike,

Këto asociacione janë autonomi të cilat kanë territor, buxhetin dhe tre pushtete, legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Një autonomi e tillë në veri, për Republikën e Kosovës do të ishte shumë e rrezikshme ose de fakto do te ishte shtet në shtet edhe pse që tani duhet të pranojmë se një element i një autonomie të tillë siç është buxheti, është realitet i pranuar si pjesë e dialogut Kosovë - Serbi. Sidoqoftë Vendimmarrësit nuk do të ishte mirë që me asnjë çmim çfarë do qoftë ai, të ofrojnë ose pranojnë një asociacion (autonomi politike) për komunat në veri të vendit tonë.

Të kujt janë resurset natyrore dhe pasuritë e kosovës

Sa është e pasur Kosova me resurse?

Sipas disa kërkimeve të mëhershme, në basenet e Kosovës, rezervat e lignitit janë mbi 15, 7 miliardë tonë, ose siç kishte deklaruar dikur UNMIK-u, këto rezerva janë gjithsejtë 8.3 miliardë tonë. Në bazë të kësaj mund të llogarisim se këto rezerva do të përdorën gjatë 150 apo 200 viteve të ardhshme. Nëse këtë e llogarisim me çmimin minimal për tonelatë, ligniti i Kosovës vlen 250 miliardë dollarë. Resurset natyrore dhe pasuritë e Kosovës shpesh herë janë tema studimi jo vetëm në Ballkan, Evropë, por edhe në botë. Sipas shkrimeve dhe debateve serbe të cilët thonë se arsye e vetme për intervenimin e NATO-s në Kosovë ishin pikërisht resurset dhe pasuritë e Kosovës, e jo çështjet humanitare, del konstatimi se serbët po shpalosin gënjeshtrën e tyre shekullore se e donin dhe e duan Kosovën jo për arsye "rrënjësh" "mitesh" apo arsye fetare, por ata në të vërtetë e duan atë (Kosovën) thjesht për arsye koloniale. Sidoqoftë, Banka Botërore kishte vlerësuar se vetëm rezervat minerare të Kosovës, vlejnë 13.5 miliardë euro. Rezervat e plumbit dhe zinkut thuhet se janë më pak se 7, nikelit dhe kobaltit deri në 13.3 milionë tonelata, xehja e boksitit 1.7 milionë tonë kurse për rezervat e magnezit thuhet se mund të arrijnë deri 5.4 milionë tonë edhe pse sipas disa vlerësimeve tjera këto arrijnë deri 8 milionë tonë. Përveç kësaj në Kosovë eksploatohen edhe xehet e argjendit, hekurit, e gjithashtu edhe mineraret e rralla si indiumi, kadmiumi, germaniumi, taliumi dhe galiumi. Edhe pse nuk janë bërë kërkime të mjaftueshme, njihen edhe gjetjet me ar, platin dhe bakër. Gjithnjë sipas studimeve serbe mendohet se 60% e resurseve natyrore dhe pasurive gjenden në territorin e Kosovës. Përveç qymyrit që sipas shënimeve te deri tashme janë mbi 20 miliardë tonelata (thuhet se tëre regjioni shtrihet mbi qymyr), në Kosovë gjenden edhe elemente shumë të shtrenjta strategjike si kadmiumi, kobalti, nikeli etj.

Të kujt janë lumenjtë tanë?

Dikush mund të më tall apo injoroj me këtë pyetje që e shtrova në këtë opinion, por fjala e fundit në këtë nëntitull tregon se lumenjtë janë tanët. Me fjalën "tanë", kuptojmë të këtij vendi, të këtij populli, të qytetarëve të Kosovës, të çdo individi veç e veç sepse kur nuk i ruajmë kur i ndotim, kur i degradojmë (pavarësisht se

tërë këto dëmtime kryesisht i bëjnë kompanitë private profitere), anatema e degradimit të lumenjve dhe mjedisit bie mbi qytetarët e pafajshëm të Kosovës. Pra thellë në ndërdijen e profiterëve dhe grupeve kriminogjene ekologjike ekziston bindja se ata po përfitojnë nga të mirat e përgjithshme, nga të mirat që janë pronë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Detyrë e institucioneve tona është që të ruhet ky resurs jetik dhe strategjik për qytetarët e këtij vendi dhe për gjeneratat e ardhshme duke pas parasysh parashikimet botërore se në 100 vitet e ardhshme luftërat kryesore do të shkaktohen për resurset ujore - ujin e pijshëm. Shteti duhet të kujdeset që asnjë kompani private mos të vendos monopol mbi lumenjtë tanë, mbi burimet e ujit të pijshëm dhe duhet të kujdeset që secili njeri të mund të shfrytëzojë këtë ujë pa pagesë. Mund të ndodhë që një ditë kur uji të bëhet aq i domosdoshëm dhe aq i shtrenjtë, kompanitë dhe individët e pa përgjegjshëm të ruajnë burimet e ujit me ushtritë e tyre private dhe mos të na lënë as ta shuajmë etjen me ujin tonë e lëre më që ta përdorim për nevojat tjera. Dhe kjo kohë mund të vijë shumë shpejt. Ujërat janë e mirë e përgjithshme (common goods, biens communs), dhe në këtë mënyrë i përkasin njerëzimit, kurse ata që e shesin ujin, pronën tonë të përbashkët janë armiqtë e njerëzimit dhe është mirë që t`u pamundësohet këtyre kapitalistëve tregtia me ujin tonë të përbashkët.

E kujt është energjia e jonë?

A është e arsyeshme dhënia e shfrytëzimit të lumenjve me koncesion, privatizimi i sistemeve elektro energjetike si dhe ndërtimi i hidro dhe termocentraleve, institucioneve ndërkombëtare dhe kompanive multi nacionale? Nisur nga logjika e thjeshtë kjo edhe mund të jetë pjesërisht e arsyeshme por nëse pyesim se pse këto shtete dhe kompani nuk ndërtojnë kapacitete të tilla të tejkaluara në vendet e tyre pasi që këto qenkan kaq fitim prurës? Kur është ndërtuar termocentrali i fundit në Evropën perëndimore? Këto vende që moti janë përshëndetur me këto gjëra sepse janë ngopur me ndotjen e ambientit, kishin shkatërruar thuaja se tërë ekosistemin e tyre, kishin shkaktuar një klimë jo të favorshme për jetë dhe as që u shkon ndërmend ta bëjnë për herë të dytë të njëjtin gabim. Kompanitë e mëdha

multinacionale janë të interesuara që përmes grupeve të ndryshme të marrin me koncesion resurset tona kështu që paratë nga shitja e energjisë nuk do të ndalen në vendin tonë e as të mbushin buxhetin e institucioneve tona por do të përfundojnë në xhepat e individëve dhe xhirollogaritë anë kënd botës, përveç Kosovës. Ngadalë po shkojmë drejt sistemit i cili të drejtën në pronën private e kupton si të drejtë për jetë, kuptohet që pushtet mbajtësit kudo nëpër botë (rregull e egër e politikës kapitaliste) për gjithçka të gjallë dhe jo të gjallë mbi këtë tokë e kanë caktuar pronarin. Vetë ideja e pronës mbi natyrën është absurde. Mënyra se si do t'i qasemi pronësisë ndaj resurseve dhe zgjidhja e drejtë e kësaj çështje do të determinojë të ardhmen jo vetëm të vendit tonë por tërë planetit tokë, bimëve dhe kafshëve, neve vet dhe gjeneratave që do të vijnë. Shtetet serioze i kushtojnë një kujdes të madh energjisë, për këtë arsye nuk rreshtin ditë as natë duke bërë studime për alternativat e mundshme energjetike, qoftë për shkak të kostos, qoftë për shkak të mos pasjes apo ruajtjes së resurseve të tyre ose thjesht për shkak të ruajtjes së mjedisit. "Nga disa hulumtime në Kosovë, si mundësi alternative e burimit të energjisë janë:

- Energjia solare;
- Energjia nga përpunimi i mbeturinave dhe
- Energjia e erës."

Ushqimi

Kosova dikur ishte një vend i pasur dhe një vend i cili mund të siguronte për banorët e saj ushqim të bollshëm dhe të shëndetshëm. Tani çdo ditë e më tepër tokat bujqësore po zëvendësohen me blloqe betoni deri sa një ditë do të na marr malli të shohim pak dhe toke pa beton. Bujqësia, dhe blegtoria, me tërë degët e tyre tani vetëm sa janë një sinonim simpatik i të së kaluarës. Mos të flasim për bio produktet malore qoftë ato ushqyese apo shëruese. "Sipas analizave vendore dhe ndërkombëtare (AZhER), Kosova është një importues i madh i produkteve bujqësore (me rreth 25 % te vlerës se tërësishme të importit vendor). Bujqësia në Kosovë karakterizohet me ferma të vogla, produktivitet të ultë dhe një shërbim

të dobët kështillë dhënës. Kjo lëmi në Kosovë përfshin rreth 1800 kooperativa dhe kompani që merren me bujqësi dhe gati 143 mijë ekonomi familjare, ku dy të tretat e tyre janë ferma me më shumë se një hektar tokë".

Shembulli degradues i Regjionit të Prizrenit - Hardhia e Rrushit

Prizreni para luftës në sektorin shoqëror kishte 1500 ha të mbjella me hardhi të rrushit ndërsa sektori privat kishte sipërfaqe gati tri herë më shumë dhe me lloje të ndryshme. Ky regjion ishte më i njohuri në Ballkan për rrush dhe verë cilësore. Nga ky regjion eksportohej verë me vlerë prej mbi 100 milionë euro në vit. Në dekadën e fundit është për keqardhje ajo çfarë ka ndodh me vreshtat dhe verarinë e regjionit të Prizrenit kur të merren parasysh kushtet e volitshme agroklimatike dhe tokësore për kultivimin e hardhisë së rrushit. Për fat të keq Prizreni, Suhareka dhe Rahoveci si kultivues të hardhisë dhe verës, po shtrydhen nën darën e çeliktë të privatizimit, i cili do të ketë pasoja shkatërruese për këtë degë të bujqësisë.

Trendët botërore

A ka bota një strategji të përbashkët në luftën kundër fantazmës së urisë e cila vetëm sa po vije duke u përhapur? Paralajmërimi madhështor i samitit të FAOS në kryeqytetin e Italisë në vitin 2008 kishte filluar me thirrjet shqetësuese për solidaritet të të pasurve ndaj të uriturve, për premtimet e mëdha në miliarda euro ndihmë të prekurve, por edhe me kritika të ashpra zhvillimit të tashëm. Prodhimi botëror i ushqimit duhet të rritet për 50% deri në vitin 2030, në mënyrë që të plotësohen nevojat e rritura të kërkesës, ka deklaruar sekretari gjeneral i Kombeve të Bashkuara Ban Ki Mun, në samitin e Romës, samit i cili po i kushtohej problemit të kërcimit të madh të çmimeve të ushqimit. Presidenti i FAO-s Zhak Diuf ka tërhequr vërejtjen se: në luftën kundër urisë, gjithnjë e më gjithëpërfshirëse, pjesa e pasur e botës duhet të kalojë nga fjalët në vepra, në të kundërtën, uria nuk do të mund të çrrënjoset as deri në vitin 2150". Ndërkohë që, nga fushat pjellore anekënd botës vijnë informacione për një korrje shirje

rekorde. Uria e cila sot po merr botën nuk mund të ç'rrënjoset lehtë për arsye se zgjidhja e krizës së tashme nuk u shkon për shtati kompanive multinacionale, dhe një numri të caktuar të qarqeve punëdhënëse", ka tërhequr vërejtjen, organizata joqeveritare Jug afrikane e quajtur: "Aksioni për Ndihmë". Në fjalimin për pjesëmarrësit e Samitit të FAO-s, papa Benedikti 16-të, ka tërhequr vërejtjen se botës nuk guxon ti mungojë solidariteti. Njeriu i shek. 21 dëshiron ti ruaj të mirat e përgjithshme si : ushqimin, ujin dhe energjinë, të cilat për fatin tonë të keq janë atakuar në mënyrën më barbare dhe më të paskrupullt nga kompanitë dhe korporatat multinacionale.

Pronë e kujt janë dhe kush duhet ti menaxhojë resurset natyrore dhe pasuritë kombëtare

Të gjitha resurset dhe pasuritë kombëtare si lumenjtë, liqejtë, pyjet, xehet dhe mineraret, janë elemente jetike për bashkësinë njerëzore të një vendi dhe natyrisht janë pronë e tij. Mbijetesa e bashkësive që e popullojnë një territor është tërësisht e varur nga kushtet klimatike dhe resurset e atij vendi, për këtë arsye edhe quhen pasuri kombëtare. Duke pas parasysh këtë logjikë, mund të konkludojmë se e mirë është vetëm ajo që shkon në dobi të bashkësisë dhe mjedisit jetësor, kurse në të kundërtën është e keqe dhe e dëmshme gjithçka që dëmton bashkësinë dhe mjedisin jetësor. Sipas këtij principi do duhej që mënyra e drejtë dhe përgjegjshme për të menaxhuar dhe ruajtur resurset do të ishte që të gjithë qytetarët e atij vendi të kenë qasje të njëjtë në resurse, në mënyrë që të gjithë së bashku të kujdesen për ruajtjen e tyre dhe mjedisit jetësor. Në natyrë mbretërojnë ligjet e ndër varshmërisë, kështu që zhdukja e një lidhjeje në ekosistem dhe në zinxhirin ushqimit do të thotë shkelje e balancit natyror që shkakton zhdukjen e shpejtë të llojeve të tjera. Duke i shkoqitur të gjitha këto që i thamë më lartë, biem në konkludim se mënyra më e mirë për të mbrojtur dhe menaxhuar resurset natyrore dhe pasuritë kombëtare është ajo demokratike, mënyra përmes së cilës kuptojmë se të gjithë ne, së bashku të marrim pjesë në vendimmarrjet prej të cilave varet mbijetesa jonë, e ardhmja e jonë. Mënyra demokratike e menaxhimit të resurseve natyrore, pasurisë kombëtare dhe

resurseve strategjike do të ishin debatet publike në të gjitha nivelet që nga sensibilizimi i fëmijëve nëpër shkolla, forume rinore, gjeneratës së mesme dhe të vjetër, niveleve akademike dhe nëse është e nevojshme pse jo edhe përmes deklarimit të qytetarëve me referendum për mënyrën e shfrytëzimit të resurseve. Kjo do të ishte mënyra e vetme dhe më demokratike e ruajtjes së resurseve natyrore dhe pasurisë kombëtare.

Kush do të përfitojë nga shitja e resurseve?

Nga procesi i privatizimit në Kosovë deri tash kemi vërejtur se në vend të zhvillimit dhe prosperitetit, kompanitë e privatizuara kanë sjell vetëm papunësi enorme, të drejta të shkelura të punëtorëve, falimentime, privatizime të dyfishta, të cilat edhe mund të mbushin arkën që nuk e dimë se të kujt por asnjëherë dhe shumë rrallë kemi parë një kompani që është e suksesshme pas privatizimit në Kosovë. Shembujt nga vendet të cilat e kanë kaluar procesin e privatizimit na flasin për një përvojë të hidhur p.sh. çmimet e energjisë elektrike pas privatizimit në ato vende ishin rritur në mënyrë drastike, kurse kualiteti i shërbimeve ishte zvogëluar në minimum. Sidoqoftë është e vërtetë se më së shumti në rastet e privatizimit do të goditen banorët e zonave ku do të ndërtohen ta zëmë termocentrale apo hidrocentrale, sepse kështu do të ndryshojë tërësisht klima, do të ndodhë ndotja, shkatërrimi dhe zhdukja e florës dhe faunës, e në vend të suksesit dhe prosperitetit do të shkaktojmë një ekocid të pafalshëm të llojit të veçantë.

12:59 / 26.06.2011, telegrafi.com

Emergjencat civile si pjesë strukturale e sigurisë nacionale

Kush dhe si do ti Menaxhoj Emergjencat / Fatkeqësitë në Nivelin Lokal

Fundi i shekullit 20 dhe fillimi i shek 21 kanë vënë botën para sfidave të mëdha, duke e ballafaquar këtë botë me rreziqe të ndryshme dhe të paparashikuara.

Secili shtet në botë e ka mënyrën e vet për të menaxhuar fatkeqësitë, krizat dhe katastrofat, deri te luftërat. Natyrisht mënyrat gati pothuajse janë të njëjta , por dallojnë fatkeqësitë, gjeografia e secilit vend, demografia, zhvillimi ekonomik dhe çështje tjera specifike që përcaktojnë mënyrën e Menaxhimit Emergjent. Duhet pas parasysh se emergjencë është ç`do rrezik i mundshëm dhe i menjëhershëm, duke filluar nga një gropë në asfalt, tjegull e varur mbi çati, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësitë tjera e gjer tek aktet terroriste. Sidoqoftë qasja ndaj Menaxhimit Emergjent duhet të jetë integruese dhe e përbashkët. Kur SHBA-të u ballafaquan me sulmin terrorist mbi kullat binjake, u detyruan që tërësisht ta ndërrojnë strukturimin dhe mënyrën e Menaxhimit Emergjent. Tani ata dhe disa shtete tjera përdorin mënyrën e integruar të Menaxhimit Emergjent që donë të thotë se në planifikim, preventivë, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje marrin pjesë të gjitha strukturat shtetërore, jo vetëm ato të dedikuara për Menaxhimin Emergjent, si pjesë e mbrojtjes civile, por edhe biznesi privat, organizatat humanitare, shoqatat e ndryshme etj. Dhe ajo që është thelbësore, Menaxhimi Emergjent kalon nga faza e Vlerësimit deri te mbikëqyrja (monitorimi) permanent i rreziqeve (menaxhimi i Integruar i rreziqeve).

Në Kosovë, pas ardhjes së Misionit Ndërkombëtar, u krijua Departamenti i Sigurisë Civile dhe Gatishmërisë Emergjente, i cili në një mënyrë do të plotësonte Ministrinë e Rendit e cila mungonte atëherë! Pastaj kishte lindur një ide që ky Departament të shndërrohej në Ministri me po të njëjtin emër, gjë e cila nuk ndodhi dhe u pengua edhe pse kishte nevojë për të. Kishte më shumë se një dekadë që në Kosovë çështjet e ish Mbrojtjes Civile si planifikimi, preventiva, gatishmëria, reagimi dhe rimëkëmbja ishin lënë pas dore për arsye të njohura dhe pa fajin tonë. Sidoqoftë, përpjekjet, më shumë ndërkombëtare se sa vendore për të krijuar një sistem të Sigurisë në Kosovë, rezultuan me një sistem heterogjen të funksionimit të Mbrojtjes Civile. Me këtë rast u krijuan struktura të veçanta thuajse me misione të njëjta që trajnoheshin për fusha të njëjta por që ju pamundësohej reagimi në Emergjenca, jo vetëm bashkërisht me strukturat tjera por edhe veç e veç, si: DME, TMK..

Sa i përket Departamentit të Sigurisë Civile dhe Gatishmërisë Emergjente, përbrenda tij ekzistonte apo thënë më mirë u krijua një strukturë hierarkike deri te Qendrat Regjionale për Alarmim dhe Koordinim. Kjo hallkë këputet te Drejtoritë Komunale për Gatishmëri Civile Emergjente, sepse këto drejtori vepronin dhe ende veprojnë në kuadër të Kuvendeve Komunale pa pasur asnjë lidhje funksionale me Departamentin – Drejtorinë- Agjencinë (në nivel regjional dhe qendror).

Që nga fillimi i krijimit të këtyre drejtorive, kishte paqartësi rreth misionit dhe emërtimit të tyre. Edhe sot e kësaj dite këto drejtori nëpër komuna të ndryshme kanë emërtime të ndryshme, si p.sh: Drejtori për Siguri, Drejtori për Gatishmëri Civile dhe Emergjente, Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim etj..

Është e natyrshme që të gjitha emergjencat dhe fatkeqësitë ndodhin në nivel lokal, dhe natyrisht edhe duhet të menaxhohen nga niveli lokal, prandaj është shumë me rëndësi shkalla e organizimit dhe e reagimit të këtij niveli ndaj Emergjencave.

Në Kosovë dhe përgjithësisht në vendet ish komuniste ka ekzistuar e ashtuquajtura Mbrojtja Civile kështu që pas luftës funksionet me rëndësi në fushën e Menaxhimit Emergjent i morën kryesisht ish ushtarakët e APJ-së, të cilët kishin njohuri të mjaftueshme në Mbrojtjen Civile, por fatkeqësisht një sistem i tillë i organizimit ishte tejkaluar që moti dhe këta njerëz edhe pse me një vullnet të mirë, ballafaqohen dhe kanë probleme të ndryshme me mënyrat dhe qasjet moderne të Menaxhimit Emergjent. “Si pasojë e tërë kësaj, ishte edhe paraqitja e ligjit për aprovim në parlament për një sistem të Menaxhimit Emergjent (Mbrojtja Civile), i cili ishte një përzierje e ish Mbrojtjes Civile me disa elemente të pakta të menaxhimit modern të emergjencave dhe i cili për fat të keq u miratua”[24]. Për habi ky ligj nuk u kundërshtua as nga UNMIK-u, ku kishte njerëz dhe specialistë që e njihnin mirë këtë fushë. Prapë se prapë një gjë duhet pas parasysh, sot Menaxhimi Emergjent është ngritur në një shkencë dinamike, sepse këtë e diktojnë zhvillimet e mëdha ekonomike, teknologjike dhe shoqërore dhe do të ishte mirë të përcillej dhe të implementohej edhe nga ne.

[24] Ligji për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera-2006-2011

Cikli i menaxhimit Emergjent ka pesë faza: Parandalim, Gatishmëri, Reagim, dhe Rimëkëmbje, kurse Lehtësimi (Zvogëlimi) është një veprim që mund të futet në të gjitha fazat që nga parandalimi e dri te rimëkëmbja. Mbi këto baza duhet të funksionojë Menaxhimi Emergjent që nga niveli lokal, regjional e deri te ai qendror. Edhe pse është bërë një punë e konsiderueshme, mbetet shumë për të dëshiruar, sepse duke filluar nga niveli lokal, kanë munguar dhe ende mungojnë vlerësimet e rreziqeve, planet preventive, planet e gatishmërisë, pastaj programet për vlerësimin e gatishmërisë (programe dhe plane të trajnimeve dhe ushtrimeve), të cilat janë të domosdoshme për përgatitjen njësive për reagim dhe institucioneve me mandat sigurie për menaxhimin e fatkeqësive të të gjitha llojeve.

Kuvendet Komunale dhe Menaxhimi Emergjent

Deri në vitin 2007 ekzistonin Drejtoritë për Gatishmëri Civile Emergjente ose me emra tjerë sipas dëshirës dhe bindjeve të drejtorëve që udhëhiqnin këto drejtori, por në fakt cili ishte misioni këtyre drejtorive? Këto drejtori kishin dhe kanë shumë punë për të bërë dhe natyrisht, detyrë e kishin dhe kanë që të merren me pesë fazat e Menaxhimit Emergjent që i përmendëm më lartë, njëkohësisht drejtorët janë edhe këshilltarët e parë të kryetarit të komunës gjatë menaxhimit të një emergjence apo fatkeqësie dhe pikërisht për këtë arsye është e domosdoshme të krijohen Qendra Operative Emergjente jo vetëm në nivel komunal por edhe në shkolla, biznese private etj. Natyrisht gjatë një fatkeqësie duhet të ngritët komiteti komunal për mbrojtje dhe shpëtim. Këtu po japim një shembull të përbërjes së Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim në nivel lokal, për të menaxhuar një fatkeqësi apo emergjencë:

- Kryetari i Komunës;
- Drejtori i DGCE (tani - Mbrojtjes dhe Shpëtimit);
- Drejtorët e drejtorive tjera;
- Komandanti Policisë lokale;
- Komandanti i Zjarrfikësve;
- Përfaqësuesi i Sektorit Privat;
- Kryqi i Kuq Lokal

- Shoqatat Humanitare, dhe OJQ-të;
- Mediet.

Nuk do të zgjatem për të shpjeguar për personelin e nevojshëm, lokacionin dhe pajisjet për një Qendër Operative Emergjente por tani me strukturimin e ri të kuvendeve komunale, me rritjen e kompetencave për kryetarët e komunave dhe me zvogëlimin e numrit të drejtorive do të shtrohet pyetja se si dhe a mund të menaxhohet me sukses një fatkeqësi me përmasa shqetësuese për nivelin lokal? Edhe në kohën kur këto drejtori thuajse ishin të kompletuara dhe me kompetenca për të punuar në këtë drejtim, rezultatet e tyre ishin të vogla bile nga një herë edhe të padukshme. Tani kur këto drejtori në disa komuna të mëdha nuk ekzistojnë dhe me rregullimin e ri të drejtorive komunale, shpresë e vetme mbetet që kryetarët e komunave ta shfrytëzojnë të drejtën për krijimin e këtyre drejtorive. Dhe krijimi i drejtorive që do të merren me Menaxhimin Emergjent është nevojë e domosdoshme.

Korrik 2011.

Krizat, llojet dhe menaxhimi i tyre

Fjala krizë rrjedh nga fjala greke " krisis" që donë të thotë "vendim".

Një krizë në thelb është një situatë e cila kërkon një vendim të shpejtë për të minimizuar dëmin ose që të sigurojë një zgjidhje. Krizat janë të vjetra po aq sa shoqëria njerëzore. Njeriun si individ dhe shoqërinë, që nga koha primitive e kanë përcjell rreziqe të shumta dhe nga të gjitha anët. Vetëm at ata cilët kishin aftësi ti parashihnin rreziqet dhe të përgatiteshin në mënyre adekuate për to, kishin mundësi të mbijetonin. Fillimisht nga këto përpjekje primitive për tu përballë me kriza, dhe për të mbijetuar, nëpër shekuj njerëzimi është përpjekur të gjej ndonjë metodë e cila do të kishte për qëllim që të parasheh dhe mbrojë njeriun nga rreziqet e mundshme, që të organizojë dhe menaxhojë drejt resurset, në mënyrë që të reagojë dhe rimëkëmbet nga fatkeqësitë, si dhe të krijojë mekanizmat (menaxhimi i krizave), që ato mos të përsëriten më.

Kriza definohet si një gjendje, gjatë së cilës kërcënohen vlerat dhe normat themelore të subjektit që është atakuar. Për krizën është karakteristike presioni i kohës me rastin e vendim marrjes dhe udhëheqjes në kriza, sepse krizat dhe menaxhimi i tyre janë fenomene të lidhura ngushtë, të cilave teorikët dhe hulumtuesit i japin më së shumti rëndësi. Çdo krize i paraprin një rrezik dhe kërcënim. Kërcënimi është një ngjarje, fenomen apo aktivitet njerëzor i cili ndodh papritmas dhe në një moment të caktuar. Nëqoftëse në këtë moment nuk jemi në gjendje të reagojmë në mënyrën e duhur, kërcënimi kalon në krizë kurse situata e krizës lehtë mund të eskalojë në katastrofë. Duke analizuar rreziqet e sotme, mund konkludojmë se ato mund të vijnë nga jashtë dhe nga brenda. Çdo ditë jemi dëshmitarë të incidenteve, grevave, protestave, demonstratave fatkeqësive natyrore, konflikteve etj., të gjitha këto kanë një emërues të përbashkët dhe nëse me kohë nuk i parashohim dhe nuk përgatitemi për to në mënyrë adekuate, pra lehtë mund të ballafaqohemi me një krizë. "Funksioni i çdo shteti, si një organizatë politike, reflektohet edhe në detyrimin e tij për të ofruar sigurinë e nevojshme për të gjithë qytetarët nëpër fusha të ndryshme të aktiviteteve, sidomos në parandalimin e formave të ndryshme të dhunës, krimit të organizuar, terrorizmit, rendit publik dhe sigurisë, drogës etj. Siguria është funksioni themelor i shtetit, duke pas parasysh se pa një nivel të nevojshëm të sigurisë nuk mund të flasim për qeverisje demokratike e as për stabilitetin e një shoqërie në përgjithësi"[25]. Shtetet e ndryshme kanë interesa kombëtare të dallueshme kështu që si pasojë edhe rreziqet dhe kërcënimet nuk janë të njëjta për të gjitha shtetet. Shtetet e vogla ballafaqohen me më shumë rreziqe, kërcënime dhe kriza, sidomos ato që janë shtete të reja ose që kanë pasur transformime të rëndësishme si: shtetet e posa dala nga lufta ose shtetet në tranzicion. Në kuptimet moderne të sistemit të sigurisë nisemi nga fakti se konceptet themelore si siguria e individit, shoqërisë dhe e bashkësisë ndërkombëtare, trajtohen nëpërmjet këtyre kornizave konceptuare themelore, domethënë: të sigurisë individuale, kombëtare, të sigurisë ndërkombëtare(regjionale), dhe globale. Sipas

[25] Tatalović, S., *Nacionalna sigurnost Republike Hrvatske i sigurnost na jugoistoku Europe*, izlaganje na znanstvenom skupu, Vrbovsko, 2001. Dobavljeno iz "http://hr.wikipedia.org/wiki/Nacionalna_sigurnost

formave (të sigurisë së veçantë), dallojmë: sigurinë politike, ekonomike, sociale, juridike, ekologjike, shtetërore, komunikacionit, siguria ushtarake etj..

Rreziqet globale kanë efekte për mbarë botën dhe në dukje mund të mos kenë efekt tek ne, por në fakt këto rreziqe mund të prishin balancat e interesave ndërkombëtare dhe shpejt mund t ë bëhen kërcënime shtetërore (kombëtare), rajonale dhe ndërkombëtare. Rreziqet Rajonale (me premisa ndërkombëtare) i ekspozohen një rajoni dhe kanë efekte të natyrave të ndryshme, mbi shumicën e vendeve të rajonit (edhe ndërkombëtare), në rastin tonë: Maqedonia, Serbia, Kosova, Shqipëria, Greqia, Bosnja, Kroacia, dhe Mali i Zi. Këto vende ndikohen nga pabarazia e zhvillimit ekonomik, politikat e spastrimit etnik, flukset e refugjatëve, emigracioni i paligjshëm, trafiqet ndërkombëtare, arsenali i armatimit në popull, mos administrimi i problemeve të minoriteteve etj.

Rreziqet dhe kërcënimet e brendshme (kombëtare), klasifikohen si rreziqe që i drejtohen një vendi dhe kanë efekte mbi atë vend. Në rreziqet e brendshme, faktori i brendshëm luan rol vendimtar por që nuk mund të injorohet edhe efekti dhe ndikimi nga jashtë. Gjithashtu shpesh herë gjatë historisë, në vende të ndryshme të botës edhe rreziqet individuale, kanë arrit të marrin përmasa të rreziqeve ndërkombëtare dhe globale.

Shteti, territori dhe kufiri nuk janë vetëm hapësirë dhe kufi të sovranitetit por janë ambient shoqëror – ekonomik, që ushtrojnë ndikim në historinë dhe politikën e një vendi (territori), kurse me territorin në mënyrë organike është i lidhur edhe kufiri shtetëror e që ka të bëjë shumë me sferën e sigurisë.

Llojet e krizave:

Gjatë procesit të menaxhimit të krizave është me rëndësi të identifikohen llojet e krizave, në mesin e krizave të cilat kërkojnë prioritet dhe strategji të ndryshme për menaxhimin e tyre. Potencialet mund të jenë të shumta por krizat zakonisht kategorizohen në shtatë lloje:

1. Katastrofat natyrore, 2. Krizat teknologjike, 3. Konfrontimet, 4. Keq bërjet,
5. Krizat e keq menaxhimit të vlerave, 6. Krizat e mashtrimit dhe 7. Krizat e abuzimeve - thashë themet.

Burimet që ndikojnë në Rreziqet dhe kërcënimet e brendshme janë: Zhvillimi i ultë ekonomik, pabarazia shoqërore, diskriminimi i grupeve etnike dhe fetare, mos kompaktësia kombëtare, lidershipi i keq, predominimi i popullsisë me mentalitet rural, brishtësia e institucioneve demokratike, mos respektimi i të drejtave të njeriut, pluralizmit politik dhe ekonomisë së tregut të lirë. Kosova ballafaqohet me disa lloje të rreziqeve dhe kërcënimeve si: kërcënimet me karakter etnik, strukturat paralele, rreziqet dhe kërcënimet territoriale, rreziqet dhe kërcënimet e jashtme, mospranimi i pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, si dhe rreziqet dhe shumë forma të ndryshme të kërcënimeve të brendshme.

Trendët aktuale me implikime rajonale dhe ndërkombëtare për Kosovën janë:

Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, dilemat rajonale dhe ndërkombëtare për pranimin apo mospranimin e pavarësisë së Kosovës, bisedat e mundshme shqiptaro serbe, gjendja e shqiptarëve në Maqedoni, gjendja e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, kriza ekonomike dhe financiare në Greqi, dhe kriza politike në Shqipëri.

Trendët aktuale të brendshme në Kosovë janë:

Mungesa e ligjeve që sanksionojnë rrezikimin e integritetit dhe sovranitetit, strukturat paralele, mos funksionimi i shtetit ligjor në veriun e Kosovës, sistemi i dobët gjyqësor, dhe mungesa e kapaciteteve të sigurisë.

Faktorët që e përkeqësojnë situatën ose e kërcënojnë sigurinë e vendit janë:

Korrupsioni, krimi i organizuar, ekonomia informale, gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale, pakënaqësitë politike dhe trafiqet ndërkombëtare. .

Menaxhimi i Krizave është një fushë relativisht e re e menaxhimit. Aktivitetet pro aktive të administrimit të krizave, në mënyrë tipike, përfshijnë parashikimin e krizave të mundshme dhe planifikimin se si të merremi me to. Është mirë që organizatat të kenë kohë dhe burime për të përfunduar një plan të menaxhimit të krizave para se ato të përjetojnë një krizë. Menaxhimi dhe përballimi me një krizë përfshin identifikimin, natyrën e vërtetë të krizës aktuale si dhe ndërhyrjen për të

minimizuar dëmin dhe për tu rimëkëmbur nga kriza. Kriza shpesh përfshin përqendrim të fuqishëm në marrëdhëniet publike për të mbuluar ndonjë dëmtim të imazhit publik dhe për të siguruar palët e interesuara se rimëkëmbja është duke u zhvilluar.

Simbolet dhe veprimet dramatike në menaxhimin e krizave

Ndodh shpesh që institucionet me mandate sigurie vetëkënaqen me tituj, bombastik si lufta kundër kësaj apo asaj, ose mjaftohen me strategji dhe plane, pastaj me dokumente për menaxhimin e krizave, që vetëm mund të jenë deklarata që në fakt as nuk i parandalojnë as nuk i zvogëlojnë rreziqet dhe kërcënimet. Në vendet e zhvilluara dhe demokratike çështjet e sigurisë shpesh herë menaxhohen pa strategji dhe dokumente të tilla por vetëm përmes objektivave (Gjermania). Vetëm hartimi i strategjive dhe dokumenteve si akt, nuk mjafton për të menaxhuar një krizë. Sidoqoftë gjestet dramatike politike gjithkund në botë manifestohen përmes formave të ndryshme. Njëra prej këtyre qëndron edhe në inicimin e madh të "iniciativave politike" që karakterizohen me asociacione të shpejta simbolike duke ose për të përfituar një mbështetje të gjerë. Për shembull në sloganet "lufta kundër drogës", lufta kundër AIDS-it", " lufta kundër varfërisë", bëhet fjalë për përdorimin e metaforave ushtarake dhe në lidhje me këtë dramatizim, janë të rëndësishme edhe veprimet e personalizuara dramatike, kryesisht në formë rituali, që zhvillohen sipas rregullave të pashkruara, plotësisht të sakta dhe të cilat përcaktojnë rregullat standarde të sjelljes së duhur si: (në përurimin apo degradimin e zyrtarëve të caktuar, letrat presidenciale publike, bisedave mes kryeministrit dhe krerëve të opozitës, konferencave të rregullta për shtyp, vizitave zyrtare ndër shtetërore etj). Simbolet dhe veprimet dramatike strukturojnë jetën politike dhe përçojnë mesazh të rëndësishëm për ata që nuk janë drejtpërdrejt pjesëmarrës në këtë proces. Kështu këto simbole dhe veprime kryejnë një rol të rëndësishëm për ruajtjen e rendit dhe stabilitetit politik. Ose si thotë Edelman "përdorimi i dramaturgjisë politike, gjuhës dhe simboleve me qëllim, shërben për marrjen e pëlqimit të

atyre që i nënshtrohen autoritetit me gjithë dallimet e mëdha në pasuri, pozitë dhe pushtet"[26].

Duke e pas parasysh që Republika e Kosovës është një shtet i ri dhe si i tillë ka mundësi reale të përballet me të gjitha llojet e mundshme të krizave, është mirë të themelohet një Qendër apo Institut për Zvogëlimin e Rreziqeve dhe Menaxhimin e Krizave, që do të kishte parasysh këto çështje me rëndësi në fushën e menaxhimit, për të gjitha llojet e krizave si:

1. Paralajmërimi i hershëm i krizës (Early warning);

2. Shpërthimi i krizës dhe analiza e saj në proces;

3. Analiza e ndryshimit të raportit të forcave në krizë;

4. Menaxhimi krizës dhe

5. Llojet e zgjidhjes së krizës.

Ne qoftë se kriza merr dimensione rajonale dhe ndërkombëtare duhet të përdorën edhe këto dy elemente, si vazhdimësi për zgjidhjen e krizës si: **Diplomacia për zgjidhjen e krizës** dhe **Arritja e marrëveshjes diplomatike për zgjidhjen e krizës.**

Korrik 2011

Plani operativ "veriu"

Nuk e di se si e kishte quajtur Qeveria e Kosovës këtë plan, por duke e ditur se zakonisht një plan operativ ushtarak, policor apo i emergjencave civile ose çfarëdo plani qoftë, duhet ta ketë një emër dhe unë e pagëzova me emrin "Veriu". Fillimisht me pak fjalë dua të sqaroj se çka është një plan operativ. Pra ky është një planifikim i organizuar për një ngjarje, fatkeqësi, incident apo krizë të caktuar dhe të vlerësuar nga ana e shkallës së rrezikshmërisë i cili përcakton situatën, ndan detyrat dhe përgjegjësitë për të gjithë pjesëmarrësit në operacion. Për dallim prej planeve operative të sistemit të lindjes, planet sipas sistemit dhe modelit perëndimor (NATO-s) kanë vetëm pesë paragrafë, siç i përdor sot edhe Forca e Kosovës për Siguri ose edhe policia e Kosovës, e cila, nuk e di se pse,

[26] Edelman, Murray (2003) Konstrukcija politickog spektakla, Politicka kultura, Zagreb

por i quan pesë pikat e Komandës. “Plani Operativ ka një ndarje shumë të thjeshtë të lehtë dhe shumë funksionale e që ndahet në:

1. Situata;
2. Misioni;
3. Detyrat për njësitë reaguese;
4. Mbështetja logjistike dhe;
5. Komanda dhe komunikimi”;[27]

Në të gjitha Planet Operative qofshin ato ushtarake, policore apo të emergjencave civile, paragrafi i parë apo situata, përcakton gjithçka dhe hartohet nga inteligjenca e cila e njeh mirë situatën, nëse situata është ushtarake, duhet të përshkruhet armiku deri në detajet më të vogla dhe ajo që është më e rëndësishmja situata përcakton edhe suksesin e operacionit. Në këtë paragraf, përshkruhen gjërat deri në detaje, përshkruhen dhe parashikohen rreziqet e mundshme, mundësitë e humbjeve në njerëz, në pajisje dhe teknikë, në humbjen e kredibilitetit vendor dhe ndërkombëtar, rreziqet politike vendore, diplomatike, rajonale dhe ndërkombëtare etj. Pastaj përshkruhet terreni, vegjetacioni, vështirësitë dhe lehtësirat gjatë zhvillimit të një operacioni e deri te kushtet atmosferike, më së paku për 24 orët e ardhshme.

Për të shkruar këtë opinion u intrigova nga emisioni “Jeta në Kosovë” i datës 28.07. 2011 nga pyetjet shpesh të ngutshme dhe të palogjikshme të udhëheqëses së emisionit dhe nga përgjigjet e disa mysafirëve që gjendeshin në studio që për fat të keq, ose nuk kishin njohuri ose nuk donin të flisnin për çështjet e sigurisë në aspektin strategjik, operativ dhe taktik. Në këtë kontekst, Jeta Xhara i shtroi një pyetje këshilltarit të kryeministrit se a kishte pasur qeveria një plan për operacionin në veri? Dhe a ishte ngritur dhoma e situatave?

Për njohuri të opinionit dhe gazetarëve duhet të them se Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka Sekretariatin dhe mbështetet nga një Qendër e Situatave (Si Qendër

[27] Field Manual FM 101-5 Headquarters Department of the Army Washington, DC, 31 May 1997

Operative Kombëtare) në rast të ndonjë incidenti serioz apo madhor. Kjo qendër aktivizohet në raste incidentesh apo krizash me karakter kombëtar. Sepse, sipas planit të Reagimit Kombëtar i hartuar dhe i aprovuar nga Qeveria e Kosovës, në të gjitha incidentet pa marrë parasysh llojin vendin dhe kompleksitetin deri në shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme pre te menaxhuar këto incidente apo kriza i koordinatore është Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht (ministri i punëve të brendshme), i cili sipas këtij plani është i caktuar edhe si koordinator. Sidoqoftë pa dashur të mbaj një ligjëratë për planet operative ose për paragrafët e planit operativ dua të vazhdoj dhe të them disa karakteristika rreth operacionit të njësisë speciale në veri të Kosovës. Sipas këshilltarit të kryeministrit, tre ishin qëllimet kryesore të këtij operacioni:

• Zbatimi i Kushtetutshmërisë, shtrirja dhe mbrojtja e sovranitetit në veri të vendit;
• Funksionalimi i doganave dhe
• Implementimi i masave të reciprocitetit me Serbinë edhe në pikat 1 dhe 31.

Gjithashtu, pa dashur të flasim se a kishte ky operacion mangësi dhe a ishte përgatitur mirë, fillimisht duhet të pajtohemi se të gjitha këto qëllime ishin dhe janë të ligjshme dhe plotësisht të arsyeshme e të pritura gjatë. Por të kthehemi edhe një herë tek operacioni, sepse janë disa çështje që pa të drejtë i adresohen kryeministrit të vendit:

E para: Operacionet e tilla janë tepër sekrete dhe edhe pse përgatiten nga grupi planifikues, koha e implementimit ose e zbatimit është e panjohur edhe për vet ata (planifikuesit).

E dyta: E dëgjova me vëmendje pyetjen e Jetës që ia shtroi ekspertit të grupit të krizave, një pyetje lidhur rreth shkarkimin të drejtorit të policisë dhe se a duhej të njoftohej EULEX-i për këtë operacion. Përgjigjja duhet të kërkohet brenda rregullave dhe mënyrave të menaxhimit të krizave, sepse në raste të tilla tërë operacioni mund të dështojë nga një informacion i adresuar gabimisht. Mu duk e pavend dhe jashtë logjikës së menaxhimit të krizave përgjigja e ekspertit se

kryeministri është dashur ta njoftojë EULEX-in dhe edhe më e pa logjikshme ishte mbrojtja në një farë mënyre e drejtorit të policisë i cili gjoja paska kërkuar ose sugjeruar apo rekomanduar që të njoftohej EULEX-i. Në këtë Operacion kryeministri ishte vendimmarrësi kryesor dhe është qesharake që niveli vartës, siç ishte drejtori i Policisë së Kosovës (nëse kjo është e vërtetë), të hezitonte apo të binte ndesh me urdhrat e vendimmarrësit. Dhe në këtë rast ose për operacione të tilla vetëm shkarkimi nga pozita është një dënim i vogël dhe simbolik.

Kërkesat e disa ekspertëve, opozitës dhe një pjese të opinionit për radikalizëm edhe të mëtutjeshëm të situatës janë të papërgjegjshme dhe të papeshuara në aspektin e sigurisë, sepse Kosova nuk është në luftë me qytetarët e saj dhe në territorin e vet, qëllimi kryesor është arritur falë vendosmërisë së kryeministrit dhe njësisë speciale të Policisë së Kosovës.

Kryeministri i Kosovës me këtë operacion plotësisht të suksesshëm (duke e pas parasysh gjendjen reale ne teren), e theu 'Status Quo-n' dhe shkriu konfliktin e ngrirë për 12 vite radhazi që e kishte krijuar një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare në bashkëpunim të ngushtë dhe të heshtur me UNMIK-un dhe Serbinë. Sa u përket deklaratave të ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare kundër këtij operacioni mund të themi se këto qarqe e kishin krijuar bindjen se shqiptarët në përgjithësi dhe vendimmarrësit në veçanti për dymbëdhjetë vite rresht nga politika, diplomacia dhe vendimmarrja e kishin mësuar vetëm fjalën 'yes', kurse pas këtij operacioni për fatin e tyre të keq, ndoshta mund të bëjnë pushime verore shqetësuese në plazhet më të njohura botërore, por me gjasë pushimet do t'u kalojnë duke i rishkruar dhe përmirësuar skenarët për Kosovën që i kishin sjellë në CD-të e tyre këtu e dymbëdhjetë vite më parë.

Është shumë vështirë që të hartohet dhe implementohet një plan i tillë operativ, i cili ngërthen në vete premisa të interesave strategjike, politike, ekonomike dhe diplomatike. Me këtë operacion kryeministri i Kosovës sfidoi rreziqet e brendshme që kërcënonin sigurinë e brishtë të shtetit të Kosovës, sfidoi dhe

rrezikoi sigurinë mes dy shteteve (Kosovë –Serbi), sfidoi tërë rajonin e Ballkanit, njëkohësisht sfidoi sferat e interesave gjeostrategjike ndërkombëtare duke dëshmuar se është një burrë shteti me aftësi dhe shkathtësi të shkëlqyeshme vendimmarrëse. Në historinë e menaxhimit të krizave, të rralla janë rastet kur përmes prodhimit të një krize të zgjidhësh një krizë, siç është rasti i konfliktit të ngrirë në veriun e Kosovës dhe mu në zemrën e "Evropës Demokratike"

Telegrafi.com, 1:07 / 31.07. 2011

Çka pas operacionit "veriu"

Ata që pretendojnë të merren me çështjet studimeve të sigurisë, gjithmonë duhet ta kenë parasysh trinomin: Marrëdhëniet ndërkombëtare, shkencat politike dhe studimet e sigurisë.

U bënë më shumë se një muaj pas ndodhjes së Operacionit "Veriu" dhe tani me të drejtë dhe pak me vonesë shtrohet pyetja çka më tutje? Fillimisht të shtrojmë disa vështrime të studimeve të sigurisë klasike dhe moderne. E para e së parës qëndron në atë se kryeministri dhe njësiti special ROSU i dhanë një shpullë të nxehtë dhe tronditëse bilës edhe pak fyese një pjese të Evropës (edhe atyre që na kishin njohur dhe s'po luanin as gishtin e vogël për të na përkrahur së paku moralisht për të shtrirë sovranitetin në tërë vendin), UNMIK-istanit, Euleks-istanit, Serb-istanit dhe disa "stanarëve" tjerë që jetojnë den babaden në Kosovë, e që për fatin e keq të tyre disa nga keta edhe flasin shqip dhe hanë bukën shqiptare ose siç thotë populli janë vetëm taksirati i miellit.

Cili dhe çfarë është problemi i veriut?

Dëgjuam këtë muaj tropikal lloj-lloj deklaratash të çuditshme, pa vend e pa kripë, të qëllimshme e të paqëllimshme e herë-herë skajshmërisht naive, me një fjalë gjithçka, por asgjë konkrete dhe me vlerë. Së pari problemi i veriut nuk është vetëm problem i sigurisë siç po deklarojnë analistët, këshilltarët, deputetët,

OJQ-të bile edhe disa ministra që i njohin mirë studimet e sigurisë. Për të sqaruar më mirë këtë, duhet që këshilltarët për siguri të cilit do udhëheqës shtetëror qofshin, të bëjnë dallimin midis dy koncepteve të sigurisë: Sigurisë klasike cila kishte përfunduar me përfundimin e luftës së ftoftë dhe e cila kishte të bënte me sistemet lindje dhe perëndim ose kapitalizëm–socializëm e që deri në këtë kohë studimet e sigurisë privilegjonin pozitën e shtetit, ku siguria përkufizohej si studimi i kërcënimit, përdorimit dhe kontrollit të fuqisë çoftë ushtarake apo ndonjë fuqie tjetër. "Koncepti tjetër lindi në vitin 1994 në Universitetin York të Torontos në një konferencë të vogël ku studiues të shumtë nga e gjithë bota filluan të aplikojnë emërtesën "Studimet kritike të Sigurisë"[28].Në këtë rast dua tua përkujtojë deklaratën e mëhershme qesharake dhe kontradiktore të soziut të Sllobodan Millosheviqit, z. Ivica Daçiq se veriu i Kosovës është vetëm një rrezik lokal! Pikërisht këto rreziqe lokale të "Sllobodan Millosheviqit" miniatural e shpërbënë Ish Jugosllavinë e tij të "dashur", siç ishin luftërat në Bosnje, Kroaci, Slloveni dhe në Kosovë apo në sigurinë ndërkombëtare sikurse rasti i Ruandës. Por me studimet kritike të sigurisë ose me studimet moderne të kësaj fushe, humbet roli i shtetit si garantues i sigurisë së qytetarëve të vet ose përkundrazi ndodh që shteti shpesh mund të rrezikojë qytetarët e vet. Dhe pikërisht këtu është e ndjeshme "bota demokratike perëndimore" sepse matë me kutet e saja e që nuk vlejnë edhe për Kosovën në këtë shkallë zhvillimi, njohjeje dhe demokracie. Shteti shpesh mund të rrezikojë qytetarët e vet siç kishte ndodhur me shtetin Serb ndaj qytetarëve të Kosovës dhe jo vetëm ndaj tyre. Këshilltarët për siguri të Kryeministrit, Presidentit, Krye parlamentarit dhe Ministrave duhet të këshillojnë udhëheqësit vendorë se nuk sigurohet siguria vetëm nga institucionet me mandat sigurie. Siguria tani ka të bëjë me qeniet njerëzore, individin, komunitetet (qofshin ato edhe homoseksuale), grupet etnike, idetë, normat dhe rregullat demokratike që duhet të sigurohen pikërisht nga shteti sepse këto nëse nuk i siguron shteti e drejta e sigurimit të tyre kalon tek Komisionet e Ndryshme Ndërkombëtare. Sidoqoftë

[28] Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Alan Collins, përkthyer nga Enri Hide, faqe84

duhet të jemi të vetëdijshëm se sigurinë më nuk e prodhon vetëm ushtria dhe policia.

Një çështje është me rëndësi të studiohet nga ekspertët e studimeve të sigurisë. A është çështja e veriut si çështje e sigurisë e përcaktuar më shumë në aspektin subjektiv, dhe si çështje që "elita jonë, liderët politik, dhe bashkësia ndërkombëtare na kanë bindur se ne po përballemi me një kërcënim dhe se ky kërcënim ka nevojë për një masë emergjente apo jo? "Kjo teori e bindjes subjektive i përket Institutit të Kërkimeve të Paqes në Kopenhagë e njohur ndryshe si Shkolla e Kopenhagës"[29] dhe mund të ketë pak të vërtetë nga kjo teori në rastin e veriut.

Me çka po përballemi realisht në veri?

Këtu kemi dy modele të çështjeve të studimeve të sigurisë: Modelin klasik ku referenca kryesore është shteti sepse qeveria e Republikës së Kosovës plotësisht me të drejtë po kërkon dhe tenton që ta shtrijë sovranitetin e vet me qëllimin më të mirë për të siguruar qytetarët e vet dhe njëkohësisht kemi të bëjmë me modelin modern ose kritik të studimeve të sigurisë e që ka të bëjë me mbrojtjen e grupeve etnike, komuniteteve, individëve, ideve, vlerave morale, religjioze, vlerave demokratike, dhe të drejtën legjitime për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur e cila e drejtë u mungon qytetarëve më shumë se një dekadë në veri. Për më tepër, këto vlera shteti ynë i mbron nga kriminelët e dëshmuar, paramilitarët, kontrabandistët, trafikantët rajonal dhe ndërkombëtar si, dhe strukturat paralele të një shteti deri dje armik dhe pushtues i yni.

Serbët e kanë humbur torruan

Tani, pasi që doli haptas se mbështetja këtyre strukturave po u vije nga shteti serb, këta duke parë se qeveria e Kosovës është e vendosur për shtrirjen e sovranitetit në tërë territorin e vet të pranuar ndërkombëtarisht, kanë devijuar ose aktrojnë se kanë humbur misionin e tyre që ishte boshnjakëzimi i Kosovës,

[29] Studime Bashkëkohore të Sigurisë, Alan Collins, përkthyer nga Enri Hide, faqe 84

gjegjësisht ndarja e veriut. Kështu, të trembur nga integrimi i suksesshëm i Serbëve në pjesën tjetër të Kosovës sidomos nga vendosmëria dhe mbështetja së paku Amerikane dhe Gjermane për veprimet e Qeverisë me 25 gusht, serbët me gjasë nuk kanë më koncept të qartë veprimi.

Cilat janë detyrat e Planifikuesve tanë?

Së pari: Të hartohet një Plan Gjithëpërfshirës i Veprimit nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës (Ministritë), për të zbarkuar në terren dhe për të filluar së kryeri detyrat dhe përgjegjësitë sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës si psh, dogana, gjykata, targa, dokumente personale, telekomunikacion, tatime, taksa, si dhe të gjitha këto institucione të Republikës së Kosovës të përkujdesen që qytetarët e veriut pa dallim etnie të kenë qasje të barabartë në të gjitha shërbimet shtetërore sidomos në ato që i quajmë infrastrukturë vitale si uji, ushqimi dhe energjia sepse shpesh herë këto çështje mund të kërcënojnë sigurinë. Përveç kësaj ky plan gjithëpërfshirës veprimi duhet të ngërthejë në vete çështjet që në studimet e sigurisë quhen siguria shoqërore, siguria ekonomike, siguri mjedisore etj..

Së dyti: Në kohën kur qarqet anti shtet të Republikës së Kosovës morën shpullën e nxehtë nga Kryeministri dhe njësia speciale ROSU, menjëherë pas nokdaunit që pësuan vendosën t'i hakmerren kryeministrit duke caktuar kryeprokurorin për akuzat e Dick Martit, kundër Kryeministrit të Kosovës, për ta shantazhuar atë dhe për ta frenuar vrullin e tij në mënyrë që të marrin frymë sadopak, për të qartësuar dhe konsoliduar misionet e tyre të ardhshme anti-Kosovë. Në këtë drejtim është me rëndësi jetike që Kryeministri të vazhdojë punën e tij sepse si zakonisht grupet punuese dhe task-forcat e ndryshme janë të predestinuara të dështojnë.

Së treti: Krahas hartimit dhe implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Veprimit, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të vazhdojë bisedimet me Serbinë për

çfarëdo teme që ata (serbët) dëshirojnë dhe shohin ëndërr, qoftë ajo politike, teknike, politeknike, astronomike apo diç tjetër.

Telegrafi.com, 0:27 / 1.09.2011.

Autonomia politike shtetërore dhe diplomacia imponuese

Nga katër elementet e sigurisë shtetërore, si ajo fizike, autonomia politike, zhvillimi dhe rendi, autonomia është elementi më kryesor e që njëkohësisht determinon edhe tre faktorët tjerë të sigurisë. Autonomia politike si element kyç i sigurisë shtetërore shpeshherë duke dashur të ruhet me çdo kusht si motiv i krenarisë apo i pamundësisë dhe pafuqisë reale, sjell po ashtu shumë dëme dhe mund të rrezikoj shtetin nga Diplomacia Imponuese. “Autonomia politike kuptohet si liri nga detyrimi për t’iu bindur urdhrave dhe kontrollit të të tjerëve”. Gjatë historisë Diplomacia Imponuese është përdorur shpesh, por në shtetin e ish Jugosllavisë është implementuar në vitin ‘99 kundër regjimit të Sllobodan Millosheviqit. Pas Konferencës së Rambujesë, komuniteti ndërkombëtar me në krye NATO-n, u detyrua që përmes forcës të bind Millosheviqin për t’i dhënë fund shtypjes së Shqiptarëve në Kosovë.

Diplomacinë imponuese më së miri e njohin shtetet që janë çliruar nga kolonizatorët e tyre. Për këtë arsye shpesh këto shtete, të dala nga regjimet koloniale, mundohen me çdo kusht ta ruajnë autonominë e tyre politike qoftë edhe në këmbim të zhvillimit të ngadalshëm ekonomik, ose disa nga këto shtete shpesh janë të gatshme edhe të përballen me sanksione të ndryshme vetëm e vetëm për të ruajtur autonominë e tyre politike.

Si mund të humbet Autonomia politike?

Autonomia mund të humbet në disa mënyra, si pasojë e dëshirës për tu bërë mik me të fortin, ose e paqartësisë politike të një grupi politik apo individit siç ishte rasti me deklaratën e mëhershme të nënkryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Blerim Shala, i cili me gjasë kishte harruar se Kosova

është nën mbikëqyrje ndërkombëtare dhe po kërkonte edhe një mbikëqyrje ose protektorat extra për veriun dhe ndoshta në të ardhmen, për secilën pjesë të rebeluar të kësaj Kosove të "madhe" do të kërkojmë dhe vendosim nga një protektorat të vogël për ta na ruajtur apo për të na qetësuar për çdo ditë të zotit, sa herë që trembemi apo ndihemi të pa sigurt?

Sidoqoftë autonomia politike mund të humbet edhe si shkak i brishtësisë politike, zhvillimit të dobët ekonomik dhe ushtarak ose thjesht si shkak i mosbindjes duke i detyruar më të dobëtit që me forcë të ndryshojnë sjelljen e tyre. "Diplomacia imponuese është kërcënimi dhe/ose nëse është e nevojshme përdorimi i kufizuar i forcës, i ndërmarr për të bërë një kundërshtar që t'u bindet dëshirave të imponuesit. Administrata e Presidentit Bush (i vjetri) kishte folur rreth përdorimit "parandalues" të forcës e që më vonë këtë strategji e kishte implementuar edhe Presidenti Bill Klinton me rastin e sulmit kundër Serbisë në vitin '99, dhe pastaj po këtë diplomaci e vuri shpesh në përdorim edhe Presidenti Bush i Riu.

Republika e Kosovës dhe Autonomia Politike

Kosova si një shtet i ri ende është nën administrimin ndërkombëtar dhe këtë fakt nuk duhet ta anashkalojë as qytetari më i thjeshtë i Kosovës. Prandaj ruajtja e autonomisë politike ose ruajtja e mëvetësisë dhe politik bërjes autonome, është thuajse e pamundur. Është fat i mirë që krijimi i shtetit të Kosovës ishte dhe ende është interes strategjik i atyre që implementojnë Diplomaci Imponuese, përndryshe vendim marrësit tanë nuk mund të ëndërrojnë as për një autonomi politike fiktive e jo siç deklarojnë disa se janë autonom në vendimet e tyre ose siç trumbetojnë disa tjerë se mund të merrnin vendime të "mëdha", sikur ata të ishin aktorë të vendimmarrjes në Kosovë. Sidoqoftë vendimmarrësit Kosovarë mund të gjejnë mënyra të ndryshme për të ruajtur pak autonomi politike me çdo kusht, sepse pa këtë autonomi edhe ky pak shtet që e kemi do të pushonte së ekzistuari. Po e marrim si shembull procesin e famshëm të liberalizimit të vizave që për qytetarët e Kosovës nuk është një çështje jetike ekzistenciale, por në

qoftë se për hir të liberalizimit bëhen lëshime në rregullimin e brendshëm të Kosovë, duke heq dorë vullnetarisht nga ndonjë pjesë e territorit të Republikës së Kosovës, në fakt ne pastaj nuk do të kemi as autonomi politike dhe as shtet sepse këto dyja janë ngushtësisht të lidhura njëra me tjetrën.

Republika e Serbisë

Serbia si pjesë e ish Jugosllavisë e kishte përjetuar më së rëndi peshën dhe goditjen e Diplomacisë Imponuese nga sulmet e NATO-s kundër saj me 25 mars 1999. Serbët që nga ajo kohë e deri më sot nga kjo diplomaci kishin arritur dhe po arrijnë të nxjerrin disa avantazhe. Serbia edhe pse është fajtore për të gjitha luftërat, gjenocidin dhe tmerret në territorin e ish Jugosllavisë ajo me sukses është në avantazh ndaj faktorit ndërkombëtar, ndaj Kosovës dhe ndaj opinionit të vet të brendshëm.

Pse është në avantazh dhe si po e mashtron faktorin vendor, ndërkombëtar dhe Kosovën, Serbia?

Realisht dhe historikisht Kosova nuk ka qenë kurrë pjesë e Serbisë, ata (serbët), shfrytëzojnë viktimizimin e tyre (pa dhënë llogari për dëmet e luftës në ish Jugosllavi), nga Diplomacia Imponuese për të përfituar sa më shumë nga Evropa, dhe mashtrimi i fundit është për tu arsyetuar para opinionit vendor për gjoja armiqësinë e përhershme të tërë botës kundër një shteti të arsyeshëm dhe të drejtë dhe përfundimisht, shikuar nga aspekti i së ardhmes historike, ata (serbet), po ngrehin në mënyrë të vazhdueshme alibinë për padrejtësinë ndërkombëtare kundër tyre, që në të ardhmen, të rikthejnë si çështje të pazgjidhura në tryezat e bisedimeve, të tëra këto gjoja padrejtësi që po u bëhen dhe herë do kur, të rikthejnë atë territor që gjoja u është marrë me forcë dhe padrejtësi, Kosovën.

A mund të përdoret Diplomacia Imponuese në rastin e veriut?

Natyrisht që Diplomacia imponuese është përdorur dhe përdorët gjatë krizave të mëdha ndërkombëtare por sigurisht që po të ekzistojë vullnet i mirë, me lehtësi mund të përdorët edhe në rastin kur tendencat për konflikte të mëdha hiperbolizohen, siç është çështja e veriut të Kosovës. KFOR-i si forcë ushtarake paqeruajtëse ka dhënë shenjat e para se një diplomaci e tillë mund të përdorët me sukses ditën kur u konfrontua me strukturat paralele dhe paramilitare serbe në veri. Në qoftë se vendimmarrësit në Bruksel dhe Uashington dëshirojnë të implementojnë Diplomacinë Imponuese ndaj Republikës së Serbisë, këtë mund ta bëjnë në dy drejtime: me kushtëzimin për hyrje të Serbisë në BE, (në aspektin diplomatik dhe politik), dhe e dyta ata munden dhe duhet të përdorin kërcënimin, frikën dhe ndoshta fare në fund edhe një forcë të kontrolluar kundër strukturave paralele dhe paramilitare në veri, për të bindur dhe disiplinuar këto grupe kriminale me qëllim që qeveria e Republikës së Kosovës të jetë e aftë dhe e gatshme për të administruar territorin e saj, për të garantuar pushtetin, legjitimitetin, për të përfituar bindjen si dhe për të shuar apo shtypur mos bindjen.

Në ditët në vijim mbetet të shohim se si do të veprojë KFOR-i, si do të reagojnë strukturat paralele, paramilitare, kriminale serbe dhe si do pozicionohet më në fund Serbia.

Telegrafi. com, 9:18 / 17.10.2011

Ruleti rus përsëri në ballkan

Ruleti rus thuhet se u krijua në shekullin e 19. Sipas legjendës, të burgosurit detyroheshin me dhunë të luajnë ruleti rus duke e vendosur grykën e revolverit në tëmth dhe duke e tërhequr këmbëzën, Në mullirin e revolverit kishte vetëm një fishek. Kujdestarët e burgut vënin bast për rezultatin e lojës duke i ofruar vodkë me bujari atij fatlumi i cili pas gjashtë herësh radhazi të ngrehjes së këmbëzës, do të mbeste gjallë, gjë që kishte ndodhur vetëm disa herë gjatë shumë viteve. Në këtë kohë në ushtrinë perandorake ruse, revolveri standard ishte “Nagant M” e cili kishte një mulli me shtatë fishekë.

Gjatë krizës së ashtuquajtur lindore e cila kishte filluar në vitin 1853 dhe përsëritjes së saj në vitin 1878, atëherë kur Rusia e dobësuar ishte në shënjestër të fuqive të mëdha Evropiane që synonin për ta larguar atë nga Lindja e Afërt, pikërisht në këtë kohë Rusia drejtoi kursin e saj ekspanzionist kundër Perandorisë Osmane, po ashtu të dobësuar, me qëllim që të krijonte shtetet sllave dhe ortodokse në Ballkan, dhe njëkohësisht për të forcuar pozitat e saj të dobësuara karshi Anglisë, Francës dhe Gjermanisë si një forcë e re që sapo po delte në skenën ndërkombëtare. Rusia në dy krizat e Lindore tentoi, por sidomos gjatë krizës së dytë (1878) arriti të krijonte shtetet sllavo ortodokse kështu që nga Traktati i Shën Stefanit pavarësinë e fituan: Bullgaria, Rumania, Serbia dhe Mali i Zi. Rusia në atë kohë duke nxitur, urdhëruar dhe detyruar Bullgarinë që ti bashkohej, i dha asaj territore të huaja të cilat ajo nuk mundi t'i mbajë dhe t'i gëzojë kurrë, përveç se u armiqësua me popujt fqinjë për rreth. Në këtë rast Rusia kishte favorizuar shtetet e vogla Ballkanike të sapo krijuara siç ishin Serbia dhe Mali i Zi duke copëtuar territoret shqiptare. Dobësimi i perandorisë Osmane, Interesat e Francës e cila gjithmonë kishte dhe ka luajtur rolin e lakeut rus, indiferenca Angleze, dhe makutëria Austro-Hungareze për territoret e Bosnjës dhe tokat shqiptare, përgjakën dhe përgjysmuan etnikumin shqiptar anekënd Ballkanit.

Farsa Ruse e përsëritjes së krizës lindore

Tani në shek XXI Rusët për fat të mirë nuk kanë më kujt t'i vërsulën siç ishte një herë e një kohë perandoria Osmane, gjegjësisht tokat shqiptare.Tani Rusia simulon një lojë virtuale gjeostrategjike me përmasa minore të tipit si kriza lindore e shekujve XIX – XX.

Kur NATO hyri në Kosovë në qershor të vitit 1999, Rusia e trandur se do të humbiste përgjithmonë interesat dhe pozitën gjeostrategjike në Ballkan, nisi një kontingjent ushtarësh të cilët patën hyrë në Prishtinë para forcave të NATO-s, duke provokuar kështu një luftë të re përmasash botërore.Në të njëjtën kohë ajo dislokoi trupat e saj në Kosovën qendrore, në Malishevë, për t'i tërhequr më vonë

këto trupa në mënyrë të turpshme për mungesë fondesh. Gjatë gjithë viteve më pastaj diskursi politik, diplomatik dhe ushtarak i Rusisë ishte vazhdimisht kundër shtetit të ri - Republikës së Kosovës. Që nga viti 1999 paramilitarët rusë dhe serbë kanë mbajtur dhe po mbajnë peng cepin verior të trungut shqiptar, atë cep ku shqiptarët Jo shumë kohë më parë kishin vrarë si të padëshirueshëm kangjallozin (kancelarin) rus.

Përsëritja e lojës së ruletit Rus në Ballkan

Ditëve të fundit Rusia po riluan ruletin e vet me idetë e mykura dhe të tejkaluara për gjoja një krizë të re (Lindore), herë me ide për atdhesimin e 20.000 – 40.000 serbëve të Kosovës në Rusi – Siberi, herë me krijimin e një batalioni sllav që do të përbëhej nga serbët, bullgarët dhe rusët po ashtu edhe me shpalljen e pavarësisë së tri komunave serbe në veriun e Kosovës për të frikësuar kështu popujt e Ballkanit ose për të dobësuar qëndrimet e disa vendeve Evropiane dhe pozitën e qeverisë së Kosovës për mos ndryshimin e kufijve në Ballkan.Në këtë mënyrë Rusia dëshiron që me çdo kusht të ruajë interesat gjeopolitike dhe gjeostrategjike në Ballkan qoftë edhe në mënyrë simbolike.

Ç'ka fshihet pas këtyre ideve dhe cili është karremi serbo-sllavo-rus për veriun e Kosovës dhe Kosovën lindore?

Jemi dëshmitarë se këto ditë u lansuan, po vazhdojnë të lansohen si dhe po dalin sheshit idetë, dëshirat dhe propozimet e papjekura politikisht dhe po aq të rrezikshme në aspektin gjjeostrategjik për ndërrimin e territoreve me Republikën e Serbisë. Pse po bëhemi kaq naiv? Cilat janë ato territore që ne ja kemi marr Serbisë, kur dhe pse tani qenka momenti për t'ia kthyer? Pse po i kthehemi një transaksioni të rrezikshëm që në mesin e viteve 50-ta e kishte bërë me qëllim të caktuar Aleksander Rankoviçi?

Ja disa nga faktet gjeostrategjike se pse serbët dhe rusët nuk janë të interesuar për ndërrim territoresh?

1. Qeveria e Serbisë që nga viti 1911 ka një plan të detajuar për hapjen e një kanali ujor për të pas dalje në det përmes portit të Selanikut (lumi Morava), nëpër territorin e tri komunave shqiptare të Kosovës lindore, Maqedoni dhe deri në Greqi.
2. Rusia përmes rrugës tokësore (transversale), kishte dhe ende ka qasje deri në Greqi, rrugë tokësore e cila përshkon të gjitha shtete sllave dhe ortodokse. Rrugë e cila bie nëpër Kosovën Lindore. Këto ishin dhe janë ende dy momentet gjeostrategjike që Serbia dhe Rusia i kishin realizuar në vitin 1956 përmes A. Rankoviçit me ndërrimin e territoreve shqiptare (për naivët në çështjet e Sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare) gjoja mes Kosovës dhe Serbisë. Qëllimet e Serbisë dhe Rusisë për këto ndërrime ishin se: Serbia do të ruante rrugën tokësore Rusi–Greqi, si dhe për shkak të ndërtimit të kanalit të vet ujor do te siguronte daljen ne det (portin e Selanikut), njëkohësisht do ta ruante dhe mbronte Kosovën lindore, tani më pjesë integrale e Serbisë sipas parimit territorial dhe atë të Sovranitetit (Kosova nuk ishte në atë kohë as krahinë autonome).
3. Pastaj, Serbia do të mbronte enklavën serbe në veri të Kosovës sipas parimit etnik dhe duke e keq përdor këtë enklavë si pykë çarëse në mes shqiptarëve gjysmë të asimiluar të Peshterit dhe Sanxhakut dhe shqiptarëve të Kosovës, njëkohësisht duke siguruar rrugën e vet tokësore të quajtur më vonë si magjistralja e Ibrit për dalje në Adriatik përmes Malit të Zi. Edhe pse në njëzet vitet e fundit ndodhën ngjarje dramatike, tragjike dhe luftëra të cilat rezultuan me shpërbërjen e ish Jugosllavisë, ku lindën dhe u krijuan shtetet të reja, mund të krijohet përshtypja e zbehjes dhe e pamundësisë së realizimit të këtyre skenarëve serbë dhe rusë, prapëseprapë Serbia dhe Rusia do të përpiqen vazhdimisht të luajnë këtë lojë dhe vetëm në një rast të vetëm Serbia mund të tërhiqet nga këto plane atehere kur dhe: Nëse integriteti dhe sovraniteti i Serbisë rrezikohet nga radikalët myslimanë të Sanxhakut dhe autonomistët Hungarezë të Vojvodinës, vetëm atëherë Serbia e frikësuar mund të përshpejtojë hapat drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s për tu futur

nën ombrellën e mbrojtëse të saj me qëllim që të mbrojë jo vetëm integritetin dhe sovranitetin, por edhe vet qenien e saj kombëtare.

Tani, pse janë të rrezikshme dhe të pamatshme idetë për ndërrimin e territoreve?

Së pari askush nuk e din se cilat janë kërkesat dhe ofertat serbe për këtë çështje, tek e fundit kur e kërkoi Serbia zyrtarisht pikërisht një gjë të tillë, përveç një rasti kur presidenti serb Tadiç i bëri një kërkesë Shqipërisë (jo Kosovës), dhe jo për ndërrim territoresh, por për një rirregullim të kufijve në Ballkan, kërkesë kjo shumë e paqartë, konfuze dhe shumë konfliktuoze për të gjithë popujt e Ballkanit. Sidoqoftë kjo kërkesë ju drejtua Shqipërisë e jo Republikës së Kosovës, kësaj Republike që deri sot e kanë njohur më shumë se 80 shtete të Evropës dhe botës e të cilët këmbëngulin që s'do të ketë pazare rreth kufijve të Kosovës. Mendimet, idetë, planet dhe strategjitë mund të jenë joshëse por çështja është se sa dhe me çfarë çmimi janë të realizueshme këto ide? Me gjithë këto vështirësi që tani po ballafaqohet shteti ynë i ri, sa na duhen tani sprovat dhe sfidat e tilla jashtë mundësive tona dhe a nuk na mjafton shtrirja e shtetësisë në terë Kosovën si dhe stabilizimi dhe demokratizimi i mëtejmë i këtij shteti të ri dhe me prosperitet? Duke i pas parasysh të gjitha këto zhvillime të shtruara këtu dhe idetë e përsëritura serbe dhe ruse për një rikthim në Ballkan me çdo kusht, atëherë vetvetiu lind pyetja: Kush do të pësojë përsëri nga kjo ruletë ruse në Ballkan?

- Bullgarët, Jo. Ata ishin mashtruar një herë gjatë krizës lindore nga rusët
- Serbët, Jo. Sepse këta nuk i besojnë askujt dhe se e kishin tradhtuar edhe vetë Rusinë gjatë krizës lindore dhe gjatë periudhës së socializmit edhe pse Rusia kishte krijuar shtetin Serb.
- Shqiptarët, Jo dhe assesi nuk duhet të tërheqin këmbëzën e nagantit të ruletës ruse, sepse çdo shqiptar duhet ta kujtojë historinë e joshjes së Prenk Bib Dodës nga Rusët dhe Serbët (gjatë krizës lindore) që në këmbim të Republikës së Mirditës, ai të sulmonte garnizonet turke kur t'i jepnin urdhër

rusët dhe serbët. Ai kishte dëgjuar urdhrat dhe këshillat e tyre, por pësoi një përfundim të turpshëm dhe tragjik. Në qoftë se sot ne marrim parasysh këto fakte historike të cilat na kanë ndodhur jo më larg se dje, atëherë së pari duhet të punojmë që ta zbrazim mullirin e nagantit të ruletës ruse, që ai mos të kërcasë fare, tek e fundit ndoshta ky edhe mund të jetë një mulli tërësisht i zbrazët ose vetëm një blof për të favorizuar dhe forcuar pozitat serbe në bisedimet e ardhshme me shqiptarët. Sidoqoftë Republika e Kosovës si kundërmasë ndaj këtyre kurtheve shekullore duhet të nxjerr prioritetet e saja për të quar përpara projektin e vet të shtet ndërtimit dhe bashkimit. Po cilat janë këto prioritete:

- Shtrirja e Sovranitetit në tërë territorin e pranuar ndërkombëtarisht;
- Bashkimi me Shqipërinë qoftë edhe në formë konfederate;
- Një shtet i vetëm ose në konfederatë me Shqipërinë në Bashkimin Evropian

dhe në NATO. Kjo do të ishte rruga e vetme që pastaj pjesët e kombit të mbetura jashtë trupit të atdheut do të mund të integroheshin natyrshëm në trungun amë.

Telegrafi. Com 0:12 / 29.11.2011.

Sa jemi të (pa) përgatitur për të menaxhuar fatkeqësitë

Kur e njeriu i zakonshëm që shikon punët e veta dhe mundohet të jetojë ndershëm sheh se si humb jetën një fëmijë pranë oborrit të vet, në një lum që kalon me shekuj nëpër fshat, nuk e lejon ndërgjegjja e të mos pyes se pse kaq lirë kushton një jetë njeriu? A ka fajtor në këtë fatkeqësi? A duhet dikush të ketë përgjegjësi dhe pse? Në filmimet televizive pamë një urë e cila nuk kishte mbrojtëse anësore, pastaj pamë një lumë qe në raste përmbytjesh sezonale mund të bëhet i rrezikshëm së paku për fëmijët e fshatit, dhe çka?

Niveli Lokal

Me Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera si dhe me ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, për Mbrojtjen dhe shpëtimin e jetës së qytetarëve përgjegjëse është Komuna – qeverisja lokale. Pra, Kuvendi Komunal me drejtoritë apo sektorët për Mbrojtje dhe Shpëtim, janë të obliguara që të hartojnë vlerësimin e rreziqeve dhe planet për mbrojtje dhe shpëtim, ku bëjnë pjesë edhe planet preventive. Nga filmimet televizive ku kishte humbur jetën një fëmijë pesëvjeçar nuk pamë asnjë përpjekje preventive, bile as nga qytetarët e atij vendbanimi për të mbrojtur jetën e tyre dhe të mirat materiale. Pasi që Komuna është e obliguar që të hartojë vlerësimin e rreziqeve, planet Preventive, planet e gatishmerise (Planet Operative Emergjente) si dhe programet e vleresimit te gatishmerise, është e natyrshme që kjo, duke u bazuar në shkallën e vlerësimit te rrezikshmërisë, të ngritë edhe ekipet reaguese, në bazë rreziqeve që e kërcënojnë territorin dhe banorët e saj. Është e dhimbshme dhe e patolerueshme që komunat që rrezikohen nga vërshimet ose nga ndonjë fatkeqësi tjetër siç ishte bora e mëhershme, të kërkojnë ndihmë menjëherë nga FSK-ja. Ku i kanë ata reaguesit e tyre? A e dinë Komunat se FSK-ja me Planin e Reagimit Kombëtar të aprovuar nga Qeveria është Reagues i dytë ose forcë ushtarake në ndihme strukturave civile? Dikush mund të thotë se ndihma është e domosdoshme dhe nuk kemi kohë të merremi me fjalë, por duhet reaguar menjëherë kur është në pyetje jeta e njeriut. Është shumë e vërtetë kjo, por është edhe shumë e vërtetë që sipas ligjit dhe dokumenteve bazike të miratuara nga qeveria, si: Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave dhe Plani i Reagimit Kombëtar, janë të ndara detyrat dhe përgjegjësitë qe nga niveli lokal, regjional e deri te ai qendror. Nisur nga ligjet dhe këto dokumente, atëherë niveli lokal duhet të krijoj njësi reaguese sipas vlerësimit të rreziqeve për komunën e vet. Është e ditur se fatkeqësitë dhe katastrofat godasin nivelin lokal dhe thuhet se 90 për qind e viktimave gjatë një katastrofe janë viktima civile. Niveleve Lokale të Menaxhimit Emergjent ose të Mbrojtjes Civile siç është quajtur më herët, u mungojnë njësitë reaguese e në disa komuna edhe Drejtoritë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Por, është jo serioze dhe e dhimbshme kur qyteza të vogla në Kosovë, me një rrezikshmëri jo të lartë, kanë drejtori për Mbrojtje dhe

Shpëtim kurse Prishtina si kryeqendër ka vetëm një sektor në kuadër të Drejtorisë se Shërbimeve Publike. Dhe, jo vetëm Prishtina, por edhe disa qendra tjera urbane kosovare, ku shkalla e rrezikshmërisë nga rreziqet dhe kërcënimet e ndryshme është shumë e lartë. Përveç kësaj, edhe për njësitë aktuale reaguese në Komuna, mungon aftësimi,trajnimet, stërvitjet sektoriale, ushtrimet e të gjitha llojeve deri te ato fushore apo gjithë përfshirëse, programet e Gatishmërisë Emergjente (Agjencia e Menaxhimit Emergjent organizon trajnime të rregullta për të gjitha nivelet), sensibilizimi, mospërfshirja e Menaxhimit Emergjent - Mbrojtjes Civile në sistemin arsimor etj. Andaj, në këtë gjendje është shumë e vështirë të menaxhohen fatkeqësitë më të vogla, e lëre më Incidentet e karakterit kombëtar (si Restelica) apo katastrofat tjera te mundshme.

Niveli Regjional

Sa i përket nivelit Regjional, edhe pse Agjencia e Menaxhimit Emergjent tani, sipas organikës se re, Qendrat Regjionale për Alarmim dhe Koordinim i ka shndërruar në Qendra Operative Emergjente Regjionale, është fare e pamundshme që vendimmarrësit e disa komunave të mblidhen në Qendrat Operative Regjionale për të Menaxhuar dhe marrë vendime në raste fatkeqësish të përmasave regjionale, për shkak se Kosova nuk është e organizuar administrativisht në bashki.

Niveli Qendror

Ne vitin 2008, Kryeministri Kosovës ka nënshkruar një Udhëzim Administrativ shumë të rëndësishëm, atë mbi Metodologjinë e Hartimit të Vlerësimit te Rreziqeve dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim, ku pas një pune njëvjeçare ishte përfunduar vlerësimi i parë i rreziqeve në nivel vendi, i hartuar nga përfaqësuesit e Institucioneve të Republikës së Kosovës e që bartës ishte Departamenti i Menaxhimit Emergjent - tani Agjencia e Menaxhimit Emergjent. Pas kësaj, në vitet 2009-2010, u hartuan edhe dy dokumente bazike të domosdoshme për menaxhimin me sukses të të gjitha fatkeqësive - Sistemi i

Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (SIME) dhe Plani i Reagimit Kombëtar (PRK). Në hartimin e të gjitha këtyre dokumenteve kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, si dhe Kryqi i Kuq si OJQ. Në mes hartuesve kishte një marrëveshje sidomos në Planin e Reagimit Kombëtar që FSK-ja të angazhohej si reagues i dytë (model i ushtrive të vendeve demokratike), pra si forcë ushtarake në ndihmë strukturave civile, natyrisht pasi të shteren kapacitetet lokale dhe regjionale ose ne ndonjë rast specifik - në mungese të njësive të specializuar, kur ka nevojë për reagim të tillë. Kështu qëndron edhe në Planin e Reagimit Kombëtar, ku FSK-ja mbulon Funksionin Mbështetës Emergjent (FME#3) – Xhenion.

Çka ndodh në realitet?

Kuvendet komunale, duke mos qenë të përgatitura të menaxhojnë situata fatkeqësish, duke mos bërë Vlerësim të Rreziqeve dhe Plane Operative Emergjente, marrëveshje mirëkuptimi me komunat fqinje, duke mos i përfshirë resurset e sektorit privat në Planifikim, si dhe duke mos pas njohuri dhe përvojë në Vlerësimin e Situatës dhe Menaxhim Emergjent, menjëherë kërkojnë ndihmën e FSK-së ose shpallin gjendje të jashtëzakonshme! FSK-ja, e prirë nga misioni (ndërkombëtar) që ka për të reaguar në situata emergjente për të mbrojtur dhe shpëtuar qytetarët e Kosovës, herë me qëllimin më të mirë e herë për dukje formale (që është krejt normale për një ushtri), shkel Planin e Reagimit Kombëtar, planin që edhe vet ishte pjesëmarrëse në hartimin e tij! Me Planin e Reagimit Kombëtar, Koordinator i menaxhimit të incidenteve me karakter Kombëtar, deri ne shpalljen e gjendjes se jashtëzakonshme nga Presidenti, është: Ministria e Punëve te brendshme (Grupi Ndërministror i Menaxhimit të Incidenteve - GNMI), gjegjësisht Ministri i Punëve të Brendshme. Sa i përket dokumenteve bazike, Sistemit te Integruar te Menaxhimit te Emergjencave (SIME-së) dhe Planit te Reagimit Kombëtar (PRK-së), mund të pohohet se për të dyja këto dokumente Ministria e Punëve te Brendshme - Agjencia e Menaxhimit Emergjent - si bartëse e hartimit të tyre, ka organizuar në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri. trajnime njohëse javore, ku

kanë marrë pjesë të gjitha institucionet dhe reaguesit e të gjitha niveleve, si: Ministritë, Agjencitë, Kuvendet Komunale, Policia e Kosovës, Zjarrfikësit e Kosovës, Shërbimet Emergjente Mjekësore, Kryqi i Kuq etj... në mënyrë që këta të njihen sa më mirë me (dhe t'i implementojnë menjëherë dhe në çdo fatkeqësi ku involvohen dy apo me shumë institucione), Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave dhe Planin e Reagimit Kombëtar.Për t'u jetësuar në mënyrë të suksesshme këto dy dokumente, natyrisht se duhen ushtrime gjithëpërfshirëse, që nga niveli lokal e deri te ai qendror dhe me skenarë jo vetëm te fatkeqësive natyrore, fatkeqësive tjera por edhe të akteve terroriste, për të zbatuar, testuar dhe përmirësuar, vendimmarrjen, koordinimin dhe reagimin e përbashkët te e agjencive të ndryshme. Pra na duhen ushtrime përmes të cilave do të testohet dhe vlerësohet gatishmëria kombëtare për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Për të mos e ngarkuar FSK-në me detyra të nivelit lokal dhe për t'i lënë vendin e merituar si forcë ushtarake, Kosovës i duhet që të ngritë kapacitetet menaxhuese dhe reaguese brenda Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, si dhe në institucionet tjera në nivelin lokal dhe qendror, sidomos me njësi të specializuara të Kërkim Shpëtimit Urban.

Telegrafi. com, 15:53 / 5.03.2012 .

Rrini pa drojë Amerikanët nuk do te largohen nga Kosova

Ky ishte njëri nga top lajmet e Radio Televizionit të Kosovës të datës 10 janar 2012. Dhe u bë shumë mirë që u hoq kjo drojë, sepse që nga 2 janari e këndej dikush si me shaka apo me ndonjë qëllim të caktuar ose sa për të na e prishur idilin e festës dhe fishekzjarrëve, lansoi lajmin tronditës se Amerikanët po përgatiten të largohen nga Kosova.Titulli i këtij lajmi ishte jo vetëm qesharak, por edhe tragjik njëkohësisht e po ashtu edhe shumë më tronditës se sa lajmi i parë. Kështu që sakaq mu kujtua thënia e Ismail Qemalit për fëmijët dhe popujt që flenë zbathur, bëjnë pallën e sefasë pa drojë sepse "gjithnjë do t'i mbrojë dikush".

Pa dashur që të frikësojë ata që asnjëherë nuk janë mësuar të jetojnë pa tutorë dhe pa dashur tua trazojë drojën e përgjumur atyre që moto jetësore e kanë vegjetimin e këpurdhës në bythën e lisit të madh, po shpalosi disa trende të sigurisë ndërkombëtare, rajonale dhe shtetërore:

E para: Tërheqja e ushtrisë Amerikane nga Iraku

Misioni Amerikan në Irak përfundoi në fund të vitit 2011. Qëllimet gjeostrategjike Amerikane në Lindjen e Mesme dhe posaçërisht në Irak ishin arritur, synime që në dukje ishin kontradiktore, por pse athua dukeshin të tilla? Pak para largimit Amerikan nga Iraku u eliminua Osama Bin Laden pastaj ndodhi pranvera Arabe, ku liderët dikur më të fuqishëm të shteteve myslimane po binin një nga një nga pushteti pa pasur shumë nevojë për aeroplanët dhe bombat amerikane, evropiane apo të NATO-s, por po preheshin nga druri i sëpatës së pyllit të tyre. Kështu Amerikanët vendosën të tërhiqeshin nga Iraku duke manifestuar një planifikim gjeostrategjik brilant njëkohësisht për tu këndellur dhe marrë veten për beteja të reja.

E dyta: A do të ndodh lufta Izraelito- Iraniane?

Irani duke ndjekur shembullin e Pakistanit drejt rrugës për tu bërë superfuqi nukleare nuk është e sigurt nëse po bënë blof apo vërtet po rrezikon rendin aktual botëror dhe balancin gjeostrategjik ndërkombëtar duke kërcënuar kështu me një luftë me pasoja shkatërruese për tërë botën. Sidoqoftë Arsenalin bërthamor që në këtë luftë të mundshme do ta përdorte jo vetëm Izraeli si një superfuqi misterioze nukleare, pastaj Irani dhe me gjasë edhe dy superfuqitë botërore (Amerika dhe Rusia), do të ishte me pasoja apokaliptike për mbarë njerëzimin në rruzullin tokësor. Pastaj përveç kësaj do të ndesheshin interesat e vendeve të fuqishme si Amerika, Rusia dhe të disa shteteve po ashtu të fuqishme Evropiane si: Gjermania, Franca dhe Anglia. Pra një luftë e tillë do të çrregullonte dhe ç'thurte ndarjen aktuale të botës sipas sferave të interesit dhe njëkohësisht do të rrezikonte sigurinë ndërkombëtare dhe botërore.

Kosova në vorbullën e trendeve të mundshme gjeostrategjike

Njohja e pamjaftueshme ndërkombëtare e Republikës së Kosovës, vështirësitë në shtrirjen e sovranitetit në tërë territorin e saj, interesat gjeostrategjike serbe në Kosovë, interesat gjeokonomike ruse në Ballkan, Evrozona e lëkundur nga kriza ekonomike me tendenca të shkapërderdhjes, marrëveshjet e paqëndrueshme Kosovë – Serbi, tendencat dhe kërkesat e një pjese opozitare të Republikës së Kosovës drejt një padëgjueshmërie qytetare me premisa anarkie, të gjitha këto favorizojnë aktivizimin e tërë planeve të vjetra dhe ato të hartuara rishtazi për referendumet, ndarjet dhe luftërat si mjeti i fundit serb, për të trazuar edhe njëherë Ballkanin, si gjithmonë gjatë historisë.

Referendumet, homogjenizimet ataviste, ndarjet, korrigjimet e kufijve ende janë të mbyllura në kutinë e Pandorës Ballkanike dhe serbët të vetëdijshëm dhe të frustruar, sepse dy shekujt sidomos shekulli i fundit nuk ju buzëqeshën aq shumë, dëshirojnë që me çdo kusht ta hapin këtë kuti e cila do të përfshinte me radhë: Sanxhakun, Vojvodinën, Kosovën Lindore, për të vazhduar në shtetet tjera fqinje si Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Duke pasë parasysh mundësinë e ndodhjes së kësaj katrahure Ballkanike dhe duke e parë se interesat gjeostrategjike dhe gjeoekonomike të fuqive të mëdha botërore janë drejtuar nga resurset energjetike të naftës, nuk mund ta marrim ndoshta si të pa qëllimtë dhe vetëm shaka lajmin e ftoftë të festës, në ditët e para të këtij viti se Amerikanët do të largohen së shpejti nga Kosova. Por, nuk është dilemë dhe çështje e vetme se a do të largohen Amerikanët nga Kosova apo jo? Ata megjithatë një ditë do të largohen pavarësisht vajit tonë por tani shtrohet pyetja se sa jemi ne të gatshëm dhe se sa hëpërhë po përgatitemi që më në fund një herë e përgjithmonë të qëndrojmë në këmbët tona si shtet dhe si komb dhe se si do tu përgjigjemi dhe si do të reagojmë ndaj këtyre sfidave të mundshme?

Tani më ne, duhet përfundimisht të harrojmë vesin e të fërkuarit të duarve nga gëzimi kur folësit e Radio Televizioneve tona apo mediet e shkruara dhe ato elektronike, apo liderët politik apo partiakë na japin ndonjë lajm “shpëtimtar” të

llojit mjeran të njohur ndër ne që nga vitet e 90-ta i cili lajm mundohet dhe ka për qëllim të na e heq frikën e robit me fjalët: “Rrini pa drojë, Amerikanët nuk do të largohen nga Kosova”.

Telegrafi. com 10:29 / 13.01.2012

Infrastruktura kritike dhe siguria nacionale

Sipas shumë definicioneve të vendeve të ndryshme të botës, infrastruktura kritike përbën: asetet, sistemet si dhe rrjetet, qofshin ato fizike apo virtuale të një shteti. Të gjitha këto janë shumë vitale për një shoqëri dhe një shtet të konsoliduar, saqë mosfunksionimi apo shkatërrimi i tyre do të kishte efekt destabilizues për sigurinë, ekonominë, shëndetin publik ose për të gjitha këto njëkohësisht. Duke pasur parasysh këtë fakt, mbrojtja, siguria dhe vijimësia e veprimtarisë së infrastrukturës kritike është dhe duhet të jetë me prioritet për çdo shoqëri. Sipas botëkuptimit tradicional, mbrojtja e Infrastrukturës Kritike nënkupton identifikimin e sistemeve dhe objekteve specifike me rëndësi të veçantë si dhe hartimin e planeve të mbrojtjes së kësaj infrastrukture. Qasja shkencore bashkëkohore është e drejtuar drejt eko-sistemit të përgjithshëm, rrjetit dhe vartësisë së tij, dhe pikërisht ekspertët e Teknologjisë Informative, kanë njohuri dhe përvoja të mëdha në fushën e rrjeteve. Sistemi i Teknologjisë Informative është faktor kyç në krijimin e ekonomisë konkurruese, me një qeverisje efikase, transparente dhe kursimtare. Sot kur po jetojmë në kohën e shpërndarjes gjithnjë e më të madhe të informacioneve elektronike, rrjeteve sociale, ose në një shumëllojshmëri të shënimeve të tjera inteligjente, një rritje e fuqishme e E-informacioneve, definon edhe vetë pjesët e Sistemit të Teknologjisë Informative si infrastrukturë kritike të rëndësishme, kurse në anën tjetër na imponohet si zgjidhje e mirë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike në kuptimin e gjerë. Zgjidhjet përmes Sistemit të Teknologjisë Informative mund të procedojnë një spektër të gjerë informacionesh, pa marr parasysh formatin, burimin, gjuhën etj., dhe këtë informatë të proceduar e bëjnë humane, të dobishme në procesin e vërtetë të punës ose në situata incidenti, atëherë kur është më se e nevojshme - në kohë

reale. Gjithashtu mungesa e informacioneve të strukturuara të caktuara, me kohë dhe në vend, mund të kërcënojnë infrastrukturën kritike, shoqërore – ekonomike dhe ta shndërrojnë atë në irracionale ose të padobishme për përdorim, si p.sh furnizimin me energji, zvogëlimin e aftësisë së shërbimeve për mbrojtje dhe shpëtim. Gjithashtu, mungesa e energjisë, pasiguria për furnizim me energji, si dhe mungesa ose infrastruktura kritike jo adekuate, drejtpërsëdrejti mund të nxisin zvogëlimin e forcave mbrojtëse, në atë mënyrë që forcat luftarake, transportuese, komandimi dhe komunikimi, logjistika etj. Mos të mund tu vijnë në ndihmë forcave civile për nevojat e tyre në raste të fatkeqësive elementare, kushteve ekstreme për jetë dhe punë ose edhe në raste të ndryshme mjekësore.

Definimi dhe përcaktimi i infrastrukturës kritike, nevojë e domosdoshme

Republika e Kosovës ende nuk e ka përcaktuar me asnjë dokument, akt ligjor apo nënligjor përfundimisht se çka është infrastrukturë kritike, kujt i përket dhe kush dhe si duhet ta mbrojë atë. Për herë të parë, termi infrastrukturë kritike është përmendur në Udhëzimin Administrativ XIX/08 Mbi Metodologjinë e vlerësimit të Rreziqeve dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim. Edhe në këtë dokument nuk përcaktohet infrastruktura kritike, por vetëm obligohen institucionet shtetërore dhe sektori privat për të bërë vlerësimin e rreziqeve dhe planet për Mbrojtje dhe Shpëtim për Infrastrukturën Kritike.

Përvojat Ndërkombëtare

Përcaktimi i Infrastrukturës Kritike sipas BE-së

Sipas BE-së Infrastrukturën kritike e përbëjnë veprimtaritë, rrjetet, shërbimet dhe të mirat materiale, teknologjia informative, prishja apo shkatërrimi i së cilës do të ndikonte në mënyrë të konsiderueshme në shëndetin, sigurinë dhe prosperitetin ekonomik të qytetarëve ose në veprimin efektiv të qeverive të shteteve anëtare. Infrastruktura kritike përfshin, fusha të shumta ekonomike, duke përfshirë gjithashtu edhe bankat dhe financat, transportin, energjetikën, shërbimet komunale, shëndetësinë, furnizimin me ushqime si dhe shërbimet shtetërore

kyçe. Sipas përcaktimit të Infrastrukturës në BE dhe, kryesisht edhe në vendet tjera të zhvilluara, sektorët që përbëjnë infrastrukturën kritike janë: Pajisjet energjetike dhe rrjetet, Teknologjia Informative dhe e Komunikimit, Financat, Shëndetësia, Ushqimi, Uji, Transporti, Prodhimi, Deponimi dhe Transportimi i Materieve të Rrezikshme dhe Qeverisja".

Përcaktimi i infrastrukturës kritike në Republikën Federale të Gjermanisë (Ministria e Punëve të Brendshme e RFGJ)

"Me infrastrukturë kritike kuptojmë organizatat dhe pajisjet (të rëndësishme për shtetin), bashkësinë, të cilat ne rast të paaftësimit ose pengimit të punës së tyre do të krijohej një çrregullim domethënës dhe i gjatë në furnizim, përçarje e sigurisë publike në shkallë të gjerë, dhe do të kishte pasoja tjera dramatike për sigurinë publike[30]". Përveç këtyre, infrastrukturën kritike e përbëjnë edhe: sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm, sistemet e energjisë elektrike si dhe sistemi shëndetësor publik dhe pajisjet e tyre.

Përcaktimi i infrastrukturës kritike dhe resurseve kyçe në SHBA

Në SHBA infrastrukturë kyçe kritike konsiderohen të mirat, sistemet dhe rrjetet, qofshin materiale apo jo materiale (fizike ose virtuale), aq të rëndësishme për SHBA-në, saqë paaftësimi ose shkatërrimi i tyre veç e veç apo ne kombinim, do të dobësonte sistemin e sigurisë nacionale, sigurinë ekonomike nacionale, dhe sigurinë e shëndetit publik. Me Direktivën e Kryetarit të SHBA-ve me shenjën 7 ("HSPD 7Abstract-USA), janë përcaktuar parametrat për themelimin e sistemit të mbrojtjes së këtyre resurseve nga sulmet terroriste. Direktiva presidenciale nr 7 e Sigurisë së Atdheut (Homeland Security Presidential Directive 7), krijon një politikë kombëtare për departamentet federale dhe të agjencive për identifikimin dhe prioritizimin e infrastrukturës kritike, për ta mbrojtur atë nga sulmet terroriste. Direktiva përcakton kushtet përkatëse dhe shpërndan 31 deklarata të politikave. Këto deklarata të politikave përcaktojnë se çfarë mbulon Direktiva dhe rolet e

[30] www.uhm.hr...|marijan_m Obrambene File Format: Microsoft Powerpoint-Pripreme Pravnih Osoba i Zastita Objekata Vaznih za Obranu Republike Hrvatske, Zagreb 2011

ndryshme që do të luajnë agjencitë federale, shtetërore dhe ato lokale në mbrojtjen e infrastrukturës kritike[31]."

Renditja në listat indikative të infrastrukturës kritike në vendet e botës

Thuaja se të gjitha shtete e zhvilluara të botës në listën e identifikimit të Infrastrukturës kritike në vendin e parë e kanë vendosur Energjinë, pastaj telekomunikimin, shërbimet e ndryshme si ato shëndetësore, transportin, dhe qeverinë. Për dallim prej Zvicrës dhe Suedisë që ushqimin e kanë renditur mjaft poshtë, SHBA-ja ushqimin e ka renditur në vendin e katërtë kurse menjëherë pas ushqimit e ka renditur bujqësinë si infrastrukturë kritike. Po ashtu edhe Australia dhe Holanda ushqimin e kanë renditur në vendin e katërtë kurset vendet tjera, ushqimin e kanë renditur në fund të listës së Infrastrukturës kritike ose fare. Thuaja se çdo vend i fuqishëm në Evropë dhe Botë telekomunikimin e ka renditur në vendin e dytë kurse uji si infrastrukturë kritike, më së larti është i renditur në Britaninë e Madhe (tetë), Suedi (tetë) dhe SHBA (dhjetë). Në mesin e shteteve si Kanadaja , Britania e madhe, SHBA-të, Gjermania, Suedia, Norvegjia dhe Holanda, vetëm Zvicra nuk e ka renditur në vendin e parë Energjinë por objektet dhe Shërbimet.

Sektori i Energjetikës si infrastrukturë kritike dhe Siguria Nacionale

" Siguria energjetike pasqyron pjesën e rëndësishme të sigurisë nacionale të çdo vendi. Qasja ndaj energjisë dhe burimeve energjetike si dhe ndikimi i infrastrukturës kritike janë të një rëndësie të madhe, si për kualitetin e jetës të popullsisë në përgjithësi të një shteti, po ashtu edhe për ekonominë dhe sektorin publik. Gjatë historisë, shpesh, kontrolli ndaj burimeve energjetike ishte shkak i konflikteve shoqërore dhe krizave të sigurisë, kështu që nuk duhet të habitemi që aspekti gjeopolitik i sigurisë energjetike është shumë i theksuar në strategjitë e sigurisë së shumë shteteve të botës. "Kjo çështje përveç që pasqyron kërcënim për sigurinë regjionale dhe nacionale, ka edhe një aspekt tjetër, ai i lidhur me

[31] Oficial website of the Department of Homeland Security

sigurinë e ambientit[32].” Prishjet në sistemet energjetike dhe infrastrukturën kritike, mund të sjellin deri të ndotja e ambientit në një shtrirje që mund të lëviz nga incidentet lokale deri tek katastrofat ekologjike, sikurse ajo e Çernobilit.

Në anën tjetër sociologjia bashkëkohore me shumë arsye bindëse, flet për shoqërinë moderne si “shoqëri rreziku”, në të cilën rreziqet e caktuara kërcënojnë individët dhe grupet e caktuara më shumë se sa rreziqet e jashtme. Për këtë duhet ta kemi në mendje se, pyetja e kontekstit shoqëror për mbrojtje dhe siguri të infrastrukturës kritike energjetike, shtrohet në momentin kur të gjitha faktet dëshmojnë se aspektet institucionale dhe zhvillimore të “infrastrukturës nacionale energjetike”, nën ndikimin e marrëdhënieve ndërkombëtare (globalizimit), janë të ndërvarura nga prodhuesit dhe shpenzuesit më të mëdhenj të energjisë në Evropën e integruar. Marrëdhëniet e reja të ndikuara nga integrimet Evropiane sjellin nevojën e rishikimit të strategjive kombëtare energjetike dhe dilemat për mundësinë e pavarësisë për furnizimin me burimet kyçe, për rolin e shtetit në zhvillimin aktual dhe afatgjatë të sektorit elektro-energjetik, si dhe marrëdhëniet në mes infrastrukturës energjetike (si segment i infrastrukturës kritike) dhe sigurisë nacionale. Për këtë arsye sot më shumë se asnjëherë tjetër, është me rëndësi të disponojmë me vlerësime relevante teknike-teknologjike, për mundësitë potenciale të rrjeteve energjetike që kemi si dhe përdorimin dhe ruajtjen e stoqeve të disa llojeve të burimeve. Kështu pra, vazhdimisht duhet të jemi të vetëdijshëm se Sistemi Energjetik është një komponent i rëndësishëm i sigurisë nacionale për secilin shtet. Disponueshmëria e energjisë dhe burimeve të energjisë si dhe efikasiteti i infrastrukturës kritike kanë një rëndësi të veçantë, fillimisht për ekonominë e një vendi por edhe për të gjitha segmentet tjera të shoqërisë, e në këtë kontekst edhe çështjet e sigurisë energjetike dhe infrastrukturës kritike, detyrimisht kanë edhe karakter multi disciplinar.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike

[32] Strategija Nacionalne Sigurnosti RH, Zagreb 2002,III, faqe 26

Për tu definuar infrastruktura kritike në mënyrë kualitative, për ta mbikëqyrur dhe zhvilluar atë, së paku duhet të ketë një autoritet institucional i cili do të merrte pronësinë, përgjegjësinë dhe autoritetin. Natyrisht se do të nevojitej edhe drejtimi strategjik i këtij segmenti për arsye të hyrjes në integrimet e reja dhe arritjeve të reja dhe të mëdha teknologjike, të cilat gjithmonë dhe gjithnjë e më shumë i ndryshojnë kushtet e të bërit biznes me qëllim të ruajtjes dhe forcimit të infrastrukturës aktuale. Duhet ta kemi parasysh se zhvillimi teknologjik ka ndryshuar edhe mënyrën e të bërit biznes, menaxhimit dhe udhëheqjes politike si dhe kuptimin e sigurisë nacionale dhe publike. Gjithashtu teknologjia është bërë më e lirë, më e sofistikuar dhe më e arritshme por që mund shndërrohet në një instrument potencialisht të rrezikshëm, që është vështirë të kontrollohet. Për këtë arsye është e domosdoshme që të krijohen parakushtet për zvogëlimin e rreziqeve nga aktivitetet negative dhe pasojave në infrastrukturën kritike. Çrregullimet në veprimet kontinuale të institucioneve dhe infrastrukturës kritike, mund të jenë me pasoja të mëdha në sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Infrastruktura kritike në vete ngërthen subjektet nga sektori publik dhe privat, shpërndarjen, rrjetet dhe informacionet të cilat sigurojnë qarkullim të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, e që janë jetike për stabilitetin e sistemit ekonomik, shëndetit publik dhe funksioneve strategjike te vendit. Ndërprerja e funksionimit në një segment të caktuar ose në sistemin e infrastrukturës, mund të sjell ndërprerjen ose mos funksionimin e sisteme ve tjera, dhe kështu në mënyrë të kombinuar të nxisë pasoja afatgjata në sistemin qeverisës, ekonomi, shëndet publik, siguri, siguri nacionale dhe në besimin e publikut. Në grupin e infrastrukturës kritike hyjnë edhe deponimi dhe transporti i naftës dhe gazit, bankat dhe financat, transporti, furnizimi me ujë, shërbimet emergjente (përfshirë edhe ato mjekësore, të policisë, zjarrfikës dhe shpëtimit), si dhe qeveria. Tema e infrastrukturës kritike është e pa tejkalueshme viteve të fundit, sidomos në literaturën shkencore, duke filluar që nga parandalimi i rreziqeve dhe katastrofave deri te mundësitë e veprimeve të dëmshme, nga aktivitetet njerëzore. Me elementet e Infrastrukturës kritike përballemi në të gjitha fushat e aktiviteteve tona të përditshme. Në qoftë se nuk e kuptojmë rëndësinë e kësaj

teme si prioritet në proceset e e vendim marrjes së lartë, frika nga investimi i pamjaftueshëm në infrastrukturën kritike do të jetë e arsyeshme, kurse ekonomia do ti nënshtrohet një rrezikut të madh. Parakushti i zhvillimit kualitativ dhe ndërlidhja e të gjitha segmenteve të sigurisë së infrastrukturës kritike, fillon në shumicën e rasteve me sistemet e lidhura ngushtë ndër vete ose që janë të ndërlidhura me sistemet publike. Problemi thelbësor nga i cili rrjedh identifikimi i domosdoshëm i infrastrukturës kritike, mund të ilustrohet me faktin se sulmi në një segment të caktuar të infrastrukturës kritike, vetvetiu krijon dëme të shumëllojshme dhe të mëdha, sepse një sulm relativisht i vogël në një objekt të infrastrukturës kritike, mund të ketë pasoja të mëdha dhe të dëmtojë shumë segmente tjera, të infrastrukturës kritike, të ndërlidhura së bashku.

Përmbyllje

Me proceset e integrimit Evropian iniciohen edhe kërkesat për ndërlidhjen e infrastrukturave regjionale në tërësinë e infrastrukturës Evropiane. Në këtë drejtim rëndësi e veçantë i kushtohet infrastrukturës kritike si bartëse e zhvillimit ekonomik stabil dhe marrëdhënieve shoqërore. Me definimin e kornizës së infrastrukturës kritike Nacionale, do të shohim se kjo infrastrukturë është një sistem kompleks i përbërë nga potenciali njerëzor, objektet fizike dhe lidhjeve të tyre përmes sistemeve të teknologjisë informative. Pikërisht kjo e fundit, industria e TI-së, është e domosdoshme dhe është faktori kyç, për shkak të aftësisë së saj sinergjike në ndërlidhjen e degëve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që tradicionalisht janë konservative. Është me rëndësi të dihet roli i deri tashëm shumë i rëndësishëm i sektorit të teknologjisë informative në modernizimin dhe transformimin e ekonomisë dhe shoqërisë. Jemi dëshmitar të trendëve në rritje të rrjeteve sociale si Facebook, YouTube dhe rrjeteve të ndryshme, kurse kemi parë shpesh se gjatë ndodhjes së incidenteve të mëdha ose katastrofave, njerëzit kanë reaguar në mënyra të ndryshme, kryesisht duke shfrytëzuar të gjitha resurset e mundshme për mbrojtje dhe shpëtim.- dhe natyrisht edhe këto rrjete sociale. Kur të mbijetuarit nga këto fatkeqësi i kishin pyetur se çka ju mungonte më së shumti, ata ishin përgjigjur: Uji dhe informacionet. Prandaj, në

mënyrë përmbyllëse mund të konstatojmë se për një mbrojtje të suksesshme të infrastrukturës kritike, jo vetëm në kushte ekstreme, është i domosdoshëm përcaktimi dhe definimi i infrastrukturës kritike, definimi i pronarit, hartimi i planeve sektoriale për mbrojtje, hartimi i Planit Kombëtar për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, informatizimi i shoqërisë dhe ngritja e vazhdueshme e njohurive nga Teknologjia informative si dhe vetëdijesimi për rëndësinë e rrjetëzimit të të gjitha sistemeve të infrastrukturës kritike.

Telegrafi.com, 13.05.2013

Koloneli Zhak Ogar ose autori i librit " Evropa vdiq në Prishtinë"

Para ca kohësh, gjegjësisht me 7 Korrik 2014, koloneli Francez Zhak Ogar botoi librin anti shqiptar, anti UÇK, anti Evropian, anti Amerikan dhe anti njerëzor " Europa vdiq në Prishtinë."

Biografia e tij:

1 Qershor, 2010-Pjesë nga intervista e Zhak Ogar në portalin www.blic.rs/forum/index.php?topic=961.8825;wap2 e titulluar : "Do ta ktheni edhe ju Alzasin dhe Lorenin tuaj".

Zhak Ogar, Kolonel i ushtrisë Franceze dhe autor i librit " Evropa vdiq në Prishtinë" si dhe bartës i urdhërit të Shën Savës, është Francez i lindur në Paris i cili 26 vite i ka kaluar në ushtrinë Franceze.

Ja se qka thotë për vete koloneli: "Unë rrjedh nga një familje ushtarakësh Francez. Gjyshi im ishte gjeneral i Armatës franceze si kurse ishte edhe babai im. Qysh si fëmijë isha edukuar se populli serb gjithmonë kishte qenë mik i kombit francez. Vetëm në vitin 1998 kisha në dorë dosjen e Kosovës". Më tutje koloneli me bindje ortodokse dhe i mbrujtur që nga fëmijëria me idetë dhe dashurinë ndaj ortodoksizmit, sllavizmit dhe serbizmit në veqanti, vazhdon:

“Para se babai im të vdiste nga kanceri, po bisedoja me te dhe ai më kishte thënë: “ ja shikoje, jemi dëshmitarë të lindjes së një Europe, e cila nuk është ajo Europa e stërgjyshërve tanë, kjo është një Europë me të cilën manipulojnë Amerikanët. Kështu fliste babai im në prag të vdekjes”.

Ardhja në Kosovë

Si e sheh ai Kosovën pas zbarkimit të forcave të KFOR-t në Kosovë në qershor 1999?

“Erdha në Kosovë pas bombardimit të vitit 1999 dhe përshtypjet e mia do ti botoj në librin i cili do të dal së shpejti dhe i cili do të titullohet” Europa vdiq në Prishtinë”

“E zbulova Kosovën duke hyrë nga Gjilani, ku na pranuan zyrtarët sërb-pas bombardimit nga NATO me 10 qershor. Pastaj kam ardhur në Mitrovicë ku në njërën anë u takova me pushtetarët sërb e në anën tjetër me shefat e UÇK-së.

Duke shkruar për aktivitetin e kolonelit në Kosovë portali vazhdon: “Koloneli Zhak Ogar në vitin 1999 kishte ardhur në “Kosovë dhe Metohi” nga Maqedonia dhe ishte komandant i njësive speciale Franceze në “Kosovë dhe Metohi”. Këtu qëndroi për kohë të shkurtër, vetëm një muaj aq sa për të shpëtuar murgeshat e Manastirit të Deviqit dhe për këtë arsye ishte dekoruar me urdhërin e Shën Savës nga Kisha Pravosllave Serbe”.

Këtu do të bëjë një digresion lidhur me këtë çështje. Në një opinion timin pata shkruar lidhur me veriun e Kosovës e të cilin e pata titulluar:” **Veriu i Kosovës, sigurizimi dhe politizimi i çështjes”, duke shkruar për faktorët kryesor që në mënyrë faktike apo bazuar në teoritë konspirative kishin kontribuar që veriu të mbetej konflikt i ngrirë apo zonë problematike, pata Parafrazuar kështu:**

“Qysh në bisedimet Ahtisaari, Millosheviq, Çernomirdin thuhet se nga diplomacia Ruso - Serbe ishin bërë përgatitjet se si do të kompromethej çdo sukses i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Një prej bashkëpunimeve

strategjike ndërmjet BIA-s dhe SVR-së rreth ose kundër Kosovës, ishte intensifikuar gjatë luftës e sidomos gjatë bombardimeve të NATO-s në Kosovë, në muajtë prill dhe maj 1999. Në atë kohë kryetari i Finlandës Marti Ahtisaari i lindur në qytezën Viborg të Rusisë, zhvillonte bisedime me Sllobodan Millosheviqin dhe Viktor Çernomirdinin (ish kryeministër i Rusisë i Çili vdiq me 03 nëntor 2010, pak para zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Kosovë"!)

Sidoqoftë, çështja e veriut të Kosovës u sigurizua fillimisht nga bashkëpunimi i ngushtë i Forcave ndërkombëtare - KFOR-it Francez, UNMIK-ut, dhe shtetit të Serbisë të cilët mbështetën fuqishëm serbët e veriut për bojkot ndarje dhe dhunë ndaj shqiptarëve dhe shtetësisë së Republikës së Kosovës, me të gjitha strukturat shtetërore dhe sidomos me ato të sigurisë. Faktori ndërkombëtar - KFOR-i Francez i cili u vendos në Mitrovicë në vitin 99 dhe UNMIK- u, Sigurizuan çështjen e veriut (e cila mund të depolitizohej ose të politizohej, që donë të thotë të futej në mekanizmat institucional dhe të zgjidhej lehtësisht), duke frikësuar dhe demonizuar qëllimshëm opinionin vendës në veri nga një emër i vetëm, UÇK, me qëllim të spastrimit etnik dhe të krijimit të gjendjes faktike në favor të Serbisë. Serbia përmes mekanizmave shtetëror jo vetëm që çështjen e veriut e bëri kërcënim dhe rrezik për Kosovën dhe rajonin por arriti që përmes skenarëve të shumtë, me demonstrata dhe protesta radikale, përveç tjerash në emër të drejtave të serbëve në veri, të vrasë dhe të dëbojë shqiptarët nga prona e tyre shekullore e po ashtu të vrasë dhe të plagos ushtarët e KFOR-it, Policët e UNMIK-ut si dhe më vonë edhe ata të Eulexit. Skenarëve të tillë destruktiv shpesh në mënyrë të pavetëdijshme ju bashkëngjitën edhe shqiptarët sikurse ai i protestave të vitit 2004..

Vendosja dhe shpërndarja e forcave të KFOR-it në Kosovë pas intervenimit të NATO-s: Roli i Francës

Franca e cila do te vendoste kontingjentin e saj në veriun e Kosovës me rolin e saj deklarativisht pro Kosovës, do të dëshmohej si shumë negative dhe armiqësore në çështjen e veriut, si dhe pse do te ndodhte kjo? Franca është anëtare e disa organizatave të njohura botërore ndër të cilat është edhe NATO,

prej të cilës ajo ishte tërhequr në vitin 1966. Fillimisht ajo ishte entuziazmuar me rolin e saj parësor ne Rambuje, por interesat dhe miqësitë e vjetra ortodokse e pengonin që të luante rol konstruktiv. Në Francë mbretërojnë dy linja, ajo pro Amerikane dhe pro humanitare që është e mbledhur rreth mjekut dhe humanistit Bernard Kushner dhe ajo pro ortodokse dhe pro ruse dhe pro serbe që kryesisht dominon në radhët ushtarake franceze. Këto dy linja u manifestuan më së shumti në terren (Kosovë) si gjatë bombardimeve po ashtu edhe gjatë vendosjes së Kontingjentit Francez në Kosovë, i cili kontingjent me ndihmën e UNMIK-ut dhe Kryesuesit të PSSS-së i cili fatkeqësisht ishte po ashtu francez, Bernard Kushner, krijoi zonë dhe hapësirë që Serbia me forcat e saja paramilitare dhe strukturat tjera ta vendosin rendin ne veri. Kjo vendosje u përshkallëzua me dhunimin, vrasjen dhe dëbimin e popullatës shqiptare nga veriu i Kosovës për të shndërruar këtë pjesë të Kosovës në fakt të kryer. Po ashtu vëmendjen nga rreziku verior e tërhoqi edhe ndërhyrja dhe ardhja e paplanifikuar e forcave (kontingjentit) ruse në Kosovë.

Koloneli Zhak Ogar përfaqësuesi tipik i rrymës ortodokse proserbe nga grupimi ushtarak francez

Si i sheh dhe i përcepton shqiptarët dhe serbët koloneli Ogar, përfaqësusesi tipik i grupimit ortodoks, do ta shohim në vazhdimin e intervistës së tij të dhënë në vitin 2010.

“Unë tek shqipatrët njofta linjat karakteristike që gjenden në disa shtete arabe dhe i thash kusheririt tim që ishte edhe ai gjeneral, i cili poashtu kishte ardhur në Kosovë, se i duhet që sipas nevojës, të ishte shumë i rreptë dhe i fortë ndaj shqiptarëve sepse nëse tregon ndonjë lloj humaniteti ndaj tyre, ose mirësi të tepruar, do të mund të kishte telashe të mëdha. Përkundrazi ai tregoi një mirësjellje të madhe ndaj tyre dhe filloi të kishtë shqetësime”.

Cili ishte misioni i Kolonelit në Kosovë?

“Erdha në Kosovë pas bombardimit të vitit 1999 dhe përshtypjet e mia do ti botoj në librin i cili do të dal së shpejti dhe i cili do të titullohet ” Europa vdiq në

Prishtinë". E zbulova Kosovën duke hyrë nga Gjilani, ku na pranuan zyrtarët sërb-pas bombardimit me 10 qershor. Pastaj kam ardhë në Mitrovicë ku në njërën anë u takova me pushtetarët sërb e në anën tjetër me shefat e UÇK-së. Urdhërat e Shefit të Shtabit Kryesor të Ushtrisë Franceze ishin të thjeshtë: të zihen pozicionet në sektorin e ardhshëm Francez, për tia pamundësuar UÇK-së hyrjen në mes ushtrisë serbe në tërheqje dhe ushtrisë franceze në ardhje".

Përshkrimi i UÇK-së nga koloneli Francez

Duke përshkruar takimin me komandantët e UÇK-së koloneli thot**:** "Si shembull po e marr Sami Lushtakun, Komandantin e UÇK-së për Drenicën i cili një ditë erdhi tek unë, përafërsisht ishte data 15 ose16 korrrik dhe më tha se ata kishin dëshirë të organizonin një defile të fitores në Skenderaj. Unë e shiqova dhe i thashë se unë nuk e dij se çka është ky Skenderaj. Me sa dij unë ekziston një rezolutë 1244 e cila thotë se Kosova dhe Metohia është pjesë integrale e Serbisë dhe se banorët nuk mund ti ndryshojnë emrat e qyteteve vetëm nga dëshira, kështu që qyteti quhet Serbicë, kjo është e para kurse për të organizuar një defile fitoreje, duhet të ketë fillimisht një fitore dhe duhet të ketë edhe ushtarë. Ju nuk jeni ushtarë, dhe as fitimtarë, kështuqë këtu në Serbicë nuk do të ketë defile fitoreje. Kujtoj se kjo ishte një gjuhë e thjeshtë të cilën ai shumë mirë e kuptoi".

Roli i LDK-së dhe raportet e saj me UÇK-në dhe faktorin ndërkombetar pas luftës sipas Kolonelit Ogar

" Misioni im gjithashtu ishte përpjekja për të gjetur varrezat masive. Gjeta shumë më pak se sa kishim pritur, gjegjësisht (kishim pritur) 100. 000 të vdekur. Intervenimi i NATO-s natyrisht kishte filluar mbi gënjeshtrat se ishte kryer gjenocid ndaj shqiptarëve. Bill Klinton tha se ishin 100. 000 të vrarë për të arsyetuar bombardimin. Tani e dijmë se si dhe sa lehtë amerikanët përdorin këtë lloj gënjeshtre dhe se sa janë adaptuar me këtë, në mënyrë që të bëjnë të ligjshme intervenimet e tyre ndërkombëtare.

Takimet me zyrtarët e lartë të LDK-së menjëherë pas luftës, koloneli Ogar i përshkruan kështu: “Shumë shpejt shqiptarët e partisë së Rugovës erdhën dhe më thanë: Do të gjeni një gropë në fshatin i cili ishte shkatërruar jo nga ana e serbëve por nga UÇK-ja. Ne nuk jemi UÇK, nuk jemi për Thaqin por për Rugovën. Kështu filluam të kuptojmë se viktimat nëpër shumë ato gropa nuk ishin vrarë nga serbët por këtë e kishin bërë shqiptarët. Në anën tjetër, unë kisha kontakte me ushtrinë dhe policinë serbe dhe kur ua kërkova informatat për këto çështje, ata më thanë: Shkoni në atë vend. Aty kemi vrarë 35 pjestarë të UÇK-së, aty është një gropë e kthyer nga Meka në të cilën kemi vendosur gëlqere dhe kaq. Kjo nuk ishte një gropë me viktima civile. Aty ishin të varrosur pjestarë të vrarë të UÇK-së në luftimet me forcat ushtarake dhe policore serbe”.

Doktrina Amerikane sipas Ogar-it

Në pyetjen se pse një pjesë e opinionit Europian dhe vetë Amerika janë në anë e shqiptarëve, Koloneli Ogar përgjigjet kësisoji: “Sa i përket Amerikës, jam plotësisht i bindur se duke i krijuar dy shtete Islame në Europë sikurse Bosnja dhe Hercegovina dhe Republika e Kosovës, Amerikanët po vrasin Europën. Po krijojnë tërësi, të ndryshme të cilat nuk mund të asimilohen në Europë dhe duke e bërë këtë ata po e dobësojnë Europën. Për shtetet tjera dhe Francën kjo është e pakuptueshme, ky është atlantizëm, përshtatje poltikës amerikane, pa shpirt kriticizmi, pa asnjë farë vizioni për të ardhmen”.

Doktrina Evropiane sipas Ogar- it dhe këshilla e tij për serbët se si duhet ta rikthejnë Kosovën

Sipas Ogar, B.E-ja tërësisht e ka shkatërruar Francën, e ka shkatërruar ekonominë e saj dhe fuqinë blerëse, “ka shkatërruar shtresën tonë të mesme kurse më së shumti vuajnë më të varfërit. B.E nënkupton që për gjithqka vendos ajo biles edhe për verën të cilën e pijmë, për bukën që e hamë dhe se si duhet ta gatuajmë... Për këtë arsye Francezët (janë nacionalistë të mëdhenjë) sikurse hungarezët dhe Qekët janë kundër B.E-së”.

Këshilla për serbët:

Në pyetjen e gazetarit se si do ti këshillonte serbët rreth zgjidhjes përfundimtare të qështjës së Kosovës, Ogar përgjigjet:

“Nuk më takon mua tu jap këshilla serbëve por natyrisht se kam ide për këtë çështje. Para jush janë dy rrugë: rruga e keqe, ajo për të cilën mendohet se Europa do të zgjidh problemet e Serbisë por ajo nuk rregullon as problemet e Francës dhe ajo sikur ka një tendencë të vështirësimit të problemeve tona përmes një burokracie të tmerrshme, sipas një lloji të unifikimit, nivelizimit kulturor, dhe largimit të gjithë asaj që ishte pasuri individuale e jona, në llogari të një barazie e cila është e dhimbshme dhe pa ardhmëri. Rruga e dytë është mbledhja e të gjithë serbëve të vullnetit të mirë, të cilët e duan vendin e tyre, vlerat dhe traditën, në një ideologji të hapur, për një Europë të ardhshme, të cilën do ta formojmë një ditë, e të cilën e shoh si ekskluzivisht të krishtere. Sot po kërcënohen identitetet tona dhe detyrë e jona është që të mbrojmë këto identitete në mënyrë që një ditë do të mund të ndërtojmë një konfederatë, krishtere, Europiane. Ky është mendimi im”. Dhe krejt në fund koloneli Ogar shpreson dhe frymëzon serbët se: “Sikurse Alzasi dhe Loreni që para dyzet vitesh ishin gjermane, kështu edhe ju ndoshta për pesë, dhjetë apo njëzetë vite do ta ktheni Kosovën. Kosova dhe Metohia ka qenë, është dhe do të mbetet gjithmonë serbe”.

Ky është koloneli Francez Zhak Ogar, ish komandant i njësive speciale Franceze që qëndroi në Kosovë për vetëm një muaj dhe tani së fundmi botoi librin “ Evropa vdiq në Prishtinë” Nga sa shihet nga kjo që u shkrua më lartë, ka një ngjashmëri tragjike në mes kolonelit Z (ampa) të Kadaresë në romanin “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur” dhe kolonelit Zh (ampa), përfaqësuesit tipik të një grupimi militar në ushtrinë franceze, me prirje tradicionalisht pro serbe, pro ortodokse dhe neokolonialiste.

16, dhjetor 2014, Infokusi

Qentë endacak dhe menaxhimi i rreziqeve në nivelin lokal

Rasti i fundit i mbytjes së një fëmiu nga qentë endacak i ndodhur në Fushë Kosovë, është sa tronditës dhe tmerrues poaq edhe akuzë e rëndë dhe trokitje në ndërgjegjen morale për (mos) kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore që i ka niveli lokal në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve, çoftë sipas ligjit për qeverisjen lokale, çoftë sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera. Rasti si ky i fundit në Fushë Kosovë nuk është i rrallë as i vetëm në Kosovë, kurse turmat e qenëve endacak nuk janë dukuri vetëm e kësaj komune por anë e kënd vendit. Pati një tendencë nga një grup i njerëzve vullnet mirë që kanë mision mbrojtjen e kafshëve, sidomos qenëve endacak që me sistemimin, grumbullimin, vaksinimin dhe sterilizimin e tyre të merreshin seriozisht, pasi që ligji e ndalon vrasjen e tyre por me gjasë neglizhenca e autoriteteve përgjegjëse dhe neni i ligjit për ndalimin e vrasjes së tyre, do të jenë shkaktarë të mbytjes së qytetarëve tanë e sidomos të grupeve ose komuniteteve me cenueshmëri. Në praktikat moderne të vlerësimit të rrezikut dhe rrezikshmërisë, prioritet kanë grupet me cenueshmëri të lartë ose ndryshe komunitetet vulnerable siç është komuniteti RAE, por jo vetëm në Fushë Kosovë, por edhe kur bëhet vlerësimi i rreziqeve në çdo nivel qendror dhe ate lokal e që është përgjegjësi e drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim dhe drejtorive tjera, caktohen rreziqet me prioritet dhe komunitetet që mund të goditen më shumë nga këto rreziqe. Këto komunitete mund të jenë: komunitetet e dobëta ekonomikisht, komunitetet etnike, femijtë, pleqtë, njerëzit me nevoja të veqanta etj..

Sa i përket menaxhimit të rreziqeve apo menaxhimit emergjent në Republikën e Kosovës, niveli lokal len shumë për të dëshiruar. Ekziston një situatë paradoksale rreth drejtorive për mbrojtje dhe shpëtim. Pasi që me ligj kjo drejtori nuk është përcaktuar si drejtori e domosdoshme, mbetet në mëshirën e kryetarëve të komunave që të ngrisin apo jo këto drejtori. Dhe paradoksi është edhe më i madh kur komunat e vogla që kanë një shkallë rrezikshmërie më të

vogël nga fatkeqësitë ntyrore dhe fatkeqësitë tjera, kanë drejtori për mbrojtje dhe shpëtim kurse ta zëmë kryeqyteti i Kosoves ku frekuentojnë brenda ditës afër një million qytetarë, ku ka ambasada të huaja dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare, ku shkalla e rrezikshmërisë është shumë e lartë, nuk ka një drejtori për mbrojtje dhe shpëtim. Praktikat e kryeqyteteve të rajonit dhe vendeve tjera na tregojnë se në këto kryeqytete zakonisht ka dy drejtori apo institucione që merren me menaxhimin e rreziqeve dhe fatkeqësive të të gjitha llojeve, një drejtori për kryeqytetin me njësitë e tij administrative dhe një institucion ose drejtori vetem për kryeqytetin. Për fatin e keq të qytetarëve, në Kosovë edhe aty ku ekzistojnë këto drejtori kanë aq pak staf dhe aq të pa sistemuar sipas ciklit te menaxhimit emrgjent, saqë me vështirësi hartojnë edhe një dokument të vetëm, siç është ai i vlerësimit të rreziqeve, si bazament për hartimin e planeve operative emergjente.

Sidoqoftë të kalojmë tash tek shkaktari i kësaj ngjarje të dhimbshme dhe tragjike të humbjes së një jete njeriu e për më keq, jetës së një fëmiu dhe të shohim se me çka po ballafaqohemi çdo ditë dhe si ta menaxhojmë këtë rrezik.

Si të zgjidhet çështja e qenëve endacak?

Nga dita në ditë kjo çështje po bëhet shumë shqetësuese kurse organet përgjegjëse qoftë lokale qoftë qendrore nuk po ofrojnë një zgjidhje efikase. Qytetarët me të drejtë ankohen sepse këta qen endacak i pengojnë ose janë kërcënim për ta sapo dalin nga shtëpitë e tyre. Ka edhe njerëz të atillë që fajin ua hedhin vetëm qenëve endacak kurse ata të shkretët bredhin rrugëve nëpër vapë, shi dhe të ftoftë, pa ushqim, të ndjekur, të rrahur e të semurë dhe pa një përkujdesje dhe mbrojtje dinjitoze, krejt kjo për arsye se njerëzit janë të pa përgjegjshëm ndaj tyre. Shumë nga këta njerëz kanë dëshirë të ken një qen por shumë prej tyre, pas një kohe mërziten nga ta, për arsye se ata dojnë një kujdes dhe ushqim i cili kushton, kështu që vendosin ti lënë në rrugë. Dhe kështu ndodh çdo vit kurse çdo ditë e më shumë rrugët i kemi përplot qen endacak të moshave dhe racave të ndryshme, duke çaluar, të rrahur, të sëmurë dhe të uritur por që janë një rrezik shumë i madh për qytetarët.

Krijimi i mekanizmit adekuat per menaxhimin e ketij rreziku

Është e domosdoshme që organet përgjegjëse së bashku me grupet ose shoqatat për mbrojtjen e kafshëve të krijojnë një mekanizëm i cili do të mundësonte që njerëzit të cilët dëshirojnë të mbajnë një qen ose kafshë tjetër, të obligohen ligjërisht që të kujdesen për të. Po ashtu është e nevojshme që të sanksionohet përgjegjësia penale dhe materiale që këta njerëz të jenë pronar të ndergjegjëshëm të këtyre kafshëve. Vetëm në këtë mënyrë mund të identifikohen pronarët e këtyre kafshëve, te cilët nuk do të kishin mundësinë që aq lehtë ti hudhnin në rrugë.

Fillimisht, duhet që qentë endacak të kapen dhe të vendosen në strehimore që do të ngriten enkas për ta. Pastaj ata duhet të shërohen sepse shumë prej tyre janë të sëmurë dhe si të tillë janë burim potencial i sëmundjeve dhe epidemive. Në vazhdim ata duhet të regjistrohen, ti jepen dikujt qe është i interesuar të marr një qen , kurse ata që mbetën në strehimore. patjetër duhet të sterilizohen ose të vehen në gjumë..

Deri tash shoqatat për nbrojtjen e kafshëve janë kujdesur kryesisht vetëm për kafshët e sëmura sepse për këtë qëllim, nganjëherë marrin donacione ndërkombëtare por këto shoqata fare nuk janë të interesuara për qentë endacak sepse nga këta nuk kanë kurrfarë përfitimi.

Sidoqoftë, niveli lokal dhe shoqatat për mbrojtjen e kafshëve duhet që seriozisht të ndryshojnë mënyrën e menaxhimit të rrezikut nga qentë endacak, për të gjetur një zgjidhje konkrete dhe mjete që këto kafshë të përfitojnë kujdesin e duhur dhe që tu pamundësohet atyre që te frikësojnë, lëndojnë apo të marrin jetë njerëzish.

gazetaexpress.com/.. 20 dhjetor 2014

Menaxhimi i refugjatëve, sfida e radhës për Kosovën

Një fatkeqësi, një tërmet, një vërshim, një cunami, një luftë civile apo konflikt regjional, dhe një thyerje e paqes mund të bëjnë që për një kohë shumë të shkurtër shumë njerëz të mbesin pa shtëpi dhe të kenë nevojë për ndihmë dhe siguri. Para se gjithash nëse kemi të bëjmë me një katastrofë natyrore, atëherë ajo ndikon që shumë njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre, pastaj shpërthimet e konflikteve të ndryshme të cilat rezultojnë me një fluks të madh të refugjatëve ose katastrofa tjera të cilat mund të ndodhin kudo dhe kurdo dhe mund të shkaktojnë pasoja të pa parashikueshme për evakuim dhe strehim. Për ata të cilët kanë humbur prona (psh : shtëpi, banesa etj.), apo kanë kaluar nëpër ngjarje traumatike dhe për fat të keq janë të lënë jashtë, në njëfarë mënyre nga mbrojtja dhe kujdesi ndaj tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë, atëherë kampi ofron një vend të sigurt, ku ata marrin ndihmë mjekësore, ushqim, strehim dhe mbrojtje. Kampet për strehim nuk ofrojnë një zgjidhje të përhershme, por nëse ato janë të menaxhuara mirë, ashtu siç duhet atëherë ato mund sigurojnë një vend të përkohshëm i cili ofron ndihmë për shpëtimin e jetës nga fatkeqësitë.

Sot Ballkanin dhe Evropën e ka kapluar një fluks i madh i refugjatëve por refugjatët dhe menaxhimi i tyre nuk janë një dukuri e re për botën. Ky numër i madh i te ikurve që po vijnë nga Lindja e mesme, po menaxhohen në mënyrën më të keqe të mundshme nga shtetet ballkanike në përgjithësi dhe nga disa shtete tjera si Hungaria, Rumania etj. Ligjet ndërkombëtare për refugjatët na obligojnë që menaxhimi i situatave të tilla është një çështje e ndishme, humane dhe e garantuar ndërkombëtarisht. Është e papranueshme dhe jashtë çdo norme njerëzore që refugjatët të priten në pika hyrëse kufitare me ushtri dhe me polici. Të tmerrohen dhe frikësohen gratë, pleqtë, fëmijët me armë dhe me lotsjellës, duke i rrahur dhe maltretuar ata, është e dënueshme dhe jo humane, njëkohësisht është shkelje e të gjitha normave ndërkombëtare. Shembuj të tillë të pritjes së refugjatëve kemi parë në Greqi, në Maqedoni, në Kroaci dhe në Hungari. Është e kuptueshme se për çdo shtet sidomos për shtetet me ekonomi

dhe qeverisje të dobët ose për shtetet në tranzicion qe menaxhimi i refugjatëve është një sfidë tepër e madhe, shpesh e pakalueshme dhe kur kësaj kur i shtojmë edhe ksenofobinë fetare të këtyre shteteve ndaj refugjatëve me përkatësi fetare islame, shohim se menaxhimi dhe sjellja ndaj tyre ka rrëshqitur drejt një shkelje masive të drejtave elementare humane.

Kosova dhe refugjatët

Kohëve të fundit jemi dëshmitarë se shumica e shteteve Evropiane dhe Ballkanike janë duke i mbyllur kufijtë për të minimizuar numrin e refugjatëve. Kjo mbyllje sipas të gjitha parashikimeve do të detyrojë refugjatët që të ndërrojnë itinerarin e udhëtimit dhe cak i tyre tani mund të jetë Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi. Kur kësaj ja shtojmë edhe informacionet se në Bruksel para disa muajsh ishte bërë një lloj ndarje e këtyre refugjatëve sipas numrit dhe vendeve se sa secili vend mund të pranonte dhe se Kosova kishte garantuar se mund të përballonte një numër prej 5000 refugjatësh, shtrohet pyetja se sa është Kosova e përgatitur për menaxhimin e kësaj situate. Me një gjendje të tillë ekonomike, sociale, me një krizë politike parlamentare dhe kur mekanizmat e mbrojtjes shpëtimit dhe ndihmës, sigurisë, rezervave shtetërore dhe mekanizma tjerë ende të pa konsoliduar mirë, sidomos për ngjarje të tilla që kërkojnë një menaxhim shumë dimensional dhe shumë institucional, Republika e Kosovës do të sfidohet me menaxhimin e kësaj situatë, veçanërisht nëse refugjatët do të qëndrojnë një kohë të gjatë në vendin tonë. Republika e Kosovës në aspektin ligjor dhe dokumenteve bazike për menaxhimin e emergjencave, ka një sistem të Integruar të Menaxhimit Emergjent dhe një Plan të Reagimit Kombëtar. Ky plan është Plan Operativ i cili i shërben Qeverisë së Republikës së Kosovës për të menaxhuar çdo fatkeqësi pa marr parasysh madhësinë, kompleksitetin dhe juridiksionin. Planifikuesit e hartimit të planit kontingjent për menaxhimin e refugjatëve në nivel vendi, para se të hartojnë këtë plan, duhet të kuptojnë saktë termet refugjat dhe emigrant dhe qasjen që duhet pas ndaj secilit grup, sepse obligimet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe detyrat dhe përgjegjësitë shtetërore për menaxhimin e tyre nuk janë të njëjta për këto dy kategori.

Së pari, çka është një refugjat? - Një refugjat është një person i cili në vendin e tij / saj të origjinës i kanë mbetur çështje të pazgjidhura personale dhe që ju ka ndërprerë ose shtyrë edukimi. Ky është një person i cili është i traumatizuar nga fakti se ai duhej të ikte dhe se për këtë arsye ndjen një humbje të madhe. Ai është personi për keqardhje, një person i cili është i hutuar nga ardhja në një vend plotësisht të huaj, në një mjedis krejtësisht të ndryshëm dhe të panjohur kurse fëmijët refugjatë janë shpesh pa prindër ose kujdestarë.

Emigranti- Një emigrant është një person i cili ka qenë i përgatitur për udhëtim dhe për këtë arsye e ka më të lehtë përshtatjen me situatën e re e i cili ndërkohë edhe mund të kthehet atje nga ka ardhur. Me fjalë të tjera, kjo është zgjedhja e tij personale. Shpesh e gjithë familja është në rrugë dhe kryesisht të gjitha nevojat e tyre themelore janë të mbuluara paraprakisht.
Dhe ka nga ata që nuk janë as këtu, as atje dhe ku shumë prej faktorëve të mësipërm u p**ë**rzihen. Ata janë njerëz të cilët kanë lënë familjen (e cila shpesh u dërgon para dhe shumë njerëz mund ti shohin në bankat dhe zyrat e postës), miqtë dhe gjërat e njohura, dhe të cilët janë të ballafaquar me një kulturë të ndryshme, klimë dhe gjuhë tjeter e cila është arsyeja pse ata kanë nevojë për mbështetje. Siç po e shohim sot, në mesin e njerëzve të cilët aktualisht dynden në Ballkan dhe në Bashkimin Evropian ka dhe refugjatë edhe emigrantë dhe tjerë që janë diku në mes.
Sidoqoftë, një gjë duhet ta dimë dhe ta kemi të qartë se kampet ngritën për t'i siguruar të drejtat elementare humane të komuniteteve të zhvendosura për një jetë të dinjitetshme. Praktika më e mirë e menaxhimit të kampeve bazohet në të kuptuarit se, të gjitha aktivitetet e kampit duhet të ndërmerren për realizimin e qëllimit, i cili është "sigurimi i popullatës së kampit nga trajtimet abuzive apo degraduese dhe ruajtjen e të drejtave të tyre, duke i përfshirë të drejtat për ushqyerje, strehim, kujdes shëndetësor dhe bashkim familjar.

Zëri , 25 NËNTOR 2015

Marrëveshjet antikushtetuese dhe gjendja e sigurisë

Kjo situatë politike parlamentare që po mbretëron në Kosovë thuaja gjysmë viti, gjendje e cila ka tendencë që të shndërrohet në një krizë politike, sociale, etnike e që mund të rrezikojë jo vetëm Kosovën, e përcjelle me protesta dhe demonstrata jo vetëm paqësore dhe tani më jo vetëm për dy marrëveshjet por edhe si pasojë e një krize morale dhe sociale, si dhe të mosbesimit ndaj qeverisë dhe klasës politike, e shpërfaqur nga një klimë injoruese e koalicionit qeverisës ndaj opozitës, shoqërisë civile, qytetarëve, klimë që shkon deri në skajshmërinë e mospërfilljes, mund të destabilizojë vendin dhe shoqërinë duke i shtrirë pasojat edhe në pjesët tjera të Kosovës siç është veriu, komunat (enklavat) serbe në brendësi të Kosovës si dhe në jugun e Kosovës ku kemi një minoritet gorar (më shumë se dhjetë fshatra të Gores), të cilët ende edhe sot nuk e pranojnë shtetin e Kosovës.

Cilat janë kërcënimet për sigurinë e vendit:

1. Mundësia për të ndodh një konflikt brenda shqiptar si shkak i kundërshtimeve pozitë opozitë është i vogël sepse për fat të mirë një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve edhe të atyre që janë anëtarë të partive në pozitë e kanë kuptuar se dy marrëveshjet janë antikushtetuese dhe se qeverisja jo vetëm kjo e sotmja por edhe ato të mëparshmet ishin të interesuara vetëm për interesa personale dhe fitimprurëse dhe për asgjë tjetër.
2. Si pasojë e marrëveshjeve për koalicion me listën serbska të cilës dy partitë në pushtet LDK-PDK i kishin premtuar dhe bërë shumë koncesione si, pozita udhëheqëse në polici, AKI, dhe në të gjitha agjencitë ekzekutive, tani në këtë gjendje kur partnerët e koalicionit kanë hallin e vet dhe nuk mund të përmbushin premtimet e dhëna mund të ndodh një përshkallëzim i situatës në veri por tani në emër të shtetit të Kosovës dhe me emblemën e këtij shteti sepse strukturat paralele dhe paramilitare kjo qeveri i ka veshur me petkun e qeverisë së Republikës së Kosovës duke i inkuadruar

në institucionet qeveritare, kështu që tani Kosova mund ta pres bumerangun fatal nga të punësuarit e vet të rinj.

3. Pasi që gjykata kushtetuese shpalli marrëveshjen për zajednicën si shkelëse të frymës së kushtetutës dhe dha verdiktin që zajednica mos të jetë më zajednicë por një OJQ e zakonshme, serbët absolutisht, sidomos Beogradi zyrtar nuk do të pajtohen me këtë verdikt sepse tek e fundit për një OJQ- nuk ka pas nevojë të shkohet në Bruksel për të negociuar, atë (OJQ-në) mund ta regjistrosh edhe në komunën më të afërte, kështu që, ata (serbët) mund të ndërtojnë skenarë që do të kërcënojnë sigurinë jo vetëm në veri por në tërë Kosovën.
4. Dhe kërcënimi më serioz për Republikën janë autoritetet ose qeveria e koalicionit PDK-LDK të cilët me kokëfortësinë, injorancën, tëhuajsimin nga jeta reale e qytetarëve dhe nga kërkesat e drejta të opozitës, në vend se ta menaxhojnë këtë krizë shpejt dhe në mënyrën e duhur ata po e zvarrisin zgjidhjen e krizës me shpresë se qytetarët e Kosovës do ta harrojnë krimin e tyre, duke shpërqendruar vëmendjen tek çështjet margjinale e që në momentin e fundit të pranojnë kompromisin duke menduar se tradhtia dhe përgjegjësia e tyre do të zbehen.
5. Jo rrallë në historinë botërore sigurinë nacionale e rrezikojnë qeveritë e vendeve të tyre. Në kushtetutën e Kosovës Neni 2 (Sovraniteti) shkruan kështu: 1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute;

   2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
6. Sipas Nenit 131 (Gjendja e Jashtëzakonshme), ku tregohen arsyet dhe shkaqet kur presidenti mund të shpall gjendjen e jashtëzakonshme dhe natyrisht sipas këtij neni i cili thotë se: Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur:

(1) Ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;

(2) Ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;

(3) Ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.

Pra në pajtim me këtë kushtetutë sipas pikës tre (3), kur gjykata kushtetuese shpalli verdiktin se marrëveshja për zajednicën shkeli frymën dhe parimet e kushtetutës është dashtë të merren dy veprime:

- Të anulohet marrëveshja nga kuvendi sepse kuvendi e kishte miratuar ligjin dhe ligji do të duhej të tërhiqej apo të ndryshohej (Neni 18 pika 4, Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare) dhe
- Nëse qeveria nuk do dorëhiqej (siç nuk u tërhoq) dhe nuk e merr përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, të shpallej gjendje e jashtëzakonshme sepse ishte rrezikuar sistemi i brendshëm i rendit kushtetues të Republikës dhe nënshkruesit e marrëveshjes që cenoi rendin kushtetues të jepte llogari sipas kushtetutës.

Pra rreziku dhe kërcënimi më i madh sigurisë për Republikën e Kosovës tani e tutje është qeverisja, mohuese, eliminuese, autokrate dhe ekstremiste e cila nuk po i jep udhë zgjidhjes së problemeve të cilat i ka krijuar vetë me apo pa qëllim.

Janar 2016

Kosova përball anarkisë, radikalizmit dhe ekstremizmit

Anarkia ose Anarkizmi rrjedh nga fjalët greke “an” që don të thotë kundër dhe “archos” që nënkupton autoritetin / pushtetin. Me fjalë të tjera, anarkia, gjegjësisht “an-archos” do të thotë kundër autoritetit / pushtetit, ose, më lirshëm, pa autoritet. Sikurse edhe nga përkthimi, mund të shihni se kjo nuk ka të bëjë me kaosin. Përveç në qoftë se mungesën e autoritetit e konsiderojmë si kusht të origjinës së kaosit, ose në qoftë se shoqërinë e paramendoni si mundësi të vetme nën syrin vigjilent të një ose më shumë autoriteteve. Ka gjasa që bindja politike mbi të cilën mbështetet shpesh opozita ose konkretisht LVV si në aspektin programatik po ashtu edhe në ate të veprimit, është Libertarianizmi

(latinisht: Liber, "i/të lirë") i cili është një filozofi politike që mbështet lirinë si objektivin e tij kryesor. Libertarianët kërkojnë maksimizimin e autonomisë dhe lirisë së zgjedhjes, duke theksuar lirinë politike, shoqatat vullnetare, dhe përparësinë e gjykimit individual. Idhtarët e mendimit të lirë, mendimit opinionist dhe atij politik në debatet dhe diskutimet në mediat tona, të cilët mendojnë se anarkizmi është socializëm etatist ose komunizëm dhe se Lëvizja VV po dëshiron revolucion klasik, e kanë gabim sepse koncepti i sistemit politik dhe ekonomik libertarian, përfaqëson mirë përkufizimin e tij, i cili thotë se “socializmi libertarian është sistem social i cili beson në lirinë e veprimit, mendimit dhe vullnetit të lirë të individëve, në të cilin prodhuesit posedojnë edhe fuqinë politike edhe mjetet e prodhimit dhe shpërndarjen e mallrave". Sidoqoftë, kur jemi te anarkizmi, për te vlejnë tri parime thelbësore që nevojiten për të krijuar një shoqëri të vërtetë të lirë dhe ato janë: liria, barazia dhe solidariteti, të cilat janë reciprokisht të pandashme. Kohëve të fundit por edhe me herët me të drejtë e pa të drejtë aksionet dhe veprimet e lëvizjes vetvendosje janë quajtur anarkiste, radikaliste, fanatike, ekstremiste, etj.. biles ka edhe deputetë që për fatin e keq tonin, nga mosnjohja apo varfëria e tyre politike dhe intelektuale, këto veprime i quanin edhe monarkiste! Por, me të drejtë shtrohet pyetja se çka është dhe si manifestohet anarkizmi, radikalizmi fanatizmi dhe ekstremizmi dhe **pse Anarkistët janë kundër autoriteteve dhe hierarkive?** Sipas tyre “Marrëdhëniet autoritare sociale nënkuptojnë ndarjen e shoqërisë në (pakica) urdhërdhënësit dhe (shumica) urdhërmarrësit, duke varfëruar individët e përfshirë (ata mendërisht, emocionalisht dhe fizikisht) dhe shoqërinë në tërësi. Marrëdhëniet njerëzore në të gjitha segmentet, të frenuara nga autoriteti dhe duke pas parasysh se vetëm liria mund të krijojë lirinë, bien ndesh me marrëdhëniet autoritare sociale (bindja që ata kërkojnë) të cilat nuk mund dhe nuk edukojnë një person për lirinë. Po ashtu sipas tyre vetëm pjesëmarrja (vetë-qeverisja) në të gjitha aspektet e jetës mund ta bëjë këtë.

Radikalizmi - (radikal-i), në shkencat politike është emërtim për drejtimin e rishiqimeve kritike dhe ndryshimin rrënjësor të sistemit politik dhe shoqëror

ekzistues. Po ashtu në politikë kupton një pozitë të qëndrueshme, shpesh ekskluzive që kërkon përdorimin e metodave të përcaktuara në mbrojtjen e ideve të caktuara politike. Radikalizmin mund ta shpjegojmë në dy mënyra:

1. Si kthim tek rrënjët në kuptimin e kthimit tek e vjetra e cila zakonisht është e karakterit retrogard;
2. Si ripërtëritje që mund të implikojë një risi (novum) të caktuar.

Duhet ta kemi parasysh se nëse diqka është radikale nuk duhet apriori ta gjykojmë si regresive por në të kundërtën mund të ketë një rëndësi progresive. Në këtë kontekst, ne vëmë re se në kontrast me ekstremizmin që është gjithmonë me karakter negativ, radikalizmi mund të ketë një kuptim pozitiv. Le të themi, për shembull ndryshimet radikale që kanë sjellë rezultate shumë pozitive në shoqëri duke dhënë të drejtën e votës për gratë, apo procesi i dekolonizimit. Pavarësisht asaj se ndryshimet radikale mund të kenë një konotacion pozitiv, këto ndryshime njësoj destabilizojnë shoqërinë, madje edhe për një periudhë të shkurtër kohore, derisa shoqëria nuk konsolidohet.

Ekstremizmi

Ekziston bindja se në shkencat politike ka disa probleme të mëdha në shpjegimet teorike për ekstremizmin. Së pari duhet marrë parasysh se ky është një fenomen që nuk është thjesht i karakterit politik, por në mënyrë të barabartë mund të ndodhë në sfera të ndryshme të shoqërisë. Ekstremizmin e gjejmë në kulturë, sport, arte, fe, por destruktiviteti i tij është më i shquar në politikë. Nga të gjitha llojet e ekstremizmit, më i rrezikshmi është ai në politikë, sepse mund të rezultojë me pasoja të rënda për shoqërinë. Për tia përshkruar natyrën politike ekstremizmt, ai duhet të plotësojë dy kushte: duhet të ketë motiv politik dhe pasoja politike. Ekstremizmi politik gjithmonë “ndodh" me qëllim politik dhe ekziston në fushën politike. Nëse nuk ka motivim politik apo objektiva politike, nuk mund të flasim për ekstremizëm politik. Ekstremizmi politik gjithmonë pasqyron luftën kundër një politike apo politike të dikujt, pushtetit politik dhe përpjekjen e krijimit të pushtetit vetanak, ose pasqyron luftën për ruajtjen e një

regjimi në pushtet. Mosdallimi i ekstremizmit nga fenomenet tjera të ngjashme si: radikalizmi, fundamentalizmi, fanatizmi dhe ekstremizmi/terrorizmi është një tjetër pengesë në përkufizimin e tij konceptual.

Përkufizimi i definicionit të ekstremizmit politik

Duke studiuar ekstremizmin, është ardhë në përfundim se në fushën e teorisë politike ka vetëm një numër të vogël të përkufizimeve për ekstremizmin. Përveç kësaj, një numër edhe më i vogël i tyre (përkufizimeve) posedon vlefshmërinë shkencore dhe objektivitetin e hulumtimit. Ne nuk duhet të harrojmë se ekstremistët shpesh quhen si kundërshtarë politikë me tendencën e eliminimit dhe diskualifikimin e tyre nga mjedisi shoqëror-politik, e cila gjë mjegullon fytyrën e vërtetë të ekstremizmit. Kurse sa i përket ekstremizmit shtetëror, Skruton (Roger Scruton) beson se ekstremizmi përcaktohet nga elementet e mëposhtme: "Dëshira për skajshmëri ideore politike me një tendencë për eliminimin e opozitës, intoleranca ndaj alternativave tjera politike, përdorimi i fondeve politike të cilat nuk respektojnë jetën, lirinë dhe të drejtat e njeriut të pjesëtarëve tjerë të komunitetit". Sidoqoftë Ekstremizmi në politikë mund të ndodhë në tri versione tipike:

1. Kur qëllimet jo ekstreme arrihen me forma ekstreme;
2. Kur qëllimet ekstreme arrihen me forma jo-ekstreme;
3. Kur qëllimet ekstreme arrihen me forma ekstreme;

Fundamentalizmi

Fundamentalizmi (Lat. Fundamentum - bazë) është një mënyrë e të menduarit në të cilën disa parime janë konsideruar thelbësore për të vërtetën, se pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre, ato janë autoriteti i pandryshueshëm dhe i padiskutueshëm. Sa i përket fundamentalizmit, ai ndonjëherë mund të ngjaj në ekstremizëm sepse një fenomen zakonisht është i shoqëruar me tjetrin, por këto dy kategori nuk mund të konsiderohen sinonime. Fundamentalizmi është i lidhur kryesisht me fenë dhe ka tendencë për të qenë në kornizat e disa mësimeve

fetare që do të ndikojnë në kthimin në parimet bazë të asaj feje. Problemi me fundamentalizmin në shoqërinë moderne është fakti se feja u shfaq shumë kohë më parë duke koresponduar me kushtet përkatëse të atëhershme të jetës, të cilat në fund të fundit, kanë reflektuar mbi parimet themelore fetare, por që në shoqërinë bashkëkohore shpesh nuk janë të zbatueshme. Fundamentalizmi dhe ekstremizmi janë të ndërthurur veçanërisht në fushën e fesë për shkak të sistemit të vlerave të ngjashme, me të cilat nënkuptojnë zell të tepruar dhe përjashtim, intolerancë ndaj atyre që janë ndryshe, për mënyrën dogmatike të të menduarit dhe për një gatishmëri për të përdorur dhunën. Dallimi është fakti se fundamentalizmi është i lidhur kryesisht me fenë, ndërsa ekstremizmi është i pranishëm në fe, por edhe në sferat tjera të shoqërisë.

Fanatizmi

Kur është fjala për fanatizmin edhe ky është një term tjetër që shpesh është identifikuar me ekstremizmin, por besohet që është një krahasim i gabuar. Fanatizmi sikurse fundamentalizmi burimisht lidhet me fenë sepse fjala "Fanum" don të thotë tempull apo faltore. Sipas kësaj, fanatizmi përfaqëson zell të tepruar ndaj një religjioni, ideologjie, politike etj.. Pasi që abstraktja sipas Hegelit është veqori e njerëzve injorantë, këtu nuk është e vështirë për të gjetur një korrelacion midis fanatizmit, injorancës dhe dhunës. Pa marrë parasysh se injoranca është baza e së keqes, në mesin e fanatikëve ka njerëz të shkolluar që janë të gatshëm të angazhohen për ide specifike duke shkaktuar dhunë. Fanatizmi sikurse Ekstremizmi nuk është domosdoshmërisht vetëm një fenomen politik, por fanatizmi më shumë është i lidhur me fenë. Përveç kësaj, të dy fenomenet janë negative dhe të padëshirueshme në shoqëri, sepse ato destabilizojnë atë dhe nuk korrespondojnë me sistemin e vlerave demokratike. Duke i komentuar këto që shtruam më lartë, lind pyetja se cila është e drejta e një grupimi (individi) të caktuar në përzgjedhjen programatike politike sipas vullnetit, në një vend që pretendon të jetë i lirë dhe demokratik dhe sa dhe deri ku mund të denojmë, denigrojmë, injorojmë këtë të drejtë, ose në fakt, sa rrezikohet shtetësia dhe demokracia e re e një vendi nga këto bindje dhe veprime politike? Po ashtu

mund të diskutojmë se sa dhe deri ku mund të shkojë veprimi anarkist, radikal, fanatik, fundamentalist dhe ekstremist, pa i rrezikuar liritë individuale, apo grupore si një postulat i tyre? Këto janë çështje që duhet të shtrohen për diskutim dhe jo mohimi, përqeshja, akuzat infantile dhe shpërfillja deri në skajshmëri jo vetëm ndaj një grupimi politik. Pastaj duke analizuar në rrafshin konkret marrëveshjet jo parimore mes individëve, grupimeve ose partive politike, marrëveshjet ndërshtetërore, këto edhe mund të shërbejnë për të mirë nëse kanë për qëllim shtyrjen përpara të proceseve të mëdha nacionale ose jetike për shumicën e qytetarëve të një vendi, por duhet pas parasysh se "besëlidhjet" jo parimore shpesh mund të sjellin konfrontime të mëdha brenda shoqërisë të cilat edhe mund të dalin jashtë kufijve nacionalë por që këto konfrontime domosdoshmërisht nuk janë gjithmonë të gabuara dhe të dëmshme dhe të cilat pavarësisht kundërshtive, konflikteve dhe dhunës politike të përdorur, shpesh si mjet legjitim për arritjen e një rezultati, gjithmonë ose në të shumtën e rasteve janë produktive, emancipuese, ngrisin vetëdijen politike qytetare dhe të grupimeve politike ose thënë shkurt sjellin zhvillim dhe prosperitet të gjithmbarshëm të një vendi. Këto dukuri të shfaqura në masë mesatare në shoqërinë tonë, në politikë, në fe dhe fushat tjera, kërkojnë një debat të gjërë dhe të gjatë shoqëror, politik, shkencor, intelektual dhe multi diciplinar, i cili debat mund të shërbejë si njohje me këto dukuri dhe si masë parandaluese për zhvillimin e hovshëm të tyre. Zbatimi i metodave të dhunshme nga mekanizmat e sigurisë si dhe masat detyruese ligjore nga mekanizmat e drejtësisë kundër kundërshtarëve dhe bindjeve politike dhe ideore, nuk mund të parandalojnë këto dukuri, vetëm se mund të bëjë që dëmi i shkaktuar nga këto masa, do të zgjas kohën e rimëkëmbjes së shoqërisë si dhe mund të krijojë precedent për hakmarrje politike në të ardhmen.

29.12. 2015

Shërbimet sekrete Serbo - Ruse aktivizohen vrullshëm në Kosovë

Deklaratat e fundit në unison të zyrtarëve serb, gjoja për rrezikun që u kanoset qytetarëve serb në Kosovë nga fundamentalizmi dhe ekstremizmi fetar, nuk janë

të pa qëllimshme dhe nuk sjellin ogur të mirë sa i përket gjendjes së sigurisë në Republikën e Kosovës, kurse veprimet e shërbimeve jo vetëm serbe në Kosovë dhe rreth saj, që do të pasojnë në muajt në vijim, mund të jen të dhembshme dhe të pa riparueshme për Kosovën, çoftë në aspektin politik, ekonomik dhe diplomatik ose me pasoja dhe dëme me humbje të jetës së njerëzve, të mirave material apo në infrastrukturë kritike (ushqim, ujë të pijshëm, energji etj..)

Situata e rënduar politike dhe parlamentare në Republikën e Kosovës ka gjasa të mëdha të shfrytëzohet për skenarë terroristë me pasoja të rënda, me qëllimin e vetëm, të synuar kamotshëm nga qeveria e Serbisë dhe strukturave paralele të Jakshiqëve, të cilët vazhdimisht kanë trumbetuar se Kosova nuk është e zonja të qeverisë vetveten, prandaj ata përmes aksioneve te kombinuara të shërbimeve sekrete, duan të kompromet ojnë jo vetëm qeverisjen aktuale të Kosovës por edhe tërë këto pesëmbëdhjetë vite sakrifice nga vendorët dhe nga bashkësia ndërkombëtare, për ndërtimin e imazhit shtet ndërtues demokratik të Kosovës.

Serbia me çdo kusht do ta shfrytëzojë gjendjen aktuale politike në Kosovë të cilën e karakterizon një mos unitet veprimesh i liderëve institucional dhe atyre politik, konfrontimi i skajshëm pozitë opozitë, gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale, barikadimi i opozitës në qëndrimet e veta, ekskursionet e presidentes nëpër komunat e Kosovës (ne vend se të angazhohet për unitet dhe tejkalim të krizës), bisedimet me çdo kusht dhe pa kushte me Beogradin si dhe agjendat personale të liderëve institucional. Gjithashtu është i dhembshëm dhe tragjik fakti i vërshimit të portaleve dhe mediave të shkruara me akuza dhe kundër akuza të tmerrshme dhe të llahtarshme në mes njerëzve që janë së bashku në qeverisje ose atyre që ishin së bashku në veprimtari dhe aktivitete kombëtare, që nga vitet70-80 e deri tash, e që të gjitha këto për qytetarët e zakonshëm janë një shembull jo i mirë dhe i dëmshëm se si liderët institucional dhe politik po dërgojnë mesazhe përçarjeje dhe armiqësie tek qytetarët dhe se si ata nuk kanë dhe nuk mund të hartojnë një agjendë të përbashkët politike, përkundër nevojës imediate të vendit për diqka të tillë.

Shërbimet sekrete serbo-ruse dhe qeveria e Serbisë

Deklaratat e Marko Gjuriqit para dhe gjatë bisedimeve të fundit në Bruksel, se Serbia duhet të shfrytëzojë momentumin e ri në Kosovë për forcimin e ndikimit të saj, u përsëriten dhe vërtetuan edhe nga Intervista e kriminelit të luftës kundër shqiptarëve, Oliver Ivanoviq i cili edhe pse u dënua, shkoi në shtëpi gjoja pas një gabimi në përkthim në verdiktin e gjykatës. Kësi aktesh qesharake ndodhin vetëm në drejtësinë e ndërkombëtare bilës nga ata që e kanë mandatin e Evropës për këtë drejtësi që erdhën pikërisht për të na mësuar se si bëhet drejtësia. Mësimi "më i mirë "qe na e dha drejtësia ndërkombëtare ishte ky me Ivanoviqin. Akti që ndodhi në Deçan e që për fat të keq nuk u ndriçua ende mjaftueshëm nga policia, po tentohet të keq interpretohet nga kisha serbe, pastaj votimi i rezolutës për Kosovën në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ku kërkohet që në Kosovë në segmente të caktuara të sigurisë të riaktivizohet dhe instalohet UNMIK-u si bartës i vendimmarrjes dhe bashkëpunimit me Organizmat ndërkombëtar të sigurisë si Interpol dhe Evropol, në vend të strukturave vendore, janë vazhdimësi e orkestruar dhe e qëllimshme e shërbimeve serbo sllave dhe shërbimeve tjera. Po të njëjtin avaz nga Etiopia e përsëriti edhe Kryetari serb Nikoliq i cili deklaroi nga largësia se Kosova është krijuar nga Ithtarët e ISIS-it dhe sipas këtij modeli.

Një zyrtar tjetër i Serbisë (Drecun) ka deklaruar së fundmi se "incidenti te Manastiri i Deçanit ka treguar se në atë territor (Kosovë) është krijuar baza e fuqishme e islamizmit radikal dhe se shteti (serb!) do të bëjë çmos për të penguar çfarëdo kryerje të aksioneve terroriste". Prandaj, Serbia jo vetëm që ka përcjell, po përcjell por edhe në periudhën e ardhshme do të përcjell situatën dhe mbrojë serbët nga aktet e ndryshme kundër tyre deklaron ai. Kjo deklaratë tregon dhe pranon haptas, pa ngurrim dhe frikë se Serbia, Rusia dhe shërbimet e tyre, janë dhe do të jenë në kulmin e aktiviteteve destruktive në Republikën e Kosovës dhe se nuk njohin, nuk përfillin dhe as nuk dëshirojnë bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës dhe mekanizmat e sigurisë për mbrojtjen e "serbëve të rrezikuar" sipas tyre.

Deklaratat e fundit në unison të zyrtarëve serb, gjoja për rrezikun që u kanoset serbëve në Kosovë, nuk janë të pa qëllimshme dhe nuk sjellin ogur të mirë sa i përket gjendjes së sigurisë në Republikën e Kosovës, kurse veprimet e shërbimeve sekrete jo vetëm serbe në Kosovë dhe rreth saj, që do të pasojnë në muajt në vijim, mund të jenë të dhembshme dhe të pa riparueshme për Kosovën, çoftë në aspektin politik, ekonomik dhe diplomatik ose me pasoja dhe dëme të mëdha në humbje të jetës së njerëzve, të mirave materiale apo në infrastrukturë kritike (ushqim, ujë të pijshëm, energji etj.).

Agjenda e përbashkët politike

Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet e sigurisë, mekanizmat e sigurisë, partitë politike, shoqëria civile dhe qytetarët duhet të kenë kujdes dhe të jenë të gatshëm që të hetojnë dhe parandalojnë këto veprime kundër Kosovës, kurse Kryeministri pas këtyre deklaratave të zyrtarëve të lartë serb, që janë shqetësuese për sigurinë e qytetarëve të Republikës dhe sigurinë nacionale, duhet të thërras Këshillin për Siguri të Kosovës dhe të rekomandojë masa shtesë për ngritjen e nivelit të vigjilencës dhe gatishmërisë për të gjitha strukturat e sigurisë në Republikën e Kosovës.

Në këtë gjendje çfarë është Kosova, sot si asnjëherë deri më tash, është e domosdoshme një agjendë e përbashkët politike, pozitë opozitë dhe e shoqërisë civile, për të menaxhuar me sukses situatat e jashtëzakonshme që do të ç faqen si pasojë e krizës politike dhe veprimeve destruktive të shërbimeve të huaja armiqësore gjatë këtij viti.

2016

Sa është i qëndrueshëm diskursi politik për krijimin së shpejti të Forcave të Armatosura

Republika e Kosovës ende nuk e ka forcën e vet ushtarake e cila forcë do të qetësonte relativisht e grupet dhe shtetet e ndryshme që lakmojnë territorin tonë dhe punojnë vazhdimisht kundër interesave shqiptare. Duke pas parasysh se

Kosova është shndërruar në një poligon provash të fuqive ndërkombëtare dhe të një pjese të vendorëve, si të atyre që mundohen (për të mirë), që përmes dyerve të vogla të na bëjnë pjesë të organizmave të mëdha ndërkombëtare, po ashtu edhe të atyre (për të keq), që mundohen jo vetëm të na i mbyllin dyert e vogla por edhe të gjitha hapësirat e mundshme, bilës edhe ato që janë shumë të hapura si qielli, për të mos frymuar as si njerëz e posaçërisht jo si shqiptarë. Sa i përket formimit të Ushtrisë së Kosovës apo Forcave të Armatosura, faktori vendimmarrës ndërkombëtar ka bërë shumë pak, kurse tani po vazhdon të nxehë si me rreze dielli dimëror, inkubatorin e quajtur FSK. Në fillim patëm TMK-në e transformuar nga ish UÇK-ja e cila u trajnua dhe u përgatitë thuaja se një dekadë për menaxhimin e Fatkeqësive në Republikën e Kosovës dhe, pavarësisht këtij trajnimi permanent, është me rëndësi të thuhet se asnjëherë (përjashto një ose dy raste të vogla), kjo nuk menaxhoi dhe as nuk reagoi në asnjë situatë fatkeqësie. Pra me një fjalë, faktori ndërkombëtar e preokupoi TMK-në skajshmërisht deri në lodhjen e saj. Dhe kur filloi të ndihej ajo lodhje në radhët e TMK-së edhe pse, ata djem dhe vajza, falë vullnetit të tyre dhe trajnimeve u ngritën mjaft në aspektin ushtarak, kur kjo ishte gatshme për operacionalizim të kapaciteteve, atë e shndërruan në FSK. Ky shndërrim ishte i vlefshëm vetëm sa i përket uniformave dhe përfitimit të rangjeve, përndryshe misioni ishte prapë i njëjtë, me një shtesë të dislokimit ndërkombëtar në ndihmë vendeve të goditura nga katastrofat natyrore. Me transformimin në FSK filloi edhe një vendnumërim sa i përket operacionalizimit dhe shndërrimit të kësaj Force në Ushtri të Kosovës. Ajo që është shumë e rëndësishme për të ditur, në mënyrë që të mos manipulohet politikisht me këtë çështje, është fakti se Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (RSSS) i përfunduar në fund të vitit 2014 nga DIRI, rekomandon që: Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës ti ketë tri faza**:**

Faza I (2014-2016) Zhvillimi i kornizës së nevojshme kushtetuese ligjore, institucionale dhe doktrinarë për forcë të re. Fokusimi do të jetë në plotësimin me personel, doktrinë, trajnime dhe infrastrukturë.

Faza II (2017- 2019) Theksi i veçantë të vihet në zhvillimin e kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; prokurimi i armatimit dhe pajisjeve esenciale; dhe krijimi i shkathtësive shtesë dhe i kapaciteteve operacionale.

Faza III (2020-2024) Kompletimi i rekrutimit të personelit, të trajnimeve dhe pajisjeve për forcën në përmbushje të misionit të saj të ri të mbrojtjes së vendit.

Për fat të keq asnjëri nga këto rekomandime dhe dhjetëra të tjerë nga ky rishikim, ende as nuk kanë filluar të zbatohen.

Tani shpesh herë për nevoja politike ditore, zyrtarë të lartë shtetërorë dalin me pohimin se së shpejti kjo forcë do të shndërrohet në ushtri. Por pse nuk do të ndodhë së shpejti kjo? E para sepse ka një agjendë ndërkombëtare që e shtjelluam me lartë dhe e dyta sepse kjo është një çështje tërësisht politike, diplomatike (e sigurisë) ndërkombëtare. Evropa dhe Amerika për këtë çështje janë duke joshur serbët për gjoja ndonjë kompromis të mundshëm kurse vendorët të bindur blanko se gjithçka është duke shkuar "ok", po bëjnë dhe mund të bëjnë edhe më shumë kompromise se sa vetë serbët. Thjesht mos formimi i ushtrisë së Kosovës është çështje e "mos nxitjes së revoltës së serbëve të Kosovës dhe Beogradit". Sidoqoftë këto fakte nuk i shfajësojnë deputetët shqiptarë në kuvend, grupin parlamentar për siguri, institucionet përgjegjëse për fushën e sigurisë, partitë politike, dhe shoqërinë civile pse nuk e ngritën asnjëherë zërin dhe pse asnjëherë nuk ishin pro aktiv për të kërkuar në kuvend bërjen e Ushtrisë së Kosovës, si element qenësor dhe jetik jo vetëm për sigurinë e jashtme.

Por çka duhet të bërë për të lëvizur këtë çështje nga amullia dhe pritja? Është e domosdoshme Shtruarja e menjëhershme e kërkesës për formimin e ushtrisë në Kuvend dhe caktimi i grupeve të ekspertëve për hartimin e doktrinës së ushtrisë së Kosovës, ku do të analizoheshin me kujdes ushtritë rajonale sidomos ato të vendeve që kufizohen me ne ose duke analizuar doktrinat e forcave të armatosura në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi, pastaj strukturimi, numri i personelit, pajisjeve dhe mjeteve, mënyra e rekrutimit dhe shërbimit. Pra në bazë të këtyre të dhënave të caktohet edhe doktrina e Ushtrisë së Kosovës. Me doktrinë të Ushtrisë së Kosovës kuptohet e gjithë baza konceptuare, politike,

strategjike, operacionale, taktike, administrative dhe speciale, e cila normon dhe rregullon veprimtarinë e ushtrisë në të gjithë spektrin, që nga koha normale e paqes, ashtu dhe në kuadër të angazhimeve në kohë krize dhe lufte, si na planin kombëtar ashtu dhe atë ndërkombëtar. Ajo që është shumë e rëndësishme dhe vendimtare në formimin e ushtrisë sonë është përcaktimi i misionit i cili konsiston në: Mbrojtjen e integritetit, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës.

2016.

Gracka e fundosjes së shtetësisë së Kosovës në asociacion ose Gazivodë

Gjithë përpjekja politike, diplomatike dhe tendenca artificiale serbe për krijimin e një konflikti artificial të ngrirë në veri të Kosovës tash e gjashtembëdhjetë vite, tendencë e cila ishte manifestuar përmes vrasjeve të shqiptarëve, dhunës permanente, shpërnguljeve të dhunshme të, bojkotit të vazhdueshëm të shtetësisë së Kosovës dhe lojrave perfide serbe, sollën deri te akti final i ndarjes së “dhive dhe dhenve” thënë popullorqe.

Nuk e di se a janë të vetedijshëm udhëheqësit tanë shtetëror, kshilltarët e tyre, analistët, gazetarët dhe shoqëria civile se gracka që na e ka përgatitur Serbia do ta fundos përgjithmonë shtetësinë tonë.

Po cila është gracka?

Shumica e këtyre personazheve që i përmenda më lartë kur flasin për veriun mendojnë së çështjet kryesore në këto bisedime janë telekomi ose prefiksi për Kosovën dhe “parku i paqes”.

Serbia në mënyrë mjeshtërore ka paralizuar të drejtën tonë legjitime për sovranitet duke na mashtruar me prefiksin dhe “Parkun e Paqes” megjithëse hileja serbe qëndron në asociacionin e komunave, i cili mund ta fundos shtetësinë tonë në Ujman (Gazivode). Serbia thot se me asnjë çmim nuk do ta jep Gazivoden dhe me çdo kusht kërkon Asociacionin. Duhet ta dijnë të gjithë ata që janë të involvuar drejtpërsëdrejti se asgjë nuk mund të ndalojë njërin nga këto kushte, asociacionin apo Gazivodën.

Pse këto dy kërkesa janë në fakt një dhe është shumë vështirë për përfaqësuesit tanë të dalin nga kjo situatë?

E para, nëse serbët e nxjërrin një asociacion politik ekzekutiv, Ujmani do të jetë i tyre. Nëse nuk mund ta nxjerrin asociacionin do të kërkojnë së paku Ujmanin dhe natyrisht se në këto dy kërkesa ne nuk mund të fitojmë maksimalisht, ose thënë popullorqe kjo është hyp se të vrava zbrit se të vrava. Njërin nga këto dy kushte Kosova duhet ta pranojë dhe cilindo kusht që e pranon, në atë moment Kosova i ka humbur të dyja, shtrirjen e sovranitetit me asociacion e me të edhe Ujmanin ose do ta humb Ujmanin duke ua dhënë asociacionin e që asociacioni me kompetenca ekzekutive na e merr Ujmanin, pra në secilën zgjidhje i bie jo vetëm humbje e sovranitetit por edhe aneksim i një pjese të territorit të Republikës së Kosovës nga Serbia me vullnetin tonë.

Ndoshta neve na mjafton prefiksi sepse Kosovarët nuk mund ta paramendojnë mbijetesën pa telefoni dhe poashtu mund ta heqim barrikadën ushtarako-luftarake të quajtur “park i paqes” në shkëmbim të sovranitetit shtetëror.

Ndihmona o zot!

2016

Konspiracioni HAARP apo ndërtimi i autostradës e shkaktoi tragjedinë në Hasanbeg

HAARP është Program i Hulumtimit të aktivitetit të lartë frekuencor auroral **(**The High Frequency Active Auroral Research Program- HAARP), një program hulumtues jonosferik i financuar bashkërisht nga Forcat ajrore amerikane, Marinës amerikane, i Universitetit të Alaskës dhe hulumtimit te avancuar të Agjencisë së Mbrojtjes së Projekteve. HAARP-i shpesh herë është cak i sulmit të teoricienëve konspirativ, të cilët pretendojnë se ky program është në gjendje të modifikojë motin, paaftësojë satelitët dhe të ushtrojë kontrollin e mendjes mbi njerëzit dhe se ky program është duke u përdorur si një armë kundër terroristëve. Disa teoricienë fajësojnë programin se ka shkaktuar tërmete, thatësi, stuhi dhe përmbytje, pastaj sëmundje të tilla si sindromi i Luftës së Gjirit dhe sindromi i lodhjes kronike, rrëzimin e avionit TWA Flight 800 në vitin 1996,

dhe shkatërrimin e anijes kozmike Columbia në vitin 2003. Kur para dy vitesh shira dhe vërshime të mëdha patën goditur Serbinë, një pjesë të Bosnjës dhe një pjesë të Kroacisë duke shkaktuar humbje në jëtë njerëzish dhe dëme të mëdha materiale, disa medie dhe analistë serb për këtë fatkeqësi patën akuzuar programin dhe sistemin Amerikan HAARP të vendosur në Alaskë. Sipas tyre, Amerika me qëllim, përmes këtij programi, po krijonte fatkeqësi edhe në Ballkan e sidomos në Serbi si shenjë hakmarrjeje për përafrimin e Serbisë me Rusinë.
Pas vërshimeve të këtyre ditëve në Shkup, gjegjësisht në fshatin Hasanbeg ku jeton një përqindje e madhe e qytetarëve shqiptarë, një gazetar Maqedonas pro serb dhe pro rus, antishqiptar i përbetuar, përsëri akuzoi Amerikën dhe programin HAARP si shkaktar të kësaj fatkeqësie, gjoja për të kompromet uar udheheqësit shtetëror dhe klasën politike në Maqedoni si të pa aftë për të menaxhuar kriza. Por cili është në të vërtetë shkaku i kësaj fatkeqësie?
Për të shkuar në fshatin Hasanbeg duhet të futesh në autostradën që të qon në Kumanovë. Pas disa kilometrash, në anën ë djathtë të autostradës ishte dhe është edhe sot një liqe i vogël i cili kishte një sipërfaqe mesatare por që asnjëherë deri më tash nuk kishte dalë nga shtrati për të vërshuar fshatrat poshtë tij. Tani me ndërtimin e autostradës, sipërfaqja e liqenit është zvogëluar dukshëm dhe është prishur balanci i shtratit të tij. Shirat me stuhi që vazhduan për katër orë rresht javën e parë të gushtit, bënë që ky liqe të vërshojë si tërbuar (shto prrojet dhe ujrat nga malet e Karadakut), më një vëllim të paparë ujrash dhe me valën goditëse fillestare të ujit me një lartësi deri katër metra që në fshatin Hasanbeg arrinte deri në dy metra lartësi, duke marr jetëra njerëzish (deri tash 22 të konfirmuar) dhe duke shkatërruar çdo gjë para vetes. Dhe natyrshëm lind pyetja, a është ndërtimi i kësaj autostrade projekt konspirativ i qeverisë maqedonase dhe, çka do të ndodh tash e tutje me banorët shqiptarë të fshatit Hasabnbeg, pasi që tani më ky rrezik do të jetë i përhershëm për ta? A do të ndodh de popullimi (largimi) etnik shqiptar dhe ikja e tyre nga ky vend, siç kishte ndodhur pas tërmetit të Shkupit me 26 korik të vitit 1963? Pra cili është konspiracioni këtu, Programi Amerikan HAARP apo ndërtimi i qëllimshëm i autostradës mbi një shtrat liqeni? Se do të ndodh diqka e tillë u vërtetua edhe

nga vizita që i bëmë këtij fshati ku vërehej dukshëm një diskriminim etnik dhe politik ndaj banorëve shqiptarë nga shteti Maqedon edhe gjatë (keq) menaxhimit të kësaj fatkeqësie. Në fillim të vendbanimit, aty ku banorët janë kryesisht Maqedonas, kishte shumë njësi reaguese vendore, forca ushtarake, policore, auto ambulanca, vullnetarë të Kryqit të Kuq dhe njësi reaguese nga shtetet e ndryshme si Serbia, Bullgaria dhe Greqia me mjete dhe pajisje që po kryenin operacione intenzive për të rimëkëmbur komunitetin dhe infrastrukturën e goditur, kurse për habi në pjesën ku banojnë shiptarët, pamë vetëm një ekip nga Kosova (shumë të angazhuar) me pompa thithëse që largonin ujin nga oborret dhe shtëpitë e banimit, pamë vët vetiniciativën e qytetarëve shqiptarë, dhe pamë kompani private shqiptare nga Maqedonia që po punonin vullnetarisht dhe në mënyrë humanitare. Sa i përket vizitave të liderëve të partive politike shqiptare nga Maqedonia në Hasanbeg, nuk ka asgjë të re, ata me gjasë nuk do të vizitojnë vendin e fatkeqësisë sepse si duket, ende nuk e kanë kuptuar se aty ka ndodhur një fatkeqësi me përmasa tragjike ose do ta vizitojnë këtë vend më vonë, atëherë kur do t`u duhet edhe ndonjë votë për zgjedhjet që priten të mbahen së shpejti në Maqedoni.

27 gusht 201

Në programet për zgjedhjet lokale mungon trajtimi i politikave të sigurisë në komunitet

Mos shpalosja e politikave lokale të sigurisë në komunitet, nga kandidatët për kryetarë komunash, është një papërgjegjësi e pafalshme ndaj qytetarëve dhe ikje e parakohshme nga përgjegjësia ligjore e menaxhimit të rreziqeve në nivelin lokal.

Duke shikuar dhe dëgjuar kandidatët për kryetarë komunash për zgjedhjet e ardhshme lokale, të krijohet përshtypja se niveli lokal nuk përballet me asnjë lloj rreziku, ose ndoshta kandidatët për kryetarë, mendojnë se dikush tjetër do të merret me menaxhimin e rreziqeve në komunat që ata pretendojnë ti qeverisin. Politika lokale e sigurisë dhe menaxhimi i rreziqeve, janë detyrë dhe përgjegjësi

e nivelit lokal, bazuar në disa ligje, si ai për vetëqeverisjen lokale, ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera etj.

Siguria në komunitet mund të vështrohet nga shumë aspekte dhe duke marrë parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë në sigurinë, ky aspekt i jetës në komunitet duhet të interpretohet gjerësisht, duke përfshirë të gjitha çështjet që ndikojnë në sigurinë e banorëve të saj dhe pronës se tyre. Siguria nuk nënkupton vetëm mungesën e krimit, por edhe sjelljet dhe ngjarjet që dëmtojnë sigurinë e komunitetit dhe njerëzve, si dhe në ndjenjën e sigurisë.

Politika e sigurisë në nivel lokal drejtohet në përputhje me interpretimin e lartpërmendur dhe në aspektin e gjerë të konceptit, si çështje e cila për nga natyra e saj ndikon në sigurinë aktuale dhe të perceptuar të individit dhe komunitetit. Siguria në nivelin lokal duhet të shikohet nga prizmi i krimit dhe shkeljes së rendit publik, nga rreziqet e armëve të vogla, mjeteve të pashpërthyera, rreziqet e aksidenteve rrugore, kërcënimi nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe nga qentë endacakë. Gjithashtu, siguria duhet të analizohet edhe nga këndvështrimi i popullsive të ndryshme, duke pas parasysh karakteristikat socio demografike të grupeve të veçanta dhe statusin eventual të pakicave të çdo lloji. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet analizës se si disa prej rreziqeve dhe sfidave ndikojnë në gratë dhe burrat, te të moshuarit, fëmijët me nevoja të veçanta, analizë përmes së cilës kërkohet sigurimi i qasjes së ndjeshme gjinore dhe grupeve të cenueshme, në zbatimin e politikës së sigurisë.

Politika lokale e sigurisë synon të adresojë nevojat sigurisë për të gjithë, ose të paktën për shumicën e banorëve dhe komuniteteve lokale, pa diskriminim. Kjo politikë është përmbajtësisht gjithëpërfshirëse dhe shmang zgjidhjet që do bëjnë përfitues vetëm një kategori të privilegjuar të qytetarëve. Siguria duhet të jetë një e drejtë për të gjithë, jo një privilegj i individëve.

Siguria e komunitetit është përgjegjësi e pushtetit lokal. Afërsia e komunitetit me autoritetet lokale ndikon në qasjen e tyre të natyrshme ndaj njëri tjetrit. Organet e qeverisjes lokale janë përgjegjëse sipas ligjeve në fuqi, për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve të tyre nga çdo rrezik dhe çdo lloj fatkeqësie natyrore

apo fatkeqësie tjetër. Ata duhet të kenë mjetet konkrete dhe praktike për menaxhimin e sigurisë në nivelin lokal. Këto aftësi reflektohen kryesisht në buxhetet e qeverive, autoriteteve dhe institucioneve lokale që duhet krijuar dhe të cilat do të veprojnë në nivelin lokal. Megjithatë, një resurs edhe më i madh i autoriteteve lokale në arritjen nivelit të dëshiruar të sigurisë në komunitetin lokal është vetë komuniteti dhe organizimi i tij, si dhe rrjetet shoqërore formale dhe joformale. Kjo politikë lokale e sigurisë në veçanti, do te theksonte veprimin sinergjik të institucioneve qeveritare, sektorit privat, OJQ-ve dhe komunitetit, për çështjet e përbashkëta.

Mos shpalosja e politikave lokale të sigurisë, nga kandidatët për kryetarë, për komunat ku ata kandidojnë, është një pa përgjegjësi e pafalshme ndaj qytetarëve dhe ikje e parakohshme nga përgjegjësia ligjore e menaxhimit të rreziqeve në nivelin lokal.

therandapost.com, 4 tetor 2017

Sfidat e menaxhimit të sektorit të sigurisë në bashkësi (komunitet)

Ngjarjet e fundit tragjike që ndodhën në Komunën e Suharekës, kërkojnë një vëmendje dhe mobilizim të shtuar të mekanizmave lokal të sigurisë, të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar të cilët së bashku me institucionet tjera, duhet të koordinojnë veprimet për menaxhimin e rreziqeve që kërcënojnë bashkësinë (komunitetin). Disa nga rreziqet aktuale që kërcënojnë bashkësinë jo vetëm në komunën e Suharekës janë: Delikuenca e të miturve, rreziqet nga përdorimi i substancave narkotike, armët ilegale, ngacmimet seksuale, qentë endacak, pastaj dhuna dhe bullizmi në shkolla (Bullizëm janë sjelljet e përsëritura, të dëmshme e agresive ndërmjet personave që ndryshojnë në nivelin e tyre të forcës dhe mund të jenë fizike dhe psikologjike. Ato përfshijnë goditjet, rrahjet, ngacmimet verbale, gjestet fyese, përjashtimin ose thjesht presionin për t'iu përshtatur atyre që dëshiron apo thotë bullisti). Kjo dhunë po bartet nga shkollat në vende publike, në rrugë, lokale, stacione autobusësh e deri në familjet e tyre.

Aspektet strategjike dhe ligjore

Republika e Kosovës sa i përket politikave, strategjive, ligjeve dhe akteve nën ligjore e ka të rregulluar çështjen e sigurisë në bashkësi. Fillimisht këtë çështje e rregullon Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi, Ligji për Policinë e Kosovës dhe Ligji për Policimin në Bashkësi, pastaj është **UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 03/2012 - MAPL PËR KËSHILLAT KOMUNALE PËR SIGURI NË BASHKËSI**, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera. Po ashtu Republika e Kosovës ka krijuar një mori mekanizmash që kujdesen për menaxhimin e rreziqeve dhe përgjithësisht për menaxhimin e sigurisë publike. Mekanizmat ekzistues për menaxhimin e sigurisë në bashkësi në kuadër të Policisë se Kosovës si dhe ka përcaktuar aktorët kryesor koordinues për zvogëlimin dhe parandalimin e rreziqeve në komunitet janë:

Policimi në Bashkësi (komunitet)

"Policimi në komunitet është filozofi dhe një strategji organizative që është e bazuar në përpjekjet e përbashkëta të banorëve dhe policisë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Policimi në bashkësi nënkupton "ruajtjen në çdo kohë të marrëdhënieve me publikun gjë kjo që e bënë të vërtetë traditën historike ku policia është populli dhe populli është policia! Policët janë thjeshtë pjesëtarë të popullit të cilët paguhen për t'i kushtuar vëmendje gjatë gjithë kohës detyrave të cilat i përkasin çdo banori, në interes të mirëqenies dhe ekzistencës së bashkësisë. Për të arritur një partneritet efikas dhe efektiv të policisë me bashkësinë, ajo duhet: të jetë e dukshme dhe e arritshme për publikun; ta njohë dhe të njihet nga publiku; t'u përgjigjet nevojave të komunitetit; të dëgjojë shqetësimet e komunitetit; të angazhohet dhe ta mobilizojë komunitetin; të japë llogari për veprimtaritë e saj dhe për rezultatet e këtyre veprimtarive"[33].

[33] https://www.osce.org/sq/kosovo/131466.

“Policimi në bashkësi përbëhet nga disa elemente të cilat mbështesin këtë policim si:

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB), janë organe komunale këshilluese për çështjet e sigurisë, të cilat në bashkëpunim me policinë, analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë. Qëllimi i KKSB-ve është ngritja e vetëdijes për llojet e ndryshme të krimit, prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komunitetit lokal, si dhe identifikimi i shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike.

Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVS), janë grupe të ndryshme njerëzish që përfshijnë përfaqësues nga komuniteti, qeveritë lokale dhe policia, të cilët kanë për qëllim identifikimin dhe adresimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krimin, sigurinë dhe kualitetin e jetës, për të arritur qëllimin e përbashkët, krijimin e një bashkësie më të sigurt. EVSB-të janë themeluar nga programi ICITAP/Departamenti i Drejtësisë -SHBA si dhe ndihmuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë.

Këshillat Lokale për Siguri Publike (KLSP) kanë për detyrë implementimin e iniciativave të Policimit në bashkësi duke mbledhur së bashku përfaqësues të komunitetit, policisë, shkollës, grave dhe rinisë, që të përmirësojnë sigurinë dhe kualitetin e jetës në bashkësinë ku ata veprojnë dhe jetojnë. Këto forume të Sigurisë në Bashkësi veprojnë si trupa konsultativë, roli i të cilëve është të rrisin vetëdijen mbi natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet jo-shoqërore, të njohin çështjet e rendit dhe sigurisë, të identifikojnë metodat e zhvillimit dhe implementimit efektiv të projekteve dhe planeve të veprimit në nivel lokal në partneritet me Policinë e Kosovës, zyrtarët lokalë dhe partnerët tjerë. Këto forume të sigurisë janë mekanizma të rëndësishëm që përkrahin zbatimin e iniciativave të sigurisë në bashkësi në nivel kombëtar, regjional dhe lokal. Përbërja e këshillave komunale për siguri në bashkësi është e mjaftueshme për të parandaluar, për tu përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga çdo rrezik që cenon ose godet komunitetin sepse këto këshilla përbëhen nga: **1.**

Kryetari i Komunës (Kryesues); 2. Komandanti i Stacionit të Policisë në komunën përkatëse; 3. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse; 4. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të komunës përkatëse; 5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës; 6. Zyrtari për Barazi Gjinore; 7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim; 8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse; etj."[34].

(Mos) Zbatimi i ligjeve në funksion të menaxhimit të sektorit të sigurisë në nivelin lokal

Ligjin Për Policinë e Kosovës, Ligjin për Policimin në Komunitet, Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimin Administrativ për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, pastaj ligjet tjera dhe aktet nën ligjore që e rregullojnë çështjen e menaxhimit të sektorit të sigurisë në bashkësi si dhe mekanizmat institucional aktual, të cilët për fatin e keq nuk zbatohen nga nivelet lokale ose zbatohen vetëm sa për të përmbushur formalitetet administrative, është e domosdoshme që kryetari i Komunës si autoriteti kryesor lokal (zyrtar i zgjedhur), ligjërisht ti zbatojë, t`i menaxhojë dhe t`i koordinojë këto akte dhe mekanizma, në funksion të parandalimit, zbutjes dhe reagimit ndaj këtyre rreziqeve që kërcënojnë apo mund ta godasin nivelin lokal, gjegjësisht bashkësinë. Siguria në bashkësi (komunitetit) është përgjegjësi e pushtetit lokal. Afërsia e bashkësisë me autoritetet lokale ndikon në qasjen e tyre të natyrshme ndaj njëri tjetrit. Organet e qeverisjes lokale janë përgjegjëse sipas ligjeve në fuqi, për sigurinë dhe mbrojtjen e qytetarëve të tyre nga çdo rrezik. Ata duhet të kenë mjetet konkrete dhe praktike për menaxhimin e sigurisë në nivelin lokal. Pra, edhe një herë po e potencojë se: koordinimi ndërinstitucional në nivelin lokal është vendimtar në menaxhimin e rreziqeve çfarëdo qofshin ato. Të gjithë këta mekanizma vendimmarrës, koordinues dhe reagues, sikur të ndër

[34] I gjithë materiali për këtë opinion është nxjerrë nga politikat, strategjitë, ligjet dhe aktet nënligjore qe e rregullojnë menaxhimin e sektorit te sigurisë në bashkësi.

veprojnë dhe të punojnë së bashku, sipas detyrave dhe përgjegjësive të tyre të sanksionuara me ligjet e lartë cekura, gjendja e sigurisë në nivelin lokal do të ishte relativisht e mirë. Detyrë dhe obligim ligjor i këtyre mekanizmave është që të përcjellin trendët e kërcënimeve dhe rreziqeve ne bashkësi, të analizojnë dhe vlerësojnë këto rreziqe dhe kërcënime, të hartojnë plane dhe marrin masa parandaluese, përmes inspektimeve dhe kontrolleve të shpeshta, pastaj të hartojnë plane veprimi në mënyrë që të reagojnë me kohë qoftë për të parandaluar rreziqet, qoftë për të reaguar ndaj situatave me rrezikshmëri të lartë që cenojnë jetën, të mirat materiale dhe pronën e pjesëtarëve të bashkësisë.

Pasi që Kryetari i Komunës, Drejtori i Policisë dhe përfaqësuesit e institucioneve tjera qeveritare lokale, OJQ-të dhe mediat, që janë pjesë e mekanizmave vendimmarrëse, koordinuese dhe reaguese të sigurisë në bashkësi, janë të obliguar me ligj që të menaxhojnë sektorin e sigurisë, sigurisht se duhet të kërkohet nga ta përgjegjësi ligjore, politike dhe morale, kur situatat e sigurisë eskalojnë duke marrë jetë njerëzish, sepse misioni i këtyre mekanizmave është që të parandalojnë rreziqet dhe të mbrojnë jetën e qytetarëve si dhe të kujdesen për mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve. Prandaj, është vështirë e justifikueshme tragjedia e fundit kur një nxënës 17 vjeçar, vritet jo më larg se 50 metra larg stacionit të policisë, ose tjetri vritet në oborrin e shtëpisë së tij nga pakujdesia, dhe kështu, menjëherë shtrohet pyetja: pse i kemi krijuar gjithë këta mekanizma të sigurisë në bashkësi dhe kujt i japin llogari këta mekanizma, në rastet kur siguria e qytetarëve në bashkësi cenohet rëndë deri edhe me jetë?

therandapost.com, 16 prill 2018

LITERATURA DHE BURIMET

Literatura:

1. Dr.sc Kolë Krasniqi, Terrorizmi Ndërkombëtar, Botimi II -Prishtinë 2010
2. Edelman, Murray (2003) Konstrukcija politickog spektakla, Politicka kultura, Zagreb
3. Tatalović, S., *Nacionalna sigurnost Republike Hrvatske i sigurnost na jugoistoku Europe*

4. Politics; who gets what, when, whew. Author, Harold Dwight Lasswell. Publisher, Whittles house, 1936. Original from, the University of Michigan

5. TEORIJE I SISTEMI SIGURNOSTI-Prof. dr. Ramo Masleša, Magistrat, Sarajevo, 2001.

6. Studime bashkëkohore të sigurisë. Origjinali: Contemporary security studies. Gjinia: Shkenca sociale. Autori: Alan Collins. Shqipëroi: Enri Hide. Shtëpia botuese: UET Press

Burimet:

- *http://reliewweb.int/node/73842*
- Nuc News - September 11, 2000
- DU EFFECTS IN KOSOVO UNMIK INSTITUCIONET E PËRKOHSHMVE VETQEVERISËSE Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor
- The Nation, October 21, 1996
- World Kosovo waterways bombing a 'war crime' By News On line's Alex Kirby
- FOCUS News Agency
- Zeitschrift für Geopolitik -*Journal for Geopolitics* (1924), Karl Ernst Haushofer
- http://www.mekaleh-eritra.org/Documents/Nekrumah/2006-07-05-USA-Doc1.htm.
- "Koha", 1 mars 1995
- Headquarters Department of the Army Washington, DC, 31 May 1997
- Press releases *Thursday 11 Jan 2001* Depleted Uranium sites in Kosovo detailed by UNEP, See also http://balkans.unep.ch
- Campaign Against Depleted Uranium (CADU) E-mail: gmdcnd@gn.apc.org
- The National Gulf War Resource Center – USA E-mail: ngwrc@vva.org
- Zeleni Sto – Jugoslavija E-mail: greentbl@eunet.yu

~~~~~~

© Pashtriku.org, korrik 2018
~~~~~~